



UDHËZUES MBI

Praktikat e mira të raportimit financiar dhe transparencës buxhetore në sektorin publik

© 2025 Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim / Banka Botërore
1818 H Street NW
Uashington D.K. 20433
Telefon: 202-473-1000
Internet: www.worldbank.org

Ky dokument është produkt i stafit të Bankës Botërore, me kontribute të jashtme. Konstatimet, interpretimet dhe përfundimet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë medoemos pikëpamjet e Bankës Botërore, Bordit të Drejtorëve Ekzekutivë të saj apo të qeverive që përfaqësojnë.

Banka Botërore nuk garanton saktësinë, plotësinë apo aktualitetin e të dhënave të përfshira në këtë punim dhe nuk merr përgjegjësi për gabime, mosparaqitje apo mospërputhje të informacioneve apo në lidhje me përdorimin apo mospërdorimin e informacioneve, metodave, proceseve apo përfundimeve të paraqitura në të. Kufijtë, ngjyrat, emërtimet dhe çdo informacion tjetër që paraqitet në hartat e këtij dokumenti nuk nënkuptojnë nga ana e Bankës Botërore asnjë gjykim për statusin juridik të asnjë territori dhe nuk përbëjnë ndonjë mbështetje apo pranim të kufijve të paraqitur.


Asgjë në këtë punim nuk mund të përbëjë apo të interpretohet apo të konsiderohet si kufizim apo heqje dorë nga privilegjet dhe imunitetet e Bankës Botërore, të cilat mbeten veçanërisht të rezervuara.

Të drejtat dhe lejimet

Materialet e këtij dokumenti janë objekt i të drejtës së autorit. Duke qenë se Banka Botërore nxit shpërndarjen e njohurive të saj, ky dokument mund të riprodhohet, tërësisht ose pjesërisht, për qëllime jo komerciale, për sa kohë që është përmendur plotësisht titulli i këtij dokumenti.

Çdo kërkesë për të drejta dhe leje, përfshirë të drejtat dytësore, duhet t'i drejtohet Zyrës së Botimeve të Bankës Botërore, Banka Botërore, 1818 H Street NW, Uashington, D.K. 20433, SHBA; faks: 202-522-2625; e-mail: pubrights@worldbank.org.

Grafika e kopertinës: Kora Reichardt



Shkurtime	3
Parathënie dhe falënderime	4
Përmbledhje e dokumentit	5
HYRJE	8
PRAKTIKA E MIRË 1: PËRGATITJA E INFORMACIONEVE FINANCIARE TË PLOTA, TË SAKTA DHE TË BESUESHME PËR NDIKIMIN AFATSHKURTËR DHE AFATGJATË TË VENDIMEVE PËR POLITIKAT	10
Kuadri i menaxhimit të financave publike	11
Kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara	11
Administrimi i pasqyrës së bilancit	14
PRAKTIKA E MIRË 2: SIGURIMI I RAPORTIMIT FINANCIAR TË KONSOLIDUAR TRANSPARENT ME SHQYRTIM EFEKTIV DHE ME DHËNIE TË SIGURISË	17
Pasqyrat financiare të konsoliduara	18
Kontrolli mbikëqyrës nga parlamenti	21
Kontrolli mbikëqyrës nga institucionet e pavarura buxhetore	22
Kërkesat për ndërmarrjet shtetërore	25
PRAKTIKA E MIRË 3: KOMUNIKIMI I INFORMACIONEVE PALËVE TË INTERESIT NË MËNYRË TË HAPUR, TRANSPARENTE DHE TË ARRITSHME PËR TË RRIUR BESIMIN NË RAPORTIMIN FINANCIAR	27
Transparenca buxhetore	27
Raporti vjetor	29
Përfshirja e shoqërisë civile dhe qytetarëve	30
PRAKTIKA E MIRË 4: PËRFSHIRJA E ZHVILLIMEVE TË REJA NË RAPORTIMIN E SEKTORIT PUBLIK	33
Raportimi i qëndrueshmërisë	33
Planifikimi buxhetor i gjelbër	35
Planifikimi buxhetor me bazë gjinore	38
Zgjidhjet GovTech në raportimin financiar	39

PËRFUNDIM: VËNIA NË ZBATIM E PRAKTIKAVE TË MIRA TË RAPORTIMIT FINANCIAR NË SEKTORIN PUBLIK 41

**Shtojca 1. Rrugëtimi nga kontabiliteti monetar në kontabilitetin
me të drejta dhe detyrime të konstatuara 43**


Shtojca 2. Estonia: pjesë të shkëputura nga pasqyrat financiare vjetore të Estonisë për vitin 2022 44

Shtojca 3. Zelanda e Re: pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 30 qershor 2023 52

Shtojca 4. Zvicra: Pasqyrat financiare shtetërore 2023 58


Shtojca 5. Shembuj të vendeve në lidhje me raportimin e ndërmarrjeve shtetërore 62

Materialet mbështetëse 64



SHKURTIME

BE	Bashkimi Evropian
BSNKSP	Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IPB	Institucion i Pavarur Buxhetor
MFP	Menaxhimi i financave publike
NSH	Ndërmarrje shtetërore
NZ	Zelanda e Re
OBR	Zyra për Përgjegjësinë Buxhetore, Britani e Madhe
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
PULSAR	Programi i Kontabilitetit dhe Raportimit në Sektorin Publik
PULSE	Vlerësimi i kontabilitetit në sektorin publik
SERQ	Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
SRQ	Standard për Raportimin e Qëndrueshmërisë
UK	Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandë së Veriut



PARATHËNIE DHE FALËNDERIME

Programi i Kontabilitetit dhe Raportimit në Sektorin Publik (PULSAR), i filluar në vitin 2017, është një program në nivel rajoni dhe vendi, me 11 vende përfituese të Evropës dhe Azisë Qendrore. Objektivi i programit është dhënia e mbështetjes për përmirësimin e kuadrit të kontabilitetit dhe raportimit financiar në sektorin publik në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me praktikën e mira, në mënyrë që të rritet llogaridhënia, transparenca dhe ecuria e qeverive.

Objektivat dhe fushëveprimi i Programit PULSAR përcaktohen bashkërisht nga partnerët e Programit PULSAR – Austria, Zvicra dhe Banka Botërore – të cilët japin edhe mbështetjen institucionale për zbatimin dhe mobilizojnë burimet e nevojshme për aktivitetet. Vendet përfituese ndihmojnë t'i japin trajtë këtij programi përmes platformave të bashkëpunimit rajonal dhe kontributeve në komunitetet e praktikës me fokus në kuadrin e raportimit financiar dhe në edukimin.


Më shumë informacion për programin PULSAR dhe botimet e tij gjendet në internet në adresën:

www.pulsarprogram.org

Udhëzuesi mbi praktikën e mira të raportimit financiar dhe transparencës buxhetore në sektorin publik është produkt informues i Departamentit të Institucioneve të Bankës Botërore, përgatitur në kuadër të Programit PULSAR.

Është përgatitur nga një ekip i Bankës Botërore, nën drejtimin e Adrian Fozzard-it, udhëhequr nga Iwona Warzecha, ku kanë bërë pjesë Sumita Shah, konsulent i cili ka siguruar kontributin teknik, Susan Caroline Schroeder, e cila ka bërë një punë redaktoriale të gjerësishme, dhe Kora Reichardt, e cila ka përgatitur grafikën e faqes. Arman Vatan ka siguruar orientime, mendime dhe sugjerime gjatë të gjitha fazave kryesore të hartimit. Instrumenti Shqyrtues i Dokumenteve të Mbështetur në IA i Bankës Botërore është përdorur në fazën përfundimtare për të propozuar redaktime të përmbledhjes së dokumentit, që janë miratuar nga personeli i Bankës Botërore.

Një falënderim i veçantë për Bordin Këshillimor Teknik të PULSAR-it: Andreas Bergmann, Profesor/Drejtor, Sektori Publik, Fakulteti i Administrimit dhe të Drejtës, Universiteti i Shkencave të Aplikuara i Zyrihut, Zvicër; Ian Carruthers, Kryetar, Bordin i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik; Sandro Fuchs, Profesor për Menaxhimin e Financave Publike, Universiteti i Shkencave të Aplikuara i Zyrihut (ZHAW); Thomas Müller-Marqués Berger, MMB Consult; dhe Bernhard Schatz, Drejtor, PwC Austri, i cili dha komente të hollësishme dhe të dobishme. U jemi shumë mirënjohës për kohën dhe kontributin e tyre për këtë material.



PËRMBLEDHJE E DOKUMENTIT

Në këtë material jepen udhëzime për të mbështetur përmirësimin e raportimit financiar dhe transparencës buxhetore në sektorin publik, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe me praktikën e mira, që rritin llogaridhënien, transparencën dhe ecurinë e qeverive. Materiali synon një grup të synuar të gjerë, përfshirë përdoruesit dhe hartuesit e pasqyrave: zyrtarë publikë, politikanë, kontabilistë, investitorë, organizata zhvillimore, rrethet akademike, shoqërinë civile dhe palë të tjera interesi.

PRAKTIKA E MIRË 1: PËRGATITJA E INFORMACIONEVE FINANCIARE TË PLOTA, TË SAKTA DHE TË BESUESHME MBI NDIKIMIN AFATSHKURTËR DHE AFATGJATË BUXHETOR TË VENDIMEVE PËR POLITIKAT

Për vënien në zbatim me sukses të reformave afatgjata të **menaxhimit të financave publike (MFP)**, që të jenë të qëndrueshme në kohë, nevojiten:

- ▶ një plan efektiv me prioritete, për realizimin e reformave;
- ▶ njerëzit me aftësi, njohuri dhe qasjen e duhur për t'i çuar përpara dhe zbatuar reformat;
- ▶ zbatimi i standardeve të pranueshme botërisht;
- ▶ struktura të menaxhimit financiar, përfshirë qeverisjen e mirë, sisteme dhe procese për të mbledhur, përpiluar, analizuar dhe vënë në dispozicion informacione financiare cilësore dhe aktuale, që u japin mundësi politikëbërësve të marrin vendime efektive dhe të arrijnë rezultatet e duhura për ekonominë dhe popullin.

Kalimi plotësisht në **kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuara** siguron informacione më të plota dhe më të dobishme për financat e sektorit publik. Megjithatë, rrugëtimi drejt kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara të plota mund të jetë i gjatë dhe disa e kanë të vështirë të integrojnë informacionet me të drejta dhe detyrime të konstatuara në proceset e raportimit financiar. Zbatimi me sukses varet nga rritja e kapaciteteve dhe aftësive të qeverive, si edhe nga përmirësimi i besueshmërisë dhe paprekshmërisë së sistemeve të buxhetit dhe të raportimit financiar. Megjithëse nuk e zëvendëson informacionin me bazë monetare, kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara siguron një pamje të plotë të pozicionit financiar dhe ecurisë së qeverisë duke përfshirë, si zërat monetarë, ashtu edhe ata jo-monetarë në pasqyrat financiare.

Administrimi i bilancit është i nevojshëm, si për vendimmarrjen, ashtu edhe për llogaridhënien në MFP. Pasqyra e bilancit tregon gjendjen financiare të njësisë ekonomike në një moment të caktuar kohor, duke informuar se çfarë zotëron (aktivet) dhe çfarë u detyrohet të tjerëve (detyrimet). Në sektorin publik, pasqyra e bilancit e ndihmon qeverinë të ketë një paraqitje pamore të financave publike dhe të përmirësojë administrimin e rreziqeve buxhetore. Bilanci ndihmon planifikimin afatgjatë, rritjen e qëndrueshme ekonomike, drejtësinë mes brezave dhe kushtet për begati në të ardhmen. Administrimi i mirë i bilancit është tipar thelbësor i menaxhimit të financave publike dhe mund t'i ndihmojë qeveritë në arritjen e objektivave të politikave dhe në shërbimet përkatëse. Në planin afatgjatë, administrimi i bilancit i jep mundësi qeverisë të administrojë aktivet dhe pasivet dhe të mendojë si të minimizojnë rreziqet, si dhe të maksimizojnë vlerën për tatimpaguesit.

PRAKTIKA E MIRË 2: SIGURIMI I RAPORTIMIT FINANCIAR TË KONSOLIDUAR TRANSPARENT ME SHQYRTIM EFEKTIV DHE ME DHËNIE TË SIGURISË

Shumë qeveri kanë llogari statistikore kombëtare të hartuara mirë, që janë të rëndësishme, mirëpo raportimi financiar shërben për qëllime të ndryshme dhe siguron një pamje më të gjithanshme të financave publike. Për një administrim buxhetor të suksesshëm nevojiten politika makroekonomike solide të mbështetura në të dhënat statistikore dhe në raportimin e gjithanshëm financiar. Së bashku, ato rrisin transparencën, mbështesin politikëbërjen e shëndoshë dhe kontribuojnë në një administrim buxhetor efektiv për të parashikuar dhe administruar krizat e mundshme ekonomike.

Pasqyrat financiare të konsoliduara rritin transparencën duke dhënë një pamje të plotë dhe të qartë të financave publike të vendit. Kjo i ndihmon qeveritë të përmirësojnë administrimin e aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve shtetërore, çka sjell realizim më të mirë dhe më efikas të shërbimeve. Pasqyra financiare të konsoliduara të cilat janë të besueshme u japin qeverive dhe palëve të interesit informacione të dobishme për bërjen e politikave dhe rritin krahasueshmërinë në nivel ndërkombëtar.

Për të parandaluar shtrembërimet politike apo heqjen e informacioneve në mbledhjen dhe raportimin e të dhënave financiare, rëndësi të madhe kanë strukturat solide të **kontrollit shqyrtues**. Organe të tilla si komisionet për financat publike ose të ngjashme me to, kontrollet e shtetit dhe mekanizma të tjerë të pavarur (si institucionet e pavarura buxhetore [IPB]) e rritin besueshmërinë dhe saktësinë e informacioneve dhe ndihmojnë në zbutjen e rrezikut të një krize të mundshme në të ardhmen.

Ndërmarrjet shtetërore (NSH) kanë detyrimin të respektojnë parimet e drejtimit të brendshëm të shoqërive tregtare por edhe parimet e MFP-së, përfshirë llogaridhënien, transparencën dhe praktikën e shëndosha financiare. NSH-të luajnë role kyçe për realizimin e shërbimeve publike në shumë vende. Ato mund të jenë organizata të mëdha komplekse, me marrëdhënie dhe interesa shumëdimensionale. Është e rëndësishme që të kenë organizimin e duhur të drejtimit të brendshëm dhe mekanizma për shqyrtimin publik dhe që të japin informacione mbi rezultatet mbështetur në të dhëna financiare dhe operative të plota dhe të njëtrajtshme, në përputhje me sistemin e përgjithshëm të MFP-së. Modeli i raportimit financiar për sektorin e NSH-ve duhet të sigurojë standarde të pranueshme dhe adekuate kontabël.

PRAKTIKA E MIRË 3: KOMUNIKIMI I INFORMACIONEVE PALËVE TË INTERESIT NË MËNYRË TË HAPUR, TRANSPARENTË DHE TË ARRITSHME PËR TË RRIUR BESIMIN NË RAPORTIMIN FINANCIAR

Gjithçka që bën qeveria është në interes të publikut, çka do të thotë se publiku dhe palët kryesore të interesit janë shumë të interesuara. Qytetarët presin të kenë besim në financat publike për të cilat kontribuojnë. Ata presin edhe që qeveritë të jenë transparente në lidhje me situatën buxhetore të vendit dhe mënyrën se si përdoren fondet publike (llogaridhënia, qeverisja, etika).


Transparenca e financave buxhetore është e domosdoshme për një llogaridhënie dhe administrim buxhetor efektiv. Kjo fuqizon besueshmërinë e planeve ekonomike të vendit dhe shërben si bazë për besimin e tregut dhe perceptimin e aftësisë paguese. Kjo

- ▶ mbështetet në dhënien e informacioneve të plota, të besueshme (të sakta dhe solide), aktuale, përkatëse dhe cilësore (në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP)) për financat publike të vendit, çka ndihmon në vendimet e politikave shtetërore.
- ▶ kërkon që informacionet shtetërore të jenë të arritshme dhe të kuptueshme, duke u mundësuar palëve të interesit t'i kërkojnë llogari qeverisë.
- ▶ pret që informacionet të konfirmohen nga kontrolli dhe dhënia e sigurtisë në mënyrë të pavarur.

Komunikimi publik i informacioneve financiare/ pasqyrave vjetore të sektorit publik duhet të synojë të jetë i qartë, i plotë dhe paraveprues.

PRAKTIKA E MIRË 4: PËRFSHIRJA E ZHVILLIMEVE TË REJA NË RAPORTIMIN E SEKTORIT PUBLIK

Qeveritë duhet të ecin me hapin e zhvillimeve dhe tendencave të raportimit financiar. Kjo përfshin dhënien e shembullit sa i takon përfaqimit dhe hartimit të strategjive, sistemeve dhe proceseve për **planifikimin e gjelbër buxhetor dhe raportimin e qëndrueshmërisë**; shfrytëzimin e **planifikimit buxhetor me bazë gjinore** për ta forcuar planifikimin buxhetor dhe për të mbështetur objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe për të qenë më shumë në përputhje me ta; dhe nëpërmjet përdorimit të **GovTech**-ut, për të ndihmuar në modernizimin e sektorit publik që ky të jetë përqendrohet te interesat e qytetarëve, duke ofruar shërbime të arritshme dhe një qasje të mbarë qeverisë ndaj transformimit digjital.



HYRJE

Një raportim financiar i gjithanshëm dhe i saktë i sektorit publik siguron që qeveritë të kenë informacionin financiar të nevojshëm për vendimmarrje të informuar. Kjo mund të sjellë rritje të transparencës buxhetore dhe dhënie informacionesh publike për të përmirësuar llogaridhënien dhe ecurinë. Një nga fushat e vëmendjes të programit rajonal PULSAR është ndërgjegjësimi për arsyetimin për reformën e kontabilitetit në sektorin publik, përfshirë demonstrimin e përfitimeve që sjell kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara dhe nxitja e arritjes së konsensusit mes palëve të interesit në lidhje me programin dhe zbatimin e reformës.

Analiza e qëndrueshmërisë së financave publike është thelbësore për stabilitetin ekonomik, rritjen dhe zhvillimin. Kjo do të thotë se qeveritë kanë detyrimin:

- ▶ të përgatisin informacione financiare të besueshme, të sakta dhe të plota, duke marrë në konsideratë ndikimin afatshkurtër dhe afatgjatë të vendimeve për politikën;

- ▶ të krijojnë struktura që mundësojnë që vendimet e tyre të kundërshtohen dhe të jenë objekt i shqyrtimit dhe dhënies së sigurisë;
- ▶ t'ua komunikojnë informacionet palëve të interesit në mënyrë të hapur, transparente dhe të arritshme;
- ▶ të rritin besimin në raportimin financiar.


Krizat ekonomike të dekadave të fundit hedhin dritë mbi cilësinë e dobët të menaxhimit dhe raportimit financiar të vendeve të ndryshme. Krizat financiare dhe ekonomike goditën Azinë Juglindore, Rusinë dhe pjesën më të madhe të Amerikës Latine në vitet 90 të shek. XX, ndërsa kriza e borxhit shtetëror preku qeveritë në mbarë botën në 2008-2010. Disa vende të Evropës (përfshirë Greqinë, Portugalinë dhe Qipron) kërkuar ndihmë nga organizata të ndryshme si Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Banka Qendrore Evropiane dhe Komisioni Evropian. U dëshmuar gjerësisht se një MFP i dobët dhe sidomos një menaxhim dhe raportim financiar me cilësi të dobët, kishin kontribuar në krizën buxhetore dhe e kishin zgjatur dhe thelluar atë. Disa vende i

nënvlerësuan ose i fshehën pozicionet e tyre deficitare dhe borxhin, çka e ka rritur mosbesimin për të gjitha informacionet financiare dhe e ka minuar besimin te qeveritë dhe ekonomia më në përgjithësi.

Kjo ka krijuar një kërkesë për menaxhim më të mirë financiar si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Synimi është të përmirësohen mekanizmat e drejtimit të brendshëm dhe të llogaridhënies, si dhe raportimi i hapur dhe transparent i mbështetur në standarde cilësore të kontabilitetit dhe auditimit dhe të zbatuara në mënyrë të njëtrajtshme, të mbështetur me udhëheqje të fortë financiare në krye të qeverisë. Në një ekonomi botërore konkurruese, qeveritë duhet të administrojnë me kujdes financat, të mbajnë parasysh të gjitha aktivet dhe detyrimet, të identifikojnë dhe të zbusin rreziqet dhe të marrin vendime në kohë për të drejtuar politika të shëndosha makroekonomike drejt një sërë qëllimesh. Kjo kërkon

informacione të sakta dhe përkatëse, si dhe kontribute nga të gjitha palët e interesit (p.sh., struktura të forta parlamentare dhe mbikëqyrëse, me politika publike, buxhete dhe plane të rritjes që i nënshtrohen në mënyrë transparente shqyrtimit).

Vendet e programit PULSAR po u japin zgjidhje vështirësive të përmirësimit dhe zgjerimit të raportimit financiar të sektorit publik. Ky udhëzues synon ta mbështesë këtë punë, duke identifikuar katër fusha të praktikave të mira ku vendet e programit PULSAR duhet të fokusohen gjatë përpjekjeve për të rishikuar dhe përmirësuar menaxhimin financiar të sektorit publik. Materiali synon një grup të synuar të gjerë, përfshirë përdoruesit dhe hartuesit e pasqyrave: zyrtarë të lartë publikë, politikanë, kontabilistë, shoqëri civile dhe qytetarë të interesuar pa përvojë kontabël, sepse të gjithëve u intereson ecuria e sektorit publik.



PRAKTIKA E MIRË 1: PËRGATITJA E INFORMACIONEVE FINANCIARE TË PLOTA, TË SAKTA DHE TË BESUESHME PËR NDIKIMIN AFATSHKURTËR DHE AFATGJATË TË VENDIMEVE PËR POLITIKAT

Një kuadër i mirë i MFP-së ndihmon në menaxhimin e qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike. Ky kuadër duhet t'i japë zgjidhje metodës së kontabilitetit dhe administrimit të pasqyrës së bilancit.

Megjithëse shumë qeveri kanë llogari statistikore kombëtare të hartuara mirë, raportimi financiar shërben për qëllime të ndryshme dhe siguron një pamje më të gjerë dhe më të plotë. Së bashku, ato rrisin transparencën, mbështesin politikëbërjen e shëndoshë dhe kontribuojnë në një administrim buxhetor efektiv për të parashikuar dhe administruar krizat e mundshme ekonomike. Në këtë aspekt,

nevojiten politika makroekonomike solide, të mbështetura në statistika dhe në raportim financiar.

Kur kanë mundësi të kenë informacione më të plota, qeveritë mund të kuptojnë më mirë financat publike dhe mund të bëjnë zgjedhje më të mençura dhe të marrin vendime më të mira në lidhje me politikat fiskale dhe shpenzimet publike. Pra, një hap kyç është një paketë e mirë **pasqyrash financiare me të drejta dhe detyrime të konstatuara**, të hartuara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik (SNKSP) ose me standarde të ngjashme vendase. Pasqyrat financiare

me të drejta dhe detyrime të konstatuara mund të ndihmojnë në identifikimin e treguesve dhe informacioneve të plota mbi nivelet e deficitit dhe borxhit shtetëror, si edhe mund të ndihmojnë në përcaktimin dhe parashikimin e shpenzimeve dhe të ardhurave publike, që, nga ana e vet, mund të ndihmojnë në zbulimin e problemeve buxhetore që nuk janë të dukshme në pasqyrat me bazë monetare.

Qeveritë e kanë të nevojshme të jenë në gjendje të përdorin **administrimin e pasqyrës së bilancit** për të analizuar qëndrueshmërinë afatgjatë të financave publike, p.sh., duke kuptuar dhe analizuar detyrimet e aktiveve. Për shembull, qeveria mund të dojë ta rifinancojë borxhin e pashlyer për të përfituar nga norma të ulëta të interesit. Por kjo duhet të bëhet me kujdes të madh. Përqendrimi i tepërt në uljen e mundshme të kostove të lidhura me vëllime të mëdha të borxhit afatshkurtër ose me norma të ndryshueshme rrezikon ta ekspozojë vendin ndaj kushteve të luhatshme të tregjeve financiare dhe ndryshimeve në aftësinë kredimarrëse të vendit.

KUADRI I MENAXHIMIT TË FINANCAVE PUBLIKE

Sistemet, proceset dhe praktikën që përdorin qeveritë për të menaxhuar fondet publike duhet të mundësojnë mbledhjen, përpilimin, analizimin dhe përdorimin e informacionit financiar për raportim financiar cilësor dhe aktual. Ky kuadër do të kishte nevojë për **standarde dhe politika të pranuar botërisht**.

Ka një varg instrumentesh diagnostikuese që mund të mbështesin reformën e kuadrit të MFP-së. Sekretariati për Llogaridhënien për Shpenzimet dhe Financat Publike ka identifikuar instrumentet e gatshme diagnostikuese të MFP-së,¹ përfshirë kornizën e analizës së kontabilitetit të sektorit publik (PULSE) të zhvilluar nga Banka Botërore. Instrumentet diagnostikuese mbulojnë shumë aspekte të gjera të sistemit të MFP-së dhe disa përqendrohen në funksione, institucione ose nënsisteme individuale të MFP-së dhe në sektorë ose tema specifike.

Menaxhimi i ndryshimit, përfshirë dimensionin njerëzor, duhet gjithashtu të merret parasysh për të siguruar që ekzistojnë strukturat e duhura të administrimit dhe që punonjësit e përfshirë në hartimin ose përdorimin e informacioneve financiare të kenë aftësitë, njohuritë dhe kapacitetin e duhur.

KONTABILITETI ME TË DREJTA DHE DETYRIME TË KONSTATUARA

Kontabiliteti përfshin regjistrimin, analizimin dhe raportimin e veprimeve ekonomike në formë monetare për palët e interesit. Ndërkohë që shoqëritë private shpesh përdorin kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuara dhe standarde të tilla si Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), sektori publik historikisht është mbështetur në kontabilitetin monetar. Kontabiliteti monetar është i thjeshtë dhe i lehtë për t'u kuptuar, por nuk kap kompleksitetin e veprimeve të sotshme shtetërore, borxhet e lindura, të gjitha pasivet dhe aktivet.

Kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara, në të cilin veprimet dhe ngjarjet ekonomike kontabilizohen kur ndodhin dhe jo kur këmbehen paratë, ofron një pamje më të plotë të rezultateve dhe gjendjes financiare. Kjo metodë është e vlefshme për bilancin e fund-vitit dhe për raportimin e rezultateve financiare, pasi mbështet një vendimmarrje më të mirë, parashikimet, planifikimin buxhetor, si edhe rrit kontrollin financiar përmes proceseve të standardizuara. (Shih edhe botimin e PULSAR-it "Përfitimet e kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara në sektorin publik").²

Kalimi drejt kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara është një proces gradual, që ndër të tjera kërkon: vendosje të objektivave, planifikim, zbatim, integrim në vendimmarrje, formim profesional të personelit, ngritje të sistemeve të përshtatshme informatike dhe legjislacion. Kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara nuk e eliminon nevojën për informacione me bazë monetare, por e plotëson atë, për të ofruar një pamje më të plotë financiare.

¹ <https://www.pefa.org/node/5240>

² <https://cfr.worldbank.org/publications/benefits-accrual-accounting-public-sector>

Shpesh, qeveritë parapëlqejnë buxhetin me bazë monetare, por mbajnë pasqyra financiare me të drejta dhe detyrime të konstatuara për të përmbushur kërkesat e kontrollit shqyrtues dhe llogaridhënies para palëve të interesit dhe qytetarëve. Planifikimi buxhetor me të drejta dhe detyrime të konstatuara ofron përfitime shtesë për shkak të harmonizimit

të plotë me raportimin financiar, krahas rritjes së transparencës dhe llogaridhënies (Shih **Shtojcën 1**).

Përfitimet e kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara në krahasim me bazën monetare paraqiten në **Figurën 1** më poshtë.

Figura 1. Përfitimet e kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara në krahasim me bazën monetare

LLOGARIDHËNIA DHE TRANSPARENCA

- ▶ Plotësia e informacionit – kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara i mbështetur në standarde ndërkombëtare është më i plotë se kontabiliteti me bazë monetare dhe sjell informacione financiare të krahasueshme dhe transparente.
- ▶ Rritje e llogaridhënies - informacioni i plotë, i besueshëm, aktual, përkatës dhe cilësor kontribuon në llogaridhënien publike.
- ▶ Informacion i arritshëm dhe i kuptueshëm – u jepet lehtësisht qytetarëve dhe palët e tjera të interesit.

PËRMIRËSIMI I MENAXHIMIT FINANCIAR

- ▶ Vendimmarrje më e mirë – informacioni financiar cilësor, i saktë, objektiv dhe aktual sjell administrim më të mirë afatshkurtër dhe afatgjatë të aktiveve dhe detyrimeve, identifikim dhe administrim më të mirë të rreziqeve, çka sjell përmirësim të vendimmarrjes, planifikimit dhe shpërndarjes së burimeve.
- ▶ Analizimi i forcës rezistuese financiare - pasqyrat financiare të publikuara u japin mundësi përdoruesve të parashikojnë flukset e ardhshme monetare dhe analizojnë forcën rezistuese ose rrezikun. Ato mund të japin një pamje të drejtë dhe të ekuilibruar të së kaluarës dhe një orientim për rezultatet e ardhshme.
- ▶ Më shumë transparencë për detyrimet e ardhshme – sjell përmirësim të planifikimit buxhetor, duke marrë parasysh angazhimet e marra përsipër që mbeten për t'u paguar deri në fund të vitit.

REZULTATI

- ▶ Mat rezultatet – administrimi i rezultateve matet në bazë të të dhënave financiare dhe operative të gjithanshme dhe të njëtrajtshme, që mundësojnë përdorim më të mirë të burimeve dhe realizim më të mirë të shërbimeve.
- ▶ Nxiti angazhimin për reforma - reformat e MFP-së kërkojnë gatishmëri për të bërë ndryshime të ndjeshme në politika dhe/ose për të krijuar stimujt e duhur financiarë.

Kutia 1. Shembuj nga vende të ndryshme, të modeleve të kontabilitetit dhe të raportimit financiar**ZELANDA E RE³**

Zelanda e Re është vendi i parë që ka adoptuar kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuara në administratën shtetërore. Pasqyrat financiare hartohen në bazë të Ligjit për Financat Publike të vitit 1989 dhe në përputhje me “Praktikën përgjithësisht të pranuar të kontabilitetit” të Zelandës së Re, të përcaktuar në Ligjin për Raportimin Financiar të vitit 2013 (mbështetur në SNKSP). Zelanda e Re i përdor këto standarde për planifikimin buxhetor, kontabilitetin e drejtimit dhe vendosjen e objektivave buxhetorë. Pasqyrat financiare auditohen nga institucioni i kontrollit të lartë të shtetit të Zelandës së Re.

KONTABILITETI NË ZVICËR⁴

Modeli i kontabilitetit në sektorin publik⁵ evidenton proceset dhe marrëdhëniet financiare nga një perspektivë e dyfishtë (parimi i kontrollit të dyfishtë), domethënë duke përdorur qasjet e rezultateve dhe të financimit.

Ky model ndjek sektorin privat, duke përdorur kontabilitetin me të drejta dhe detyrime të konstatuara të mbështetur në SNKSP. Ka pasqyrën e performancës financiare, pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e flukseve monetare dhe shënimet. Përveç këtyre, ka pasqyrën e investimeve dhe dëshmi për respektimin e kufizimit mbi borxhin. Pasqyrat financiare paraqesin sa më saktë situatën faktike, për sa u takon aktiveve, financave dhe të ardhurave buxhetore. Kjo siguron transparencë dhe vijimësi në raportimin financiar, por bën të mundur edhe krahasimin e pasqyrave financiare federale me ato të autoriteteve të tjera publike dhe sektorit privat. Transparenca dhe krahasueshmëria mbështesin menaxhimin financiar dhe rritin besimin e publikut. Neni 126 i Kushtetutës Federale, Ligji për Buxhetin Financiar dhe Urdhri për Buxhetin Financiar përbëjnë bazën ligjore të modelit të kontabilitetit.

Qasja e rezultateve tregon shpenzimet (rënie e vlerës) dhe të ardhurat (rritje e vlerës) të realizuara gjatë kryerjes së detyrave. Vlerat i njihen periudhës në të cilën krijohen ose konsumohen. Në pasqyrën e performancës financiare, shpenzimet e një viti të caktuar ushtrimor shënohen kundrejt të ardhurave të krijuara në të njëjtën periudhë. Teprica tregon suficitin ose deficitin e vitit ushtrimor. Për të nxitur efikasitetin, pasqyra e performancës financiare plotësohet me kontabilitet të kostos në nivel të njësisë administrative. Përgjegjësia e decentralizuar në mënyrë të njëtrajtshme e kredisë dhe faturimi i brendshëm i shërbimeve federale nxisin një ndërgjegjësim për kostot dhe një përdorim ekonomik të fondeve.

Qasja e financimit është vendimtare për drejtimin e përgjithshëm të buxhetit federal mbështetur në kriteret e kufizimit të borxhit. Rregullat e kufizimit të borxhit kanë për synim sigurimin e një ekuilibri të qëndrueshëm midis shpenzimeve dhe të ardhurave dhe shmangien e çekuilibrit strukturor në buxhetin federal.

Dallimi kryesor midis qasjes së rezultateve dhe qasjes së financimit lidhet me mënyrën si trajtohen investimet. Ndërkohë që në metodën e rezultateve përfshihet vetëm konsumi vjetor i kapitalit afatgjatë përkatës (amortizimi), me metodën e financimit shuma e plotë e shpenzimeve për investimet raportohet menjëherë. Kjo do të thotë se efektet buxhetore të investimeve janë drejtpërdrejt të dukshme dhe të kontrollueshme në momentin e blerjes dhe jo në momentin e konsumit. Sipas metodës së financimit, rëndësi ka huamarrja apo huadhënia neto, apo bilanci i përgjithshëm buxhetor. Kjo tregohet në dëshminë e respektimit të kufizimit mbi borxhin.

³ Burimi: Thesari i Zelandës së Re.

⁴ Burimi: https://www.efv.admin.ch/efv/en/home/themen/finanzpolitik_grundlagen/rechnungsmodell.html

⁵ https://www.efv.admin.ch/efv/en/home/themen/finanzpolitik_grundlagen/rechnungsmodell.html

ADMINISTRIMI I PASQYRËS SË BILANCIT

Pasqyra e bilancit ka për qëllim të tregojë gjendjen financiare të njësisë ekonomike, pra çfarë të drejtash dhe çfarë detyrimesh ka. Pasqyra e bilancit e sektorit publik a e një nënsektori të përcaktuar do të kërkonte konsolidimin ose agregimin e njësisë të kontrolluara dhe mund t'i jepte qeverisë një pamje më të qartë

të financave publike të vendit. Kjo mundëson një administrim më efektiv të rreziqeve buxhetore, një planifikim afatgjatë, nxitje të drejtësisë mes brezave⁶ dhe mbështetje të përpjekjeve për të krijuar kushtet e duhura për prosperitetin në të ardhmen. Administrimi i bilancit i jep mundësi qeverisë të administrojë më mirë aktivet dhe pasivet dhe të mendojë si të minimizojnë rreziqet, si dhe të maksimizojnë vlerën për tatimpaguesit.

Kutia 2. Përdorimi i pasqyrës së bilancit në sektorin publik⁷

Pasqyra e bilancit mbështet vendimet për politikën. Përdorimi i pasqyrës së bilancit:

- ▶ siguron informacione të vlefshme në pasqyrat financiare të integruara, në lidhje me aktivet, rrezikun, pasivet dhe pozicionin financiar të qeverisë
- ▶ tregon pasojat financiare të vendimeve të marra nga politikëbërësit
- ▶ mbështet vendimmarrjen e informuar
- ▶ u jep palëve të interesit informacion për t'u kërkuar llogari vendimmarrësve
- ▶ mund të ndihmojë në përmirësimin e MFP-së

Informacionet kryesore që përmbajnë pasqyrat e bilancit të disa vendeve me pasqyra financiare të integruara janë aktivet dhe pasivet, infrastruktura dhe pronat publike, aktivet financiare, kapitali qarkullues, detyrimet financiare, pensionet dhe rreziqet e bilancit.

Pyetjet që mund t'i ndihmojnë qeveritë të përdorin sa më mirë informacionet financiare janë:

- ▶ Çfarë aktivesh kanë dhe a i shfrytëzojnë sa më mirë këto aktive?
- ▶ A duhet t'i rrisin apo t'i pakësojnë investimet qeveritë?
- ▶ Cilat janë detyrimet dhe si do t'i shlyejnë apo t'u shërbejnë?
- ▶ A ofron rifinancimi mundësi për të kursyer para?
- ▶ Me çfarë shpejtësie rriten detyrimet në raport me të ardhurat dhe a mund të ngadalësohet rritja e tyre?
- ▶ Cili është ndikimi afatgjatë i vendimeve me pasojë financiare përtej vitit të ardhshëm?

Britania e Madhe ndjek qasjen e pasqyrave për qeverinë si të tërë. Kjo siguron kontabilizim të plotë të të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve dhe detyrimeve në një çast kohor dhe gjatë një periudhe vitesh për

të gjitha njësitë e qeverisjes në Britaninë e Madhe. Shqyrtimi i pasqyrës së bilancit, proces që ka nisur në vitin 2017, është përdorimi më i rëndësishëm i këtij informacioni deri më sot. Kjo qasje është konsideruar

⁶ ICAEW (2006), "Administrimi i pasqyrës publike të bilancit" – Brezat e sotshëm (si përfitues dhe persona të besuar të burimeve të fundme) përfitojnë nga ato që kanë ndërtuar dhe grumbulluar brezat e tjerë, ndërsa vendimet e sotshme dhe administrimi i këtyre burimeve janë një përcaktues i fortë i gatishmërisë së tyre për brezat e ardhshëm. Drejtësia mes brezave do të thotë se secili brezi duhet të japë së paku po aq sa merr nga pasuria e shoqërisë. Mirëpo, si mund të maten shumat që jep a merr secili brez?
<https://www.icaew.com/-/media/corporate/files/about-icaew/what-we-do/policy/public-finance/managing-the-public-balance-sheet.ashx>

⁷ Burimi: Instituti i Kontabilistëve të Autorizuar në Angli dhe Uells: "Administrimi i pasqyrës së bilancit të sektorit publik".
<https://www.icaew.com/-/media/corporate/files/about-icaew/what-we-do/policy/public-finance/managing-the-public-balance-sheet.ashx>

e suksesshme, ngaqë siguron informacione të hollësishme mbi katër mënyrat e kontabilitetit të qeverisë (raportimi financiar i qeverisë, kontabiliteti statistikor, planifikimi buxhetor, si edhe parashikimet

për qëndrueshmërinë buxhetore) me rritje të transparencës buxhetore, e cila për këtë arsye është më pak e prekshme nga kontabiliteti “kreativ”.^{8,9}

Kutia 3. Shqyrtimi i bilancit në Britaninë e Madhe¹⁰

Shqyrtimi i pasqyrës së bilancit synon Identifikimin e mundësive për të hequr ato aktive që nuk i shërbejnë më qëllimit të politikës, përmirësimi i kthimeve nga aktivet e mbajtura dhe zvogëlimi i rrezikut dhe kostos së detyrimeve.

PROCESI

Në bashkëpunim të ngushtë me ata që janë përgjegjës për aktivet dhe detyrimet, dikasterëve u kërkohet të bëjnë dallimin midis 1) aktiveve dhe detyrimeve qendrore (domethënë, jetike për politikë ose mbajtja e të cilëve duhet për interesin publik) dhe 2) aktiveve dhe detyrimeve jo të domosdoshme (që nuk i shërbejnë më një qëllimi të politikave).

Kjo zbulon vështirësitë me të cilat përballen dikasteret për administrimin efikas të bilancit të tyre. Kjo i jep gjithashtu mundësi qeverisë të identifikojë pengesat, të dalë me propozime për reforma dhe të zbatojë ndryshime për të realizuar përmirësime sistematike.

REZULTATET

Shqyrtimi dëshmon sa e vlefshme është kur ke një kuadër të qartë të pasqyrës së bilancit të sektorit publik për administrimin e aktiveve dhe detyrimeve në periudhën afatgjatë. Kjo ka ndihmuar me:

- ▶ identifikimin se si mund të administrohen më mirë pasuritë e paluajtshme të sektorit publik dhe/ose të lirohen për përdorime alternative ose për t'u shitur;
- ▶ eliminimin e objektivave arbitrare për shitjen e aktiveve, çka do të thotë se dikasteret nuk kanë nevojë të vazhdojnë me shitjet e aktiveve që nuk sjellin vlerë për investimin;
- ▶ përmirësimin e vendimmarrjes për shitjet e aktiveve – arsyetimi i politikës për shitjen, dhënia e informacioneve shpjeguese për shitjet dhe a sjell vlerë shitja;
- ▶ rritjen e transparencës;
- ▶ përfshirjen e administrimit të pasqyrës së bilancit në shqyrtimet e shpenzimeve, çka nxit një qasje afatgjatë në vendimmarrje; dhe
- ▶ përqendrimin te përmirësimi i administrimit të aktiveve dhe detyrimeve ekzistuese përpara marrjes së fondeve të reja.

HAPAT NË VIJIM

Mes të tjerash, Britania e Madhe vijon të përqendrohet te përmirësimi i administrimit të pasqyrës së bilancit duke vlerësuar ecurinë për të përmirësuar efikasitetin në mbarë qeverinë, duke nxitur zyrtarët të marrin në konsideratë ndikimin që ka administrimi i bilancit në vendimet për shpenzimet, proceset dhe udhëzimet në mbarë qeverinë. Shqyrtimi kontribuon në marrjen në konsideratë të ekspozimeve ndaj rreziqeve në lidhje me ndryshimet klimatike dhe kalimin drejt një ekonomie më të gjelbër.

⁸ “Dobia e mundshme e nënrealizuar e Pasqyrave të Qeverisjes si e Tërë të Britanisë së Madhe”, botuar në dhjetor 2023.

⁹ Megjithatë, dobia e ardhshme është cenuar kohët e fundit nga një reklamim i Zyrës Kombëtare të Kontrollit për Pasqyrat e Qeverisjes së e Tërë për vitin 2022/23 për shkak të “rasteve të prapambetura” të auditimeve të autoriteteve vendore angleze. Vetëm 10% e autoriteteve vendore dorëzuan të dhëna të besueshme, ndërsa 46% dorëzuan informacione të paaudituar dhe 44% nuk dorëzuan fare të thëna. Për pasojë, pasivet neto dhe të ardhurat neto ishin të mbideklaruara. Kontrollori dhe Audituesi i Përgjithshëm theksonin nevojën për pasqyra aktuale dhe solide të audituara të autoriteteve vendore.

¹⁰ Burimi: “Shqyrtimi i pasqyrës së bilancit: përmirësimi i administrimit të pasqyrës së bilancit të sektorit publik”, botuar në nëntor 2020. https://assets.publishing.service.gov.uk/media/5fbd02dfe90e077ee6d17a26/The_Balance_Sheet_Review_report____.pdf


Pasqyra e bilancit jep informacione të qarta të cilat mund të përdoren për të kuptuar pozicionin financiar të vendit. Në të jepet një pamje transparente e aktiveve dhe detyrimeve, që mund të përdoret për

vendimmarrjen dhe planifikimit në mbështetje të administrimit të rreziqeve dhe të maksimizimit të vlerës (shih **Kutinë 4**).

Kutia 4. Aktivet dhe detyrimet e Zelandës së Re, 2019-2023¹¹



¹¹ Burimi: Për shifrat e vitit 2023: faqe 5 e <http://www.treasury.govt.nz/sites/default/files/2023-10/fsgnz-2023.pdf>



PRAKTIKA E MIRË 2: SIGURIMI I RAPORTIMIT FINANCIAR TË KONSOLIDUAR TRANSPARENT ME SHQYRTIM EFEKTIV DHE ME DHËNIE TË SIGURISË

Edhe me llogari statistikore kombëtare të përgatitura mirë, mbështetja në statistika të veçanta dhe të ngushta pa një pasqyrë tërësore e bën më të vështirë parashikimin dhe administrimin e krizave të mundshme ekonomike. Përdorimi i pasqyrave financiare të konsoliduara jep një pamje shumë më të plotë. Krahas rritjes së vendimmarrjes për politikën, kjo mundëson dhënien e informacioneve publike të arritshme dhe të krahasueshme, për t'u marrë në shqyrtim nga palët e interesit. Për të administruar përmbushjen e politikave kontabël dhe për të zbutur rreziqet e krizave ekonomike, financiare apo të borxhit në nivel të konsoliduar, ka rëndësi të ketë struktura efektive të kontrollit (p.sh., komisione për pasqyrat e llogarive publike a të ngjashme, institucioni i kontrollit të lartë të shtetit etj.) dhe mekanizma të tjerë të pavarur (p.sh., IPB).

Meqenëse përpilimi dhe raportimi i këtij informacioni mund të cenohet nga politizimi dhe mosveprimet (duke lënë jashtë konsolidimit disa njësi ekonomike të konsiderueshme), politika kontabël e përfshirë në kuadrin ligjor duhet të përcaktojë qartë njësitë e konsoliduara, për të siguruar plotësinë. Në përputhje me SNKSP-të, kjo realizohet duke vlerësuar dhe zbatuar parimin e kontrollit, që përcakton se një njësi ekonomike kontrollon një njësi tjetër nëse plotësohen të gjitha kriteret e mëposhtme: i. njësia ushtron fuqi mbi njësinë tjetër; ii. njësia është e ekspozuar, ose ka të drejta, ndaj përfitimeve të ndryshueshme nga përfshirja e saj me njësinë tjetër; dhe iii. njësia e ka mundësinë për të përdorur fuqinë e saj mbi njësinë tjetër për të ndikuar në natyrën ose shumën e përfitimeve nga përfshirja e saj me njësinë tjetër (SNKSP 35, paragrafi 20).

NSH-të luajnë role kyçe për realizimin e shërbimeve publike në shumë vende. Si organizata të mëdha komplekse, me marrëdhënie dhe interesa shumëdimensionale, është e rëndësishme që ato të ndjekin parimet e MFP-së për llogaridhënien, transparencën dhe menaxhimin e mirë financiar. Informacionet mbi ecurinë duhen mbështetur në të dhëna financiare dhe operative të gjithanshme dhe të njëtrajtshme, që identifikojnë përdorimin e burimeve dhe realizimin e shërbimeve dhe që janë në përputhje me sistemin e përgjithshëm të MFP-së. NSH-të duhet t'u nënshtrohen kërkesave të drejtimit të brendshëm dhe shqyrtimit publik. Për sektorin e NSH-ve duhet të ketë standarde dhe politikë adekuate dhe të unifikuara kontabël dhe një model i pranueshëm i raportimit financiar. Kjo mund të ndryshojë sipas orientimit të NSH-së (NSH-të me orientim tregtar duhet të ndjekin standardet e kontabilitetit për shoqëritë tregtare siç janë SNRF-të, ndërsa SNKSP-të mund të jenë më të përshtatshme për ndërmarrjet e orientuara nga shërbimet). Praktikisht, qeveritë zgjedhin modele të ndryshme për mbledhjen dhe mbajtjen në ndjekje të rezultateve financiare dhe të qëndrueshmërisë së NSH-ve, përfshirë konsolidimin në pasqyrat financiare të qeverisë ose të shoqërive mëmë, raportimin e përmbledhur të të gjitha NSH-ve ose të përzgjedhura, dhënien e informacioneve shpjeguese shtesë në pasqyrat vjetore ose ndonjë ndërthurje e këtyre.

PASQYRAT FINANCIARE TË KONSOLIDUARA

Qëllimi i konsolidimit të pasqyrave financiare është sigurimi i transparencës duke pasur një pamje të qartë të sektorit ose nënsektorit publik të përcaktuar në mënyrë që të administrohen me efikasitet dhe efektivitet rezultatet, rreziqet buxhetore, detyrimet dhe aktivet. Kjo duhet të ndihmojë në transparencën dhe llogaridhënien publike nëpërmjet informacioneve financiare të arritshme dhe të kuptueshme mbi sektorin publik.

Pasqyrat financiare të konsoliduara japin një pamje të aktiveve ekzistuese, vendndodhjes dhe shpërndarjes së tyre (p.sh., gjeografikisht). Kjo mund të përdoret për

të kuptuar rreziqet e lindura, në mënyrë që të bëhet një analizë nëse këto rreziqe mund të zbuten dhe si mund të zbuten ose nëse mund të administrohen kur rreziku ndodh. Kjo jep edhe një pamje të ecurisë së përgjithshme të qeverisjes si të tërë (përfshirë njësitë e kontrolluara) në realizimin e objektivave dhe programeve të politikave. Konsolidimi ia cakton pronësinë dhe përgjegjësinë njësisë ekonomike më të lartë, që duhet të jetë përgjegjëse për procesin e konsolidimit dhe besueshmërinë e informacionit financiar të ofruar nga njësitë e kontrolluara, përfshirë aktive dhe pasive të veçanta.

“Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivele të ndryshme të qeverisjes”,¹² botim i programit PULSAR, informon mbi qasjet e ndryshme të konsolidimit dhe përpilimit të pasqyrave financiare, përfshirë përvojat e vendeve dhe praktikave mira ndërkombëtare. Në të theksohen edhe vështirësitë me të cilat përballen vendet në procesin e rakordimit dhe mënyrën se si marrin zgjidhje këto vështirësi.

Një revistë përmbledhëse për disa vende (**Tabela 1** më poshtë) evidenton mënyrat me të cilat qeveritë raportojnë financat e sektorit publik. Vendet zgjedhin formatin, metodikën dhe bazën e kontabilitetit në varësi të legjislacionit, rregullave dhe vendimeve për politikën. SNKSP-të mund të ofrojnë udhëzime të qarta për plotësinë e njësive ekonomike që duhen konsoliduar (duke përdorur parimin e kontrollit), për procesin e konsolidimit përfshirë marrjen e të dhënave të krahasueshme dhe për kryerjen e veprimeve rregulluese në konsolidim. Në të evidentohet se jo të gjitha pasqyrat financiare të qeverive janë lehtësisht të arritshme në faqet e tyre në internet; nga disa pasqyra nuk dilte gjithmonë qartë se cili ishte niveli i konsolidimit - përdoruesve do t'u duhej të filtronin shumë informacione për të gjetur se cilat organe përfshiheshin në konsolidim; në disa raste, megjithëse qytetarët dhe palët e interesit mund t'i kuptojnë informacionet, komuniteti ndërkombëtar mund ta ketë të vështirë të gjejë informacione të kuptimta për krahasueshmërinë; dhe nuk ishte gjithmonë e qartë nëse pasqyrat ishin audituar në përputhje me standardet ndërkombëtare apo vendase të auditimit. Pasqyrat financiare të konsoliduara janë gjithashtu të përmbledhura, pasi nuk përsërisin dhënien e informacioneve shpjeguese të paraqitura më parë në nivel të njësive ekonomike.

¹² <https://cfr.worldbank.org/publications/consolidation-financial-statements-different-levels-government>

Tabela 1. Qasja që ndjekin vende të ndryshme për raportimin financiar në sektorin publik

Pasqyrat e konsoliduara shtetërore	Australia	Kanadaja	Estonia	Franca	Zelanda e Re	Zvicra	Britania e Madhe
Pasqyra financiare / raport vjetor	po	po	po	po	po	po	po
Viti për të cilin shqyrtohen pasqyrat financiare	2023	2023	2022	2019	2023	2023	2021
Numri i faqeve	177	41 (përmbledhur)	277	64	181	67	285
Cilat njësi ekonomike konsolidohen	Kurora plus gjithë qeverisja qendrore përfshirë NSH-të	Të gjitha organet e qeverisjes qendrore / federale përfshirë NSH-të	Qeverisja qendrore dhe vendore dhe njësi të tjera të sektorit publik	Njësitë ekonomike të qeverisjes qendrore përfshirë NSH-të	Pasqyrat e qeverisë si e tërë, pa përfshirë qeverisjen vendore, përfshirë NSH-të	Qeverisja qendrore / federale dhe NSH-të kombëtare	Pasqyrat e qeverisë si e tërë, pa përfshirë NSH-të
Raport i Audituesit	po	po	Vetëm opinion për saktësinë e llogarive dhe rregullsinë e transaksioneve	po	po	Jo - për pasqyrat financiare të konsoliduara që nuk janë audituar. Po për pasqyrat financiare të "shtetit" (që janë edhe ministritë dhe njësitë e decentralizuara në konsolidim)	po
Informacione të përgjithshme ekonomike	po	po	po	po	po	po	po
Treguesit / rezultatet financiare	po	po	po	po	po	po	po
Suficiti / deficit	po	po	po	po	po	po	po
Rezultatet financiare	po	po	po	po	po	po	po
Shpenzimet	po	po	po	po	po	po	po
Përdorimi i buxhetit të shtetit	po	po	po	po	po	po	po
Përdorimi i aktiveve dhe pasiveve	po	po	po	po	po	po	po

Pasqyrat e konsoliduara shtetërore	Australia	Kanadaja	Estonia	Franca	Zelanda e Re	Zvicra	Britania e Madhe
Pasqyrat Financiare							
Pasqyra e bilancit	po	po	po	po	po	po	po
Pasqyra e performancës financiare	po	po	po	po	po	po	po
Pasqyra e flukseve monetare	po	po	po	po	po	po	po
Ndryshimet në aktivet neto / vlerën neto	po	po	po	po	po	po	po
Modelet e kontabilitetit dhe parimet e vlerësimit	Standardet Australiane të Kontabilitetit mbështetur në SNRF	Standardet Kanadeze të Kontabilitetit të Sektorit Publik	Standardi Estonez i Raportimit Financiar mbështetur në standardet e raportimit financiar të njohura botërisht, përfshirë SNKSP-të	Standardet Franceze të Kontabilitetit të Sektorit Publik (me krahasim me SNKSP-të / SNRF-të, sipas rastit)	Praktika Përgjithësisht e Pranuar Kotabël e Zelandës së Re / SNKSP	SNKSP me të ardhura fiskale me bazë monetare dhe pajisje të sektorit të mbrojtjes me bazë kostoje	Parimet Përgjithësisht të Pranuar Kontabël të Britanisë së Madhe mbështetur në SNRF
Informacione të tjera shtesë	po	po	po	po	po	po	po

Kutia 5. Shembuj të qasjeve të vendeve për raportimin e konsoliduar

ESTONIA

Raporti i konsoliduar i Estonisë informon për pozicionin financiar të sektorit publik të qeverisë dhe ecurinë e planeve të veprimit dhe jep një vlerësim të sistemit të kontrollit të brendshëm. Ministria e Financave, brenda datës 31 gusht, ia paraqet raportin e konsoliduar qeverisë dhe parlamentit. Raporti i konsoliduar përfshin një raport drejtimi, pasqyrat financiare vjetore, informacione të autoriteteve vendore dhe informacione të tjera të sektorit publik dhe të dikastereve të qeverisë qendrore. Konsolidimi përfshin organet e qeverisjes qendrore dhe vendore dhe njësi ekonomike të tjera të sektorit publik. Pasqyrat vjetore ofrojnë një pamje të gjendjes financiare të konsoliduar dhe të pakonsoliduar të shtetit, të performancës financiare, të flukseve monetare dhe të zbatimit të buxhetit të shtetit dhe shpjegojnë zërat më të rëndësishëm. Informacionet për sektorin publik dhe sektorin e qeverisjes së përgjithshme dhe informacionet për autoritetet vendore përfshijnë një pasqyrë të konsoliduar të pozicionit financiar, të performancës financiare dhe të flukseve monetare të këtyre sektorëve. Pasqyrat financiare përpilohen në bazë të vlerës së drejtë dhe të parimit të kostos. Raporti i auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për Raportin Vjetor të Konsoliduar bën vetëm një analizë të saktësisë së pasqyrave dhe rregullsisë së veprimeve, ndërsa më pas raporti miratohet nga parlamenti. **Shtojca 2** paraqet pjesë të shkëputura nga pasqyrat financiare vjetore të Estonisë për vitin 2022.

ZELANDA E RE

Qeveria e Zelandës së Re i publikoi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 30 qershor 2023, më 5 tetor 2023 – katër muaj pas fundit të vitit. Pasqyrat hartohen në bazë të dispozitave të legjislacionit të Zelandës së Re dhe janë në përputhje me Praktikën Përgjithësisht të Pranuar Kontabël të Zelandës së Re dhe me Standardet e Kontabilitetit të Njësive Ekonomike në Përfitim të Publikut në Sektorin Publik të mbështetura në SNKSP. Zelanda e Re jep një përmbledhje të shpenzimeve totale krahasuar me buxhetin në pasqyrat financiare të fundit të vitit. Këto auditohen nga institucioni i kontrollit të lartë të shtetit të Zelandës së Re. Deklaratat fillojnë me një Përmbledhje Buxhetore, ku evidentohen rezultatet buxhetore dhe forca qëndruese – shih **Shtojcën 3**, për një shembull.

ZVICRA

Pasqyrat financiare të Zvicrës hartohen në përputhje me SNKSP-të. Prej vitit 2023, tatimet e drejtpërdrejta federale njihen me të drejta dhe detyrime të konstatuara në pasqyrën e performancës financiare kur konstatohen tatimet e arkëtueshme (më parë, disa informacione paraqiteshin mbi bazën e arkëtimeve dhe pagesave, për shembull, të ardhurat nga tatimet e drejtpërdrejta federale paraqiteshin të njohura në çastin e arkëtimit dhe jo në momentin e lindjes së të drejtës së arkëtimit, ndërsa pajisjet e sektorit të mbrojtjes kontabilizoheshin me kosto dhe jo me jetën e dobishme). Pasqyrat financiare federale të konsoliduara nuk janë objekt auditimi, ndërsa në nivel më të ulët pasqyrat financiare të shteteve, ku konsolidohen edhe ministritë dhe njësitë ekonomike të decentralizuara, auditohen nga Zyra Federale e Auditimit të Zvicrës. Shtojca 4 jep një shembull të pasqyrave financiare në nivel shteti për Zvicrën.

KONTROLI MBIKËQYRËS NGA PARLAMENTI

Në shumë vende, parlamenti luan një rol të rëndësishëm për të shqyrtuar, kundërshtuar dhe kërkuar llogari prej ministrave dhe dikastereve. Disa qeveri kanë procese zyrtare kontrolli dhe të dhënies së sigurisë kundrejt parlamentit, ku merren në pyetje ministrat, bëhet debat, shqyrtohen dhe hetohen

politikat, veprimet dhe shpenzimet e qeverisë. Një pjesë e këtij procesi përfshin komisione të përzgjedhura ose të ngjashme, që marrin në shqyrtim rregullisht politikën e dikastereve dhe shpenzimin e parave të tatimpaguesve.

Vende të ndryshme kanë mekanizma të ndryshëm për kontrollin mbikëqyrës, përfshirë edhe parlamentin.

Tabela 2 më poshtë bën një krahasim të qasjeve të kontrollit mbikëqyrës të disa vendeve:

Tabela 2. Mekanizmat e kontrollit mbikëqyrës financiar

Strukturat kontrolluese	Britania e Madhe	Australia	Zelanda e Re	Austria	Estonia	Gjeorgjia
Komision parlamentar për financat publike ose i barasvlershëm	✓	✓	✓	✓		
Komisione të përzgjedhura ose të barasvlershme, përgjegjëse për kontrollin e politikave	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Komisione dikasteriale ose të barasvlershme, përgjegjëse për kontrollin e financave / buxhetit	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Kontrolli financiar (i udhëhequr nga personeli)	Sektori i Kontrollit					
Institucion i Pavarur Buxhetor	✓	✓		✓	✓	✓

Strukturat kontrolluese	Britania e Madhe	Australia	Zelanda e Re	Austria	Estonia	Gjeorgjia
Zyra kombëtare e auditimit ose institucioni i kontrollit të lartë të shtetit	✓	✓	✓	✓	✓	✓
Auditimi i brendshëm	i centralizuar	dikasterial	dikasterial	i centralizuar	dikasterial	dikasterial i kufizuar
Zyra e Statistikave Kombëtare	✓	✓	✓	✓	✓	✓

Kutia 6. Shembull i qasjes së një vendi për kontrollin mbikëqyrës¹³

Në **Britaninë e Madhe**, në zyrën e Komisionit pranë dhomës së ulët të parlamentit ka një sektor të kontrollit. Ky sektor u siguron ekspertizën e specializuar (përfshirë nga specialistë juridikë, kontabël, politikë, një specialist i ekonomisë dhe një statisticien) komisioneve të përzgjedhura (të cilat zhvillojnë hetime për tema të veçanta) në lidhje me aspekte legjislative dhe financiare.

Sektori i kontrollit mbështet shqyrtimin e projektligjeve, bashkërendon parashtrimet me shkrim dhe me gojë dhe ofron informime për anëtarët e komisioneve për seancat dëgjimore. Ky sektor shqyrton politikat, me anë të punës kërkimore, analizës analitike, si dhe mbështetjes për përcaktimin e pikave për hetime të mundshme, administron seancat dëgjimore ose elementet e hetimeve më të gjata, harton pyetje për seancat publike mbi projektligjet dhe bën ndjekjen e rekomandimeve të raporteve. Ai bën edhe shqyrtime të informacioneve financiare dikasteriale, si: çmuarjet kryesore dhe plotësuese; relacionet dhe pasqyrat vjetore; dhe shlyerjet e shpenzimeve, pasqyrat e buxhetit dhe pasqyrat e vjeshtës. Me këto shqyrtime, u kërkon përgjigje me shkrim dikastereve dhe informime për seancat dëgjimore. Krahas kësaj, synon të përmirësojë cilësinë e informacioneve financiare përmes shënimeve udhëzuese dhe formimit profesional (përfshirë shembujt e praktikave më të mira).

KONTROLI MBIKËQYRËS NGA INSTITUCIONET E PAVARURA BUXHETORE

Një mënyrë tjetër për të kontrolluar politikat buxhetore dhe planet e rritjes të qeverisë është krijimi i një IPB-je për të shqyrtuar politikat fiskale dhe politikat shpenzuese. Detyra kryesore e IPB-së është të sigurojë një analizë të pavarur dhe të aftë të qëndrueshmërisë së financave publike. IPB-të mund t'i bëjnë një analizë dhe këqyrje kritike qëndrueshmërisë së financave publike, përfshirë parashikimet makroekonomike për planifikimin e buxhetit dhe mund të mbajnë në ndjekje respektimin e rregullave buxhetore në mënyrë objektive dhe transparente, ndërkohë që sigurojnë edhe kontroll mbi politikat buxhetore. Ato mund të sigurojnë këshilla jopartiake për politikat dhe ecurinë buxhetore, që mund të jenë çelësi për nxitjen e vendimeve të shëndosha të

financave publike në përputhje me interesin publik. Ka raste kur mosmarrëveshjet buxhetore janë burim tensionesh të mëdha ndërmjet një këshilli buxhetor dhe qeverisë (shih shembullin e Britanisë së Madhe në **Kutinë 7**). Në qoftë se pasqyrat financiare me të drejta dhe detyrime të konstatuara janë pjesë e sistemit të MFP-së, është shumë e rëndësishme që institucionet mbikëqyrëse, si parlamenti dhe IPB-ja, të krijojnë kapacitete të mjaftueshme për ta përdorur dhe analizuar informacionin. Në shumë raste organet e mbikëqyrjes publike përdorin vetëm informacione statistikore për buxhetin dhe financat e qeverisë.

Numri i IPB-ve është rritur ndjeshëm në vazhden e krizës financiare botërore, si edhe kohët e fundit kur vendeve anëtare të eurozonës iu kërkua të kishin organe të tilla (shih **Kutinë 8** më poshtë).

Në vitin 2014, Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) botoi një raport mbi

¹³ Burimi: Parlamenti Britanik, <https://www.parliament.uk/>

Kutia 7. Shembull vendi për një institucion të pavarur buxhetor dhe për mungesën e suksesit në zbatim

E krijuar në vitin 2010, Zyra për **Përgjegjësinë Buxhetore (OBR) në Britaninë e Madhe** luan rol këshillues dhe jo vendimmarrës për politikë. Është e pavarur nga qeveria, por jep llogari para Parlamentit dhe Kancelarit. Kjo zyrë analizon rreziqet buxhetore dhe evidenton problemet e lidhura me to, vlerëson ecurinë kundrejt objektivave buxhetorë të qeverisë (perspektivat ekonomike dhe buxhetore) dhe nxjerr parashikime ekonomike dhe buxhetore. Ajo ka të drejtën ligjore të marrë informacion dhe ndihmë nga qeveria dhe ka marrëveshje buxhetore shumëvjeçare e cila bëhet publike. Pranë kësaj zyre, Komisioni për Përgjegjësinë Buxhetore emërohet nga Kancelari, ndërsa Nënkomisioni për Thesarin ka të drejtën e vetos në çdo vendim emërimi. Kjo “bravë me dy çelësa” nuk gjendet në procedurat e emërimit në poste të tjera publike në Britaninë e Madhe. Anëtarët japin llogari para politikanëve, por nuk varen prej tyre.

OBR është e veçantë mes homologëve ndërkombëtarë në kuptimin që nxjerr parashikime zyrtare të qeverisë dhe luan një rol kontrolli në formë opionence ndaj Thesarit për koston e masave të politikave gjatë procesit të parashikimeve buxhetore. Qeveria e Britanisë së Madhe zakonisht përgjigjet me anë të një relacioni ku identifikon se si do të administrohen rreziqet buxhetore dhe si do t’u jepet zgjidhje problemeve të evidentuara nga OBR. Kjo siguron dhënien e informacioneve dhe komponentët e administrimit për kornizat e rreziqeve buxhetore, të cilat janë të rëndësishme dhe i japin parlamentit dhe publikut një mjet për të analizuar përshtatshmërinë e strategjive të qeverisë lidhur me administrimin e rreziqeve dhe për t’i kërkuar llogari qeverisë për zbatimin e tyre.

Në shtator 2022, qeveria britanike prezantoi një mini-buxhet në të cilin përfshinte shkurtime tatimesh, të financuara me rritje të huamarrjes. Qeveria nuk u konsultua fillimisht me OBR-në e nuk i dha informacion, siç vepronte zakonisht, dhe kjo solli mungesë të një kontrolli të pavarur. Mini-buxheti shkaktoi krizë financiare; sterlina angleze u zhvlerësua me shpejtësi kundrejt dollarit amerikan, mes një krize të koston së jetesës. FMN-ja e kritikoi qasjen e Britanisë së Madhe e kjo solli reagime negative nga tregjet botërore dhe një prapakthim të politikës. “London School of Economics” diskutoi për këtë incident, duke theksuar rëndësinë e procesit të transparencës dhe mbikëqyrjes për politikëbërësit e ardhshëm, sidomos në demokracitë e përparuara.

parimet për institucionet e pavarura buxhetore,¹⁴ në ndihmë të vendeve anëtare për ndërtimin e IPB-ve dhe për strukturën e drejtimit të brendshëm që do të duhej të ekzistonte për t’u dhënë mundësi këtyre organeve të bëjnë analiza kompetente dhe jopartiake të financave publike të vendit. Në vitin 2022, OECD-ja botoi një raport ku thuhet se parimet ishin zbatuar gjerësisht dhe ishin përdorur në ndërtimin e IPB-ve të reja ose në reformimin e atyre ekzistuese.

Mesazhi kryesor i një analize të kryer nga Sektori i Kontrollit të Qeverisjes Ekonomike dhe Bashkimit Ekonomik dhe Monetar, ishte se “IPB-të kombëtare janë një element i rëndësishëm në kuadër të qeverisjes buxhetore të Bashkimit Evropian (BE) dhe mund të luajnë rol në planet e parashikuara buxhetore-strukturore.

Për këtë qëllim, nevojiten disa standarde minimale. Megjithatë një qeveri e veçantë mund të hezitojë ta fuqizojë IPB-në e vendit të saj, është në interesin e përbashkët të ketë një grup IPB-sh të forta në mbarë BE-në. Kjo do të kishte nevojë për mbështetjen e Komisionit Evropian dhe të Parlamentit Evropian, duke qenë se janë këto institucione ato që “internalizojnë” eksternalitetet e politikave buxhetore.”¹⁵

Direktiva e BE-së nr. 2011/85 për kërkesat për kornizën buxhetore të Shteteve Anëtare u ndryshua në vitin 2024.¹⁶ Ajo synon ta fuqizojë më tej rolin e IPB-ve duke rritur pavarësinë, përgjegjësitë dhe llogaridhënien e tyre. Kjo direktivë kërkon përfshirjen e IPB-ve në procesin buxhetor për të siguruar monitorim efektiv dhe aktual të respektimit të

¹⁴ <https://www.oecd.org/gov/budgeting/OECD-Recommendation-on-Principles-for-Independent-Fiscal-Institutions.pdf>

¹⁵ Sektori i Kontrollit të Qeverisjes Ekonomike dhe Bashkimit Ekonomik dhe Monetar. 2023. “Pikat e forta dhe të dobëta të IPB-ve në Kornizën e Qeverisjes Ekonomike të BE-së”.

¹⁶ <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2024/1265/oj>

Kutia 8. Institucionet e pavarura buxhetore në Evropë dhe viti i themelimit

- ▶ **Autoriteti i Pavarur Spanjoll për Përgjegjësinë Buxhetore (2014)**
<http://www.airef.es/?locale=en>
- ▶ **Baza e të dhënave për institucionet e pavarura buxhetore e Komisionit Evropian**
http://ec.europa.eu/economy_finance/db_indicators/fiscal_governance/independent_institutions/index_en.htm
- ▶ **Bordi i Pavarur Këshillimor i Këshillit Gjerman të Stabilitetit (1963)**
<https://www.stabilitaetsrat.de/EN>
- ▶ **Bordi Këshillimor Buxhetor Austriak (2002)**
<https://www.fiskalrat.at/en/>
- ▶ **Bordi Këshillimor Buxhetor i Maltës (2015)**
<https://mfac.org.mt/>
- ▶ **Bordi Këshillimor Buxhetor Irlandez (2011)**
<http://www.fiscalcouncil.ie/>
- ▶ **Byroja Federale Belge e Planifikimit**
<http://www.plan.be/en>
- ▶ **Byroja Holandeze për Analizën e Politikave Ekonomike (1945)**
<http://www.cpb.nl/en>
- ▶ **Instituti për Zhvillim dhe Analizë Makroekonomike i Republikës së Sllovenisë (2000)**
<https://www.umar.gov.si/en>
- ▶ **Këshilli Buxhetor i Bullgarisë (2015)**
<https://www.fiscalcouncil.bg>
- ▶ **Këshilli Buxhetor i Estonisë (2014)**
<https://eelarvenoukogu.ee/en>
- ▶ **Këshilli Buxhetor i Francës (2013)**
<https://www.hcfr.fr/en>
- ▶ **Këshilli Buxhetor i Hungarisë (2009)**
<http://www.parlament.hu/web/koltsegyvetesi-tanacs/in-english>
- ▶ **Këshilli Buxhetor i Letonisë (2014)**
<http://fiscalcouncil.lv/council>
- ▶ **Këshilli Buxhetor i Qipros (2014)**
<https://www.fiscalcouncil.gov.cy/en/>
- ▶ **Këshilli Buxhetor i Rumanisë (2010)**
<http://www.fiscalcouncil.ro/>
- ▶ **Këshilli Buxhetor i Serbisë (2011)**
<https://www.fiskalnisavet.rs/>
- ▶ **Këshilli Ekonomik Danez (1962)**
<https://dors.dk/english>
- ▶ **Këshilli i Republikës Sllovaqe për Përgjegjësinë Buxhetore (2012)**
<https://www.rrz.sk/en/>
- ▶ **Këshilli i Shtetit i Vendeve të Ulëta (2014)**
<https://www.raadvanstate.nl/talen/artikel/>
- ▶ **Këshilli Kombëtar i Financave Publike i Luksemburgut (2014)**
<https://cnfp.public.lu/en.html>
- ▶ **Këshilli për Financa Publike i Portugalisë (2012)**
<http://www.cfp.pt/?lang=en>
- ▶ **Këshilli për Politika Buxhetore i Suedisë (2007)**
<https://www.fpr.se/english/fiscal-policy-council.html>
- ▶ **Këshilli Qendror për Buxhetin i Çekisë (2017)**
<https://unrr.cz/>
- ▶ **Këshilli Sllovak për Përgjegjësinë Buxhetore (2014)**
<https://www.rrz.sk/>
- ▶ **Komisioni Buxhetor Skocez (2017)**
<http://www.fiscalcommission.scot/>
- ▶ **Komisioni Kroat për Politika Buxhetore (2014)**
<https://www.sabor.hr/en/positions-fiscal-policy-commission>
- ▶ **Zyra e Kontrollit Kombëtar e Finlandës (2013)**
<https://www.vtv.fi/en/>
- ▶ **Zyra e Kontrollit Kombëtar e Lituanisë (2015)**
<https://www.valstybeskontrolle.lt/EN>
- ▶ **Zyra e Përgjegjësisë Buxhetore e Britanisë së Madhe**
<https://obr.uk/>
- ▶ **Zyra Parlamentare e Buxhetit e Greqisë (2010)**
<http://www.pbo.gr/en-gb/>
- ▶ **Zyra Parlamentare e Buxhetit e Gjeorgjisë (1997)**
http://pbo.parliament.ge/index_en.htm
- ▶ **Zyra Parlamentare e Buxhetit e Italisë (2014)**
<http://en.upbilancio.it/>

rregullave buxhetore, parashikime makroekonomike vjetore dhe shumëvjeçare realiste, korniza buxhetore kombëtare koherente dhe efektive dhe komunikim të rregullt me parlamentet dhe palët e tjera të interesit.

KËRKESAT PËR NDËRMARRJET SHTETËRORE

Zakonisht, NSH-të janë njësi ekonomike shtetërore të krijuara nga qeveria qendrore ose vendore, me formë të veçantë juridike, zakonisht me ligj. Mund të përdoren me qëllim kryesisht komercial me objektiva dhe qëllime zhvillimore ose financiare shtesë (domethënë për të nxjerrë fitime për shtetin); për të mbajtur në kontroll një situatë monopoli; për të vënë në zbatim politikat shtetërore; dhe/ose për të realizuar produkte ose shërbime shtetërore për qytetarët me çmime më të ulëta ose në vende të largëta. Më së shumti, NSH-të ushtrojnë aktivitet në sektorët me rrjete, siç janë ndërmarrjet e furnizimit me energji elektrike, ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve etj. dhe në sektorët me monopol natyror siç janë hekurudhat dhe mallrat bazë.

Informacionet financiare të NSH-ve kanë rëndësi sepse këto ndërmarrje janë shpesh subjekte tatimore të mëdha, si edhe ngaqë të ardhurat nga dividendi i tyre hyjnë në buxhet dhe subvencione/grantet për to dalin nga buxheti. Vendet shpesh përcaktojnë politika të veçanta për NSH-të – me klasifikime, përkufizime juridike, korniza të administrimit të punës dhe politika të dividendëve dhe investimeve. Disa NSH përcaktohen si strategjike dhe nuk mund të privatizohen. Po kështu, mund të ketë kufizime edhe për pasuritë e paluajtshme të shfrytëzuara nga NSH-të, që mund të mbrohen ligjërisht si pasuri publike në pronësi të drejtpërdrejtë të shtetit (dhe për rrjedhojë nuk mund të shiten nga NSH-të).

SNKSP-të japin udhëzime si duhen trajtuar NSH-të në pasqyrat financiare të qeverisë. Praktikisht, qasjet kombëtare përfshijnë konsolidim të plotë ose në bazë të kapitalit neto të NSH-ve (që mund të përfshijnë njësi të kontrolluara plotësisht dhe pjesërisht nga qeveria) në pasqyrat financiare të qeverisë ose të njësisë shtetërore që bën administrimin e aktiveve; dhënie të informacioneve në shënime të pasqyrave financiare në lidhje me vlerën e pjesëmarrjes në kapital dhe të informacioneve të tjera shpjeguese në pasqyrat financiare; një raport vjetor të veçantë të përmbledhur, posaçërisht për NSH-të; ose një ndërthurje e të gjithave sa më lart.

Në “Udhëzimet e OECD-së për drejtimin e brendshëm të ndërmarrjeve shtetërore” (2024) rekomandohet që NSH-të e kontrolluara nga qeveria *“të respektojnë standardet e larta të transparencës, llogaridhënies dhe paprekshmërisë dhe të jenë objekt i të njëjtave standarde cilësore të kontabilitetit, dhënies së informacioneve shpjeguese, përmbushjes dhe auditimit, si shoqëritë e listuara në bursë. Njësia ekonomike pronare rekomandohet të zhvillojë raportim të njëtrajtshëm për NSH-të dhe të publikojë çdo vit një raport përmbledhës për NSH-të, për pikat me rëndësi materiale, përfshirë informacione në lidhje me qëndrueshmërinë, aspektet e drejtimit të brendshëm, si dhe për arritjen e objektivave të politikës publike. Informacionet të japin një pamje të plotë, të qartë dhe të besueshme të portofolit të NSH-ve dhe të jenë cilësore, të krahasueshme, koncize dhe të arritshme nga publiku, përfshirë përmes komunikimeve digjitale.”*

Si organizata të mëdha komplekse me marrëdhënie dhe interesa shumëdimensionale, shumica e të cilave janë të lidhura me realizimin e shërbimeve publike, NSH-të duhet të ndjekin parimet e zakonshme të MFP-së:

- ▶ Llogaridhënie dhe transparencë – përfshirë përdorimin e standardeve ndërkombëtare me të drejta dhe detyrime të konstatuara si SNRF-të, me informacion financiar të krahasueshëm dhe transparent, që të jetë i plotë, i besueshëm, aktual, përkatës dhe cilësor, si dhe të jetë i arritshëm dhe i kuptueshëm.
- ▶ Menaxhim financiar – që identifikon informacion të saktë, për shembull për aktivet dhe detyrimet afatshkurtra dhe afatgjata, administrimin e rreziqeve, proceset vendimmarrëse dhe informacion të mjaftueshëm për të treguar forcën rezistuese financiare.
- ▶ Informacione mbi ecurinë – mbështetur në të dhëna financiare dhe operative të gjithanshme dhe të njëtrajtshme, që identifikojnë përdorimin e burimeve dhe realizimin e shërbimeve.

NSH-të me madhësi të konsiderueshme duhet të trajtohen si njësi ekonomike me interes publik. Kërkesat duhet të përfshijnë raportimin financiar, idealja do të ishte sipas SNRF-ve, SNKSP-ve (për NSH-të më të orientuara nga ofrimi i shërbimeve) ose sipas standardeve përkatëse të vendit; standardet e raportimit të qëndrueshmërisë; kryerjen e auditimeve vjetore dhe publikimin e pasqyrave financiare të audituara; dhe vënien në zbatim të drejtimit të brendshëm të shoqërisë njësoj si shoqëritë tregtare të

sektorit privat, përfshirë këshillin e administrimit (në nivel funksional), këshillin e mbikëqyrjes dhe komitetin

e auditimit me njohuri teknike dhe autonominë e duhur.

Kutia 9. Shembuj të organizimit të raportimit financiar të NSH-ve

BULLGARIA

Në Bullgari ka 265 ndërmarrje publike shtetërore (në fund të vitit 2021). Ekziston një pasqyrë vjetore e veçantë¹⁷ posaçërisht për NSH-të me vlerë totale 26850 milionë BGN.

SUEDIA

Qeveria është pronare plotësisht ose pjesërisht e 43 NSH-ve me vlerë totale të portofolit prej 850 miliardë SEK. Një pasqyrë vjetore e veçantë¹⁸ për NSH-të publikohet nga Zyrtar Qeveritare të Suedisë.

ZELANDA E RE

Informacionet financiare që tregojnë të ardhurat, shpenzimet, aktivet, detyrimet dhe kapitalin neto në lidhje me segmentin e NSH-ve (që mbulon njësitë ekonomike të kontrolluara dhe me pjesëmarrje të vogël) përfshihet në pasqyrat financiare të konsoliduara të qeverisë. Shih **Shtojcën 5** për një shembull.

BRITANIA E MADHE

Organet në pronësi të qeverisë konsolidohen në pasqyrat e dikasterit ku bëjnë pjesë, për shembull, "Autostradat Kombëtare" (përgjegjëse për rrjetin rrugor strategjik) konsolidohet në Ministrinë e Transportit.

KINA


Pas reformës së NSH-ve dhe konsolidimit, ka mbi 200 mijë NSH në Kinë në nivel qendror dhe vendor, duke përfshirë filialet dhe ndërmarrjet shumëkombëshe që investojnë në tregjet e reja në mbarë botën. 98 NSH-të qendrore dhe mijëra filialet e tyre janë ato që bien në sy, që ushtrojnë aktivitet në sektorë vendimtarë si sektori bankar, energjetika, transporti, telekomunikacioni, mjekësia dhe ushqimi e bujqësia. Këta sektorë zënë 70% të të ardhurave të NSH-ve qendrore. Autoriteti shtetëror (Komisioni i Mbikëqyrjes dhe Administrimit të Pasurive Shtetërore) mbikëqyr NSH-të kineze dhe shumëkombëshe (dhe publikon infografikë në anglisht me pikat kryesore për segmentet qendrore dhe vendore të NSH-ve) me vëmendje të veçantë të administrimi dhe monitorimi i rreziqeve, përfshirë:

Rrezikun rregullator: Të nxitur nga puna e qeverive të huaja për t'u dhënë zgjidhje kushteve të rënduara ekonomike dhe brishtësisë buxhetore, çka ka sjellë ndryshime strukturore afatgjata për të rritur të ardhurat nëpërmjet tatimit, rregullave të investimeve dhe kufizimeve tregtare. Këto ndryshime e kanë rritur barrën e përmbushjes për NSH-të shumëkombëshe.

Rrezikun digjital: Konkretisht, i lidhur me sigurinë kibernetike dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore për të dhënat. Copëzimi i rrjeteve globale në arkitektura rajonale ose kombëtare, nën ndikimin e trysisë gjeopolitike dhe ekonomike, i ndërlikon kërkesat ndërkufitare për të dhënat dhe sigurinë kibernetike. Kjo e ka ngadalësuar harmonizimin e të dhënave dhe zbatimin e rregullave të rrepta për sigurinë e të dhënave që janë specifike për vendin ose rajonin.

¹⁷ <https://appk.government.bg/upload/6451/Annual+summary+report+2021.pdf>

¹⁸ <https://www.government.se/contentassets/c598db6fe50d4d01abdeae3b6b1496ce/annual-report-for-state-owned-enterprises-2022.pdf>



PRAKTIKA E MIRË 3: KOMUNIKIMI I INFORMACIONEVE PALËVE TË INTERESIT NË MËNYRË TË HAPUR, TRANSPARENTE DHE TË ARRITSHME PËR TË RRYTUR BESIMIN NË RAPORTIMIN FINANCIAR

Gjithçka që bën qeveria, duhet të jetë në interes të publikut, çka do të thotë se publiku dhe palët kryesore të interesit janë shumë të rëndësishme. Qeveria duhet ta fitojë besimin e qytetarëve në financat publike për të cilat kontribuojnë. Publiku pret nga qeveria dhe nga institucionet përgjegjëse, siç janë ministritë e financave, të jenë transparente dhe të besueshme në lidhje me situatën buxhetore të vendit dhe mënyrën se si përdoren fondet publike (llogaridhënia, qeverisja, etika).

Qeveria duhet, po ashtu, të nxisë **përfshirjen e shoqërisë civile dhe qytetarëve** në financat publike. Kjo kërkon që qeveria të marrë masa vetë paraprakisht për të siguruar që informacionet

financiare të jenë të arritshme, të kuptueshme dhe t'i komunikohen me transparencë dhe paraprakisht publikut të gjerë dhe palëve të tjera të interesit. "Udhëzuesi si të flasim përmes të dhënave në sektorin publik"¹⁹ i Bankës Botërore jep metoda dhe shembuj se si të komunikohet informacioni i MFP-së për publikun.

TRANSPARENCA BUXHETORE

Rritja e transparencës buxhetore kërkohet gjithnjë e më shumë nga parlamentet, qytetarët, investitorët

dhe huadhënësit. Pa këtë, vendet mund të jenë të pambrojtura nga zmadhimi i reagimeve të tregut gjatë një periudhe krizash të shpeshta të jashtme. Gjithashtu, në kohë normale sektori publik nuk i korr plotësisht përfitimet e efikasitetit të ofruara nga përparimet e teknologjisë informatike në mungesë të një strukture transparence buxhetore të mirë-menduar dhe të proceseve që e zgjerojnë kontrollin mbikëqyrës parlamentar dhe mobilizojnë kontributin e qytetarëve dhe shoqërisë civile.

Një transparencë buxhetore moderne kërkon dhënien e informacioneve të plota, të besueshme, aktuale, përkatëse dhe cilësore për financat publike të vendit. Kjo kontribuon në llogaridhënien publike duke i bërë më të arritshme dhe të kuptueshme informacionet e qeverisë. Transparenca buxhetore mund të kontribuojë në administrimin dhe llogaridhënien efektive dhe efikase buxhetore dhe mund të fuqizojë besueshmërinë e planeve ekonomike dhe buxhetore të vendit, duke mbështetur besimin e tregut dhe perceptimet e tregut për aftësinë paguese buxhetore.

Transparenca kërkon komunikim të dyanshëm të informacioneve të rëndësishme. Duhet shmangur situata ku qeveria jep lloj-lloj informacionesh, gjoja për të bërë rritje të transparencës, kur këto të dhëna janë kryesisht të pakuptueshme ose të padukshme për shumë palë interesi. Faktorë shumë të rëndësishëm janë forma e paraqitjes, koha dhe përdorimi i të dhënave. Duke qenë se përpilimi dhe raportimi i informacioneve financiare mund të bien pre e politizimit dhe mosveprimit, duhen pasur mekanizma të pavarur për të zbutur rreziqet e krizës ekonomike apo krizës financiar dhe të krizave të borxhit.

“Kodi i praktikave të mira transparencën buxhetore” (FMN) i botuar në 2007, thekson nevojën për qartësim të roleve dhe përgjegjësi, për procese të hapura buxhetore, për informacione në dispozicion të publikut dhe për dhënie të sigurisë mbi paprekshmërinë e informacionit (shih **Figurë 2** më poshtë).

Figura 2. Praktikave të mira për transparencën buxhetore²⁰

QARTËSI E ROLEVE DHE PËRGJEGJËSIVE

Role dhe përgjegjësi të identifikuar qartë për qeverinë – rolet për politikën dhe administrimin duhet të jenë të qarta dhe të tregohen publikisht

Kuadër ligjor rregullator dhe administrativ i qartë dhe transparent për administrimin buxhetor

PROCESE BUXHETORE TRANSPARENTE

Përgatitje në kohën e duhur e buxhetit, udhëhequr nga objektiva të përcaktuar mirë të politikës makroekonomike dhe buxhetore

Procedura të qarta për zbatimin, ndjekjen dhe raportimin e buxhetit

INFORMACION NË DISPOZICION TË PUBLIKUT

Informacione të gjithanshme në dispozicion publikisht mbi veprimtaritë e shkuara, të tanishme dhe të parashikuara buxhetore dhe mbi rreziqet kryesore buxhetore

Informacionet buxhetore në dispozicion publikisht e ndihmojnë analizën e politikave dhe nxitin llogaridhënien

Informacione buxhetore të publikuara në kohën e duhur

DHËNIA SIGURIE PËR PAPREKSHMËRINË

Të dhënat buxhetore duhet të përmbushin standardet e cilësisë së të dhënave

Veprimtaritë buxhetore duhet të jenë objekt i mbikëqyrjes efektive të brendshme dhe masave mbrojtëse

Informacionet buxhetore duhet të kontrollohen nga jashtë


RAPORTI VJETOR

Është e rëndësishme të bëhet publik raportimi financiar vjetor për sektorin publik, për arsye të transparencës dhe llogaridhënies, për t'u dhënë mundësi palëve të interesit të kuptojnë se si janë përdorur paratë e tatimpaguesve dhe cilat kanë qenë rezultatet. Informacionet e hollësishme financiare duhet të dëshmojnë vendimmarrje të informuar dhe përpjekje të evidentuara drejt arritjes së prioritetëve strategjike. Raporti vjetor ofron një mundësi për vlerësimin e ecurisë dhe përbën dëshmi të administrimit të përgjegjshëm buxhetor, nëpërmjet

evidentimit të niveleve të borxhit dhe të rreziqeve financiare. Ai mund të përdoret edhe për të bërë një vlerësim krahasues.

Në publikimin e saj "Praktika e mirë për raportet vjetore",²¹ Zyra Kombëtare e Auditimit e Britanisë së Madhe përshkruan parimet e praktikës së mirë në fushat e mëposhtme organizative: strategjia, rreziqet, operacionet, drejtimi i brendshëm, treguesi matës i suksesit, rezultatet financiare dhe faktorët e jashtëm. Parimet grupohen në katër fusha kryesore: mbështetja për llogaridhënien, transparenca, arritshmëria dhe kuptueshmëria (shih Kutinë 10 më poshtë).

Kutia 10. Parimet e praktikës së mirë për raportin vjetor



²¹ Praktika e mirë për raportet vjetore, Zyra Kombëtare e Auditimit e Britanisë së Madhe, shkurt 2025, http://www.nao.org.uk/wp-content/uploads/2021/02/Good_practice_in_annual_reporting.pdf

- ▶ **Informacione jo financiare të kuptueshme:** Palët e interesit kërkojnë gjithnjë e më shumë informacione përtej financave. Organizatat duhet të komunikojnë qartë reagimin e tyre ndaj faktorëve të jashtëm që ndikojnë në to.
- ▶ **Lidhjet mes informacioneve financiare dhe jo financiare:** Tregojnë se si financat lidhen me veprimtaritë operative – dhe e mbështetin këtë me raportimin e treguesve të performancës – japin kontekstin për arritjet dhe objektivat e së ardhmes.
- ▶ **Arritshmëria:** Ofrimi i pasqyrave në formate të ndryshme dhe marrja në konsideratë e kërkesave të arritshmërisë për lexuesit përfitojnë nga përdoruesit e tyre.

PËRFSHIRJA E SHOQËRISË CIVILE DHE QYTETARËVE

Qytetarët duan të përfshihen më shumë dhe t'u dëgjohet zëri se çfarë tatimesh krijohen dhe si shpenzohen. Do të duhej që qeveritë t'i përfshinin këto palë interesi në proces, sidomos ngaqë shpesh janë ata që e dinë se çfarë po ndodh në nivel lokal. Me përparimet teknologjike dhe rritjen e përdorimit të instrumenteve digjitale, qeveritë nuk mund të thonë më se dhënia e informacioneve është shumë e vështirë ose shumë e kushtueshme. Qytetarët dhe shoqëria civile janë të gatshëm të bëjnë të tyren, e janë qeveritë ato që duhet t'ua japin këtë mundësi. Dhënia e informacioneve të sakta në kohën e duhur, krahas dhënies së mundësisë palëve të interesit të marrin pjesë dhe të japin komente, mund të jenë elemente me rëndësi të madhe të vendimmarrjes, raportimit dhe llogaridhënies së qeverisë.

Komunikimi i informacioneve financiare dhe jofinanciare të sektorit publik për publikun luan një rol të rëndësishëm në mbështetjen e mekanizmave më të hapur dhe gjithëpërfshirës të qeverisjes. Po rritet numri i qeverive që zbatojnë procese për të pasur më shumë përfshirje dhe dialog me qytetarët në mbështetje të transparencës dhe llogaridhënies.

“Raporti mbi komunikimin me publikun” i OECD-së²² thekson rëndësinë e ndarjes dhe bërjes së dallimit

ndërmjet komunikimit politik dhe komunikimit publik (sidomos në kushtet e rritjes së keqinformimit dhe mosbesimit ndaj informacionit të perceptuar si të manipuluar ose partiak). Në raport konfirmohet se vënia në dispozicion dhe dhënia e mundësisë për të përdorur burime të sakta informacionesh të verifikuara janë të domosdoshme për të mundësuar përfshirjen demokratike.

“Udhëzuesi si të flasim përmes të dhënave në sektorin publik” i Bankës Botërore²³ jep këshilla praktike dhe orientime se si të komunikohen me efektivitet informacionet mbi financat publike. Paraqitja e të dhënave duke ndërthurur informacionet financiare me përshkrime, paraqitje pamore dhe gjuhë të kuptueshme mundëson komunikim efektiv me publikun e gjerë dhe ekspertët jofinanciarë. Tregimi përmes të dhënave është hallka e munguar për shfrytëzimin më të mirë të të dhënave financiare të sektorit publik për një vendimmarrje të bazuar në informacione dhe për një realizim cilësor të shërbimeve. Zhvillimet e kohëve të fundit në fushën e teknologjisë së inteligjencës artificiale mund të ndihmojnë në zbatimin e metodave të tilla në praktikë.


Shumë qeveri po bëjnë përpjekje për të dhënë informacione financiare të dobishme dhe të arritshme publikut të gjerë dhe shoqërisë civile (shih shembullin në **Kutinë 11** më poshtë).

²² https://www.oecd.org/en/publications/oecd-report-on-public-communication_22f8031c-en.html

²³ <https://cfrr.worldbank.org/publications/data-guide>

Kutia 11. Shembuj të përpjekjeve për të përmirësuar komunikimin e informacionit financiar**MALTA**

Zyra Kombëtare e Statistikave jep informacione financiare mbi shpenzimet e qeverisjes së përgjithshme sipas funksioneve.²⁴ Të dhënat paraqiten në mënyra të ndryshme përmes disa nënndarjeve, gjë që është e dobishme për palë të ndryshme të interesit, por për qytetarët më e dobishme është nënndarja ku të dhënat paraqiten në mënyrë pamore. Informacioni mund të shkarkohet edhe në format PDF.



²⁴ <https://nso.gov.mt/public-finance/penditure-of-general-government-sector-by-function-2023/>


FRANCA

Franca ka një platformë digjitale²⁵ e cila u jep mundësi qytetarëve të konsultojnë informacionet mbi financat shtetërore në ndarje të ndryshme, për shembull të zbërthyer sipas organeve të administratës qendrore, shpenzimeve të qeverisjes vendore dhe shpenzimeve të sigurimeve shoqërore (p.sh. spitalet, sigurimet e pensionit dhe papunësisë dhe skema të tjera të sigurimeve shoqërore).

Në këtë platformë, qytetarët mund të konsultojnë në formë të hollësishme dokumentacionin e financave publike²⁶ (dokumentacioni buxhetor, pasqyrat shtetërore dhe informacione të tjera të administrimit publik). Brenda pasqyrave shtetërore për vitet 2006-2023 janë dokumente të detajuara për çdo vit. Informacioni i vitit 2023²⁷ jep pasqyra të hollësishme financiare dhe një përmbledhje me katër faqe me përmbledhje të pikave kryesore.

Paneli informues mbi pasqyrat financiare shtetërore²⁸

Kontabiliteti i përgjithshëm mbahet mbi bazën me të drejta dhe detyrime të konstatuara, domethënë duke ia ngarkuar shpenzimet dhe të ardhurat vitit ushtrimor kur kanë lindur, pavarësisht datës së pagesës apo arkëtimit. Kontabiliteti i përgjithshëm mundëson ndjekjen e ndryshimeve të vlerës së aktiveve dhe borxhit të shtetit. Ka mbi 10 vjet, kontabiliteti i përgjithshëm ndihmon për dhënien e një pamjeje të vërtetë e të drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të shtetit. Nëpërmjet mbështetjes dhe plotësimit të kontabilitetit buxhetor dhe atij kombëtar, kontabiliteti i përgjithshëm e pasuron analizën dhe transparencën e gjendjes financiare të shtetit dhe zhvillimin e saj me kalimin e kohës.




²⁵ https://www.budget.gouv.fr/reperes/comptes_etat/articles/comptes-de-letat-2023

²⁶ <https://www.budget.gouv.fr/budget-etat>

²⁷ <https://www.budget.gouv.fr/documentation/comptes-de-letat/comptes-de-letat-2023>

²⁸ Burimi: *Datavisualisation des comptes de l'Etat* | Tableau Public

<https://public.tableau.com/app/profile/dtnum.open.data/viz/DatavisualisationdescomptesdelEtat/Accueil>



PRAKTIKA E MIRË 4: PËRFSHIRJA E ZHVILLIMEVE TË REJA NË RAPORTIMIN E SEKTORIT PUBLIK

Krahas përmirësimit të MFP-së dhe raportimit financiar për prioritetet aktuale buxhetore, një sistem modern i kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara dhe transparencës buxhetore siguron bazën për zhvillimet dhe tendencat e reja në raportimin financiar dhe jofinanciar dhe raportimin e rezultateve. Këtu përfshihen:

- ▶ **Raportimi i qëndrueshmërisë dhe planifikimi i gjelbër i buxhetit** – Qeveritë duhet të kenë strategji, sisteme dhe procese për të njohur dhe trajtuar vështirësitë e lidhura me klimën.
- ▶ **Planifikimi buxhetor me bazë gjinore** – Qeveritë duhet të fuqizojnë dhe mbështesin një harmonizim më të mirë të buxheteve kombëtare me objektivat e përfshirjes sociale.
- ▶ **GovTech** – Qeveritë duhet të ruajnë ritmin dhe të përfitojnë nga ndryshimet e shpejta të teknologjisë informatike.

RAPORTIMI I QËNDRUESHMËRISË

Çështjet e qëndrueshmërisë mund të kenë ndikim të ndjeshëm në financat publike, çka përputhet me interesin publik për transparencë dhe llogaridhënie të veprimeve të qeverisë. Rritja e ndërgjegjësimit për çështjet mjedisore dhe sociale e rrit kërkesën për informacion mbi qëndrueshmërinë nga palë të ndryshme interesi, përfshirë huadhënësit, investitorët, politikëbërësit, qytetarët dhe akademikët. Qytetarët duan të dinë se si po i pakëson çlirimet e gazit karbonik qeveria, nëpërmjet investimit në teknologjitë e gjelbra, zbutjes dhe përshtatjes ndaj rreziqeve klimatike, ruajtjes dhe rivendosjes së mjedisit natyror dhe rritjes së rendimentit energjetik dhe praktikave të administrimit të mbetjeve. Për shembull, interes mund të ketë për mënyrën si përdoren fondet e mbledhura

nga gjobat dhe tarifat mjedisore (të tilla si sistemet e tregtimit): për investime të gjelbra të padëmshme për mjedisin ose të përthithura në shpenzimet buxhetore periodike. Qytetarët dhe grupet e mbrojtjes së interesave mund ta përdorin raportimin e qëndrueshmërisë për të ndjekur ecurinë e qeverisë në nismat dhe për t'i kërkuar llogari. Investitorëve mund t'u interesojnë praktikatat e qëndrueshmërisë të njësive ekonomike të sektorit publik për të vlerësuar qëndrueshmërinë afatgjatë të obligacioneve dhe kredive shtetërore.

Raportimi i qëndrueshmërisë dhe planifikimi i gjelbër buxhetor në sektorin publik kanë rëndësi për trajtimin e sfidave mjedisore dhe sociale. Prej njësive ekonomike të sektorit publik pritet të japin informacion mbi rezultatet e lidhura me ndryshimet klimatike dhe ecurinë drejt Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së. Në qoftë se përdorin udhëzuesit ndërkombëtarë dhe bëjnë harmonizim me standardet globale, atëherë kjo u jep mundësi të japin informacion gjithëpërfshirës, transparent dhe llogaridhënës për qëndrueshmërinë.

Nuk ka ende një kornizë të njohur botërisht për hartimin dhe dhënien e informacioneve të lidhura me qëndrueshmërinë për sektorin publik. Kjo ka sjellë mospërputhje në raportimin dhe zhvillimin e kornizave dhe praktikave të ndryshme të raportimit, madje edhe brenda vendeve. Duke njohur nevojën e ngutshme për përgatitje të udhëzuesve mbi raportimin e qëndrueshmërisë në sektorin publik, Bordi Ndërkombëtar i Standardeve të Kontabilitetit të Sektorit Publik (BSNKSPP) ka hartuar standardin e parë të raportimit të qëndrueshmërisë për sektorin publik (SRQ). Projekt-paraqitja SRQ 1 "Dhënia e informacioneve shpjeguese në lidhje me klimën" u publikua në tetor 2024. Në të propozohen kërkesa për dhënie të informacionesh shpjeguese nga njësitet ekonomike të sektorit publik në lidhje me (i) rreziqet dhe mundësitë e lidhura me klimën për operacionet e veta dhe (ii) programet e politikave publike të lidhura me klimën dhe rezultatet e tyre, çka i ndihmon përdoruesit kryesorë të pasqyrave financiare të përgjithshme të marrin vendime dhe të kërkojnë llogari. Qëllimi është të ndihmohen njësitet ekonomike të sektorit publik të raportojnë mbi planet e veprimit për klimën dhe progresin, për të siguruar qëndrueshmëri, krahasueshmëri, transparencë dhe llogaridhënie. Krahas kësaj, informacionet për qëndrueshmërinë u japin mundësi palëve të interesit të kuptojnë rrjedhojat financiare të nismave dhe rreziqeve të qëndrueshmërisë, të tilla si zvogëlimet e kostove në projektet e efikasitetit të energjisë

dhe identifikimi i rreziqeve të lidhura me klimën. BSNKSPP-ja ka shtuar shembuj mbi qëndrueshmërinë në "Udhëzimet e praktikës së rekomanduar për raportimin mbi qëndrueshmërinë afatgjatë të financave të njësive ekonomike".

Gjatë periudhës kalimtare deri në publikimin e SRQ-së, sektori publik mund për të përdorë kuadrin e raportimit të qëndrueshmërisë të sektorit privat, që ofron një qasje të strukturuar për raportimin mbi faktorët mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes, siç janë Nisma Globale e Raportimit, udhëzimet e Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Qëndrueshmërisë ose Standardet Evropiane të Raportimit të Qëndrueshmërisë (SERQ), për të përmbushur nevojat e veçanta të njësive ekonomike shtetërore dhe të vendeve të ndryshme.

Direktiva e BE-së për Raportimin e Qëndrueshmërisë të Shoqërive Tregtare u kërkon shoqërive të mëdha (përfshirë NSH-të) të përdorin SERQ-të. Këto kërkesa synojnë të rrisin transparencën, qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë e informacioneve të qëndrueshmërisë në të gjithë BE-në. Shoqëritë tregtare duhet të zbatojnë parimin e materialitetit të dyfishtë dhe të raportojnë për ndikimin në mjedis dhe në shoqëri të veprimtarive të tyre, ashtu edhe se si çështjet e qëndrueshmërisë ndikojnë në biznesin e tyre. SERQ përfshin si të detyrueshme katër shtyllat e Task Forcës për Dhënien e Informacioneve Financiare të Lidhura me Klimën (drejtimi i brendshëm, strategjia, administrimi i rreziqeve, treguesit matës dhe objektivat) dhe përfshin këto kërkesa shtesë nëse kanë rëndësi materiale:

► Mjedisore

- Ndryshimi i klimës
- Ndotja
- Ujërat
- Larmia biologjike
- Burimet dhe ekonomia qarkore

► Sociale

- Fuqia e vet punëtore
- Punonjësit në treguesit matës të zinxhirit të vlerës
- Treguesit matës për konsumatorët dhe për përdoruesit fundorë
- Treguesit matës për bashkësitë e prekura

► Drejtimi i brendshëm (qeverisja)

- Sjellja e veprimtarisë afariste

PLANIFIKIMI BUXHETOR I GJELBËR


Kalimi drejt bilancit zero të çlirimeve të gazeve karbonike kërkon investime të konsiderueshme private dhe publike. Qeveritë duhet të mendojnë si të mobilizohet ky investim në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë dhe të sigurojnë që të identifikohen dhe administrohen mirë mundësitë dhe rreziqet financiare. Instrumentet e planifikimit të gjelbër buxhetor mund të mbështesin vendimmarrjen për politikën në arritje të objektivave mjedisore dhe klimatike. Kjo përfshin vlerësimin e ndikimit mjedisor të politikave buxhetore dhe analizën e ndikimit të tyre në përmbushjen e angazhimeve kombëtare dhe ndërkombëtare. Planifikimi i gjelbër buxhetor mund të kontribuojë edhe në një debat dhe diskutim të mbështetur në informacione dhe në prova mbi rritjen e qëndrueshme.

Planifikimi i gjelbër buxhetor duhet të integrohet në kuadrin ekzistues të MFP-së të vendit dhe të harmonizohet me procesin ekzistues të planifikimit buxhetor. Për shembull, objektivat mjedisore dhe klimatike mund të integrohen në sistemin e

planifikimit buxhetor të mbështetur në rezultate. Aty ku proceset e shqyrtimit të shpenzimeve janë të forta, mund të ketë një fokus më të madh në matjen e objektivave të efikasitetit në lidhje me objektivat klimatike. (Shih edhe botimin PULSAR-it “Karakteristikat e njësive ekonomike të sektorit publik dhe njësive raportuese për raportimin e qëndrueshmërisë”).²⁹

Vendet po i përdorin gjithnjë e më shumë praktikën e planifikimit të gjelbër buxhetor. Komuniteti Bashkëpunues i Parisit për Planifikim të Gjelbër Buxhetor i OECD-së ofron udhëzime praktike për t’i ndihmuar qeveritë të marrin në konsideratë objektiva klimatike dhe mjedisore brenda kornizave të tyre buxhetore. Në faqen në internet të OECD-së për planifikimin e gjelbër buxhetor³⁰ jepet një larmi metodash dhe instrumentesh për politikën e planifikimit të gjelbër buxhetor. Disa vende të OECD-së kanë vënë në zbatim planifikimin e gjelbër buxhetor për të informuar vendimmarrjen politike, për të udhëhequr shpërndarjen e fondeve të buxhetit gjatë negociatave për planifikimin buxhetor dhe për të mbështetur vendosjen e prioritetëve të shpenzimeve kapitale dhe e kanë përdorur planifikimin e gjelbër buxhetor për të gjitha kriteret e politikave publike.

Figura 3. Katër elementet kryesore të Kornizës së planifikimit të gjelbër buxhetor të OECD-së³¹



²⁹ <https://cfr.worldbank.org/publications/characteristics-public-sector-entities-and-reporting-entity-sustainability-reporting>

³⁰ <https://www.oecd.org/en/topics/sub-issues/green-budgeting.html>

³¹ Burimi: Planifikimi i gjelbër buxhetor, OECD: [https://one.oecd.org/document/GOV/SBO\(2024\)2/en/pdf](https://one.oecd.org/document/GOV/SBO(2024)2/en/pdf)

Kutia 12. Shembuj të vendeve në lidhje me planifikimin e gjelbër buxhetor**AUSTRALIA**

Qeveria australiane ka një Strategji Kombëtare të Forcës Rezistuese dhe Përshtatjes ndaj Klimës,³² ku ka përcaktuar tre objektiva kryesorë:

1. Mbështetja e investimeve dhe veprimeve me anë të bashkëpunimit
2. Përmirësimi i informacioneve dhe shërbimeve të lidhura me klimën
3. Analizimi i progresit dhe përmirësimi me kalimin e kohës

Në kuadër të detyrimit që rrjedh nga Ligji për Ndryshimet Klimatike i vitit 2022, qeveria publikon një Pasqyrë Vjetore për Ndryshimet Klimatike.³³ Në të raportohet për:

- ▶ ecurinë e bërë gjatë vitit për arritjen e objektivave për pakësimin e çlirimeve të gazeve serrë
- ▶ zhvillimet ndërkombëtare gjatë vitit, që kanë rëndësi për trajtimin e ndryshimeve klimatike
- ▶ politikën për ndryshimin e klimës
- ▶ efektivitetin e politikave të Komonuelthit për arritjen e objektivave të pakësimit të çlirimeve të emetimeve të gazeve serrë në Australi dhe pakësimin e çlirimeve në sektorët e mbuluar nga këto politika
- ▶ ndikimin e politikave të Komonuelthit për ndryshimin e klimës në arritjen e objektivave të Australisë për pakësimin e çlirimeve të gazeve serrë në Australinë rurale dhe rajonale, përfshirë përfitimet në nivel shoqëror, në punësim dhe në formën e përfitimeve ekonomike që rrjedhin nga këto politika në Australinë rurale dhe rajonale
- ▶ rreziqet që i vijnë Australisë nga ndikimet e ndryshimeve klimatike, siç janë ato që lidhen me mjedisin, larminë biologjike, shëndetësinë, infrastrukturën, bujqësinë, investimet, ekonominë ose sigurinë kombëtare të Australisë.

Megjithëse në pasqyrat e konsoliduara vjetore 2023 përfshihen informacione të kufizuara të performancës ose informacione shpjeguese mbi ndryshimet klimatike, autoriteti i pavarur për ndryshimet klimatike (Ministria për Ndryshime Klimatike, Energjetikë, Mjedis dhe Ujërat)³⁴ publikoi një Vlerësim Kombëtar të Rreziqeve Klimatike,³⁵ në mars 2024, ku jepet një analizë e shpejtë cilësore për të identifikuar rreziqet e rëndësishme dhe prioritare në nivel kombëtar.

FRANCA

Prej vitit 2020, Franca përfshin një komponent të gjelbër në përgatitjen e buxhetit të shtetit. Qeveria publikon raportin vjetor të gjelbër si shtojnë e projektligjit për financat, ku rendit të gjitha shpenzimet që kanë ndikim të favorshëm, të pafavorshëm, neutral, të përzier ose të papërcaktuar në mjedis.

Një grup pune i caktuar nga qeveria analizon ndikimin mjedisor të çdo mase në buxhet në kuadër të shpenzimeve shtetërore dhe shpenzimeve fiskale kundrejt gjashtë objektivave mjedisorë:

- ▶ lufta kundër ndryshimit të klimës
- ▶ përshtatja me ndryshimet klimatike dhe parandalimi i rreziqeve natyrore

³² <https://www.dccew.gov.au/climate-change/policy/adaptation/strategy>

³³ <https://www.dccew.gov.au/climate-change/strategies/annual-climate-change-statement-2023>

³⁴ <https://www.dccew.gov.au/>

³⁵ <https://www.dccew.gov.au/sites/default/files/documents/national-climate-risk-assessment-first-pass-assessment-report-2024.pdf>

- ▶ administrimi i burimeve ujore
- ▶ kalimi drejt ekonomisë qarkore, administrimi i mbetjeve dhe parandalimi i rreziqeve teknologjike
- ▶ lufta kundër ndotjes
- ▶ ruajtja e larmisë biologjike dhe mbrojtja e zonave natyrore, bujqësore dhe pyjore

Të dhënat publikohen çdo vit. Për vitin 2024, gjenden këtu:

www.budget.gouv.fr/reperes/budget_vert/articles/plf-2024-la-4eme-edition-du-budget-vert


NORVEGJIA

Duke qenë një prej vendeve me qëndrueshmërinë më të lartë mjedisore, "Plani kombëtar për transportin, 2022 -2023"³⁶ i Norvegjisë thekson nismat për një sistem transporti efikas, të padëmshëm për mjedisin dhe të sigurt deri në vitin 2050. Në të jepet një strategji e gjithanshme për përmirësimin e sistemit të transportit të Norvegjisë duke u përqendruar në efikasitetin, qëndrueshmërinë mjedisore dhe parrezikshmërinë. Aty theksohet përdorimi i teknologjive të reja, si automatizimi dhe elektrifikimi, për rritjen e përdorimit të transportit dhe për pakësimin e çlirimit të gazeve serrë. Plani jep një pasqyrë të shpenzimeve totale të shpërndara sipas llojit të transportit. Raporti vjetor i qeverisë Norvegjeze jep informacione krahasuese të Ministrisë së Transportit në një shënim të pasqyrave financiare.

BRITANIA E MADHE

Në Britaninë e Madhe, një shënim shpjegues poshtë pasqyrave financiare të qeverisjes si e tërë 2021/22 evidenton kërkesat për dikasteret e qeverisjes qendrore të Britanisë së Madhe dhe për institucionet e vartësisë në lidhje me çlirimet e gazeve serrë.³⁷ Dikastereve u kërkohet të publikojnë raporte të qëndrueshmërisë më vete si pjesë e pasqyrave vjetore ose si relacione të veçanta ku tregohet ecuria drejt objektivave të veçantë. Nisma e Angazhimeve të Gjëlbra të Qeverisë³⁸ përshkruan kërkesat e raportimit për veprimet që ndërmarrin dikasteret dhe institucionet e varësisë për të zvogëluar ndikimin e tyre në mjedis për periudhën 2021-2025.

Tabela 1.VV: Ecuria e AGjQ-ve kundrejt objektivave

Angazhimi i Gjëlbrë i Qeverisë	Plani 2020-2021	Ecuria nga 2001-10 në 2020-21	Ecuria 2020-2021	Rezultati
Gazet serrë	Zvogëlimi i çlirimeve të gazeve serrë me së paku 43%		Pakësim 57%	Tejkalim plani
Fluturimet brenda vendit	Pakësimi i numrit të fluturimeve brenda vendit me së paku 30%		Pakësim 96%	Tejkalim plani
Mbetjet në vend-depozitim	Pakësimi i sasisë së mbetjeve që shkojnë vend-depozitim të mbetjeve në më pak se 10%		8% e mbetjeve shkojnë në landfill	Tejkalim plani
Konsumi i letrës	Pakësimi i përdorimit të letrës nga shteti me së paku 50%		Pakësim 80%	Tejkalim plani
Ujërat	Të vijohet pakësimi i konsumit të ujit		Pakësim 14%	Objektivi u arrit

³⁶ <https://www.regjeringen.no/en/dokumenter/national-transport-plan-2022-2033/id2863430/?ch=6>

³⁷ https://assets.publishing.service.gov.uk/media/6601a433f1d3a0666832ad02/WGA_2021-22_Final_for_publication.pdf

³⁸ <https://www.gov.uk/government/publications/greening-government-commitments-2021-to-2025>

Britania e Madhe ka krijuar një ministri të re për sigurinë energjetike dhe ndikim neto zero, që ka përgjegjësinë për portofolin energjetik. Në objektivat afatgjatë të kësaj ministrie përfshihen siguri i funksionimit të duhur të tregjeve energjetike, bashkërendimi i objektivave për ndikim neto zero të gjithë qeverisë dhe përdorimi i ekspertëve të jashtëm në mbështetje të projekteve të saj madhore.

ZVICRA

Raporti i Qëndrueshmërisë Buxhetore për Zvicrën (2024)³⁹ thekson nevojën për të vepruar në politikat ekonomike dhe buxhetore dhe përfshin çmuarjen e parë sasiore të ndikimit afatgjatë që ndryshimet klimatike kanë në financat publike.

Ligji Federal për Novacion dhe Mbrojtje Klimatike e angazhon Zvicrën që të bëhet arrijë ndikim neutral në klimë brenda vitit 2050. Masat e mbrojtjes klimatike në Zvicër ndikojnë në të ardhurat dhe shpenzimet publike drejtpërdrejt dhe tërthorazi, përfshirë në nivelet federale, kantonale dhe komunale. Ndikimet kryesore përfshijnë pakësimin e të ardhurave nga tatimet mbi naftën dhe nga taksa e dyoksidit të karbonit, si dhe shpenzimet publike për programet e ndërtimit në nivel federal dhe kantonal. Në vitin 2021, nga këto masa u prekën rreth 71% e të ardhurave të zakonshme shtetërore dhe 75% e shpenzimeve të zakonshme.

PLANIFIKIMI BUXHETOR ME BAZË GJINORE

Planifikimi buxhetor me bazë gjinore shkon përtej aspekteve financiare, sepse është një pasqyrë e prioriteteve të vendit për diversitetin dhe përfshirjen, pa harruar eliminimin e shtrembërimeve gjinore nga proceset dhe instrumentet kryesore të qeverisë. Puna e gjerë e qeverisë gërsheton të menduarit në aspektet

gjinore me një qasje më të gjerë strategjike, përfshirë vendimet ligjore, rregullatore, politike, buxhetore dhe financiare. Kjo duhet të sjellë përmirësime të sistemeve, proceseve dhe instrumenteve publike për të arritur objektivat e barazisë gjinore. Përgatitja buxhetore me bazë gjinore ndihmon në identifikimin e prioriteteve, për shembull për të zvogëluar ose mbyllur hendekun gjinor të pagave në tregun e punësimit.

Kutia 13. Shembuj të vendeve në lidhje me planifikimin buxhetor me bazë gjinore

KANADAJA

Qeveria Kanadeze, në kuadër të procesit të planifikimit buxhetor, publikon një "Pasqyrë dhe raport mbi ndikimet në barazinë gjinore, diversitetin dhe cilësinë e jetës".⁴⁰ Informacionet e hollësishme në këtë pasqyrë përfshijnë analizën e treguesve dhe arritjeve të kuadrit të rezultateve gjinore në fusha të tilla si objektivat e barazisë gjinore për Kanadanë, përfshirë një shënim mbi metodikën.

UKRAINA

Në 2013-2020 Ministria e Financave e Ukrainës udhëhoqi një nga projektet më të mëdha botërore për planifikimin buxhetor me bazë gjinore. U analizuan mbi 300 programe buxhetore në nivel shtetëror dhe vendor dhe shumë prej tyre u ndryshuan për të qenë më të mbështetur mbi një bazë gjinore.

³⁹ <https://www.efd.admin.ch/en/fiscal-sustainability-report#First-quantitative-estimate-of-the-impact-of-climate-protection-measures>

⁴⁰ <https://www.budget.canada.ca/2023/pdf/gdql-egdqv-2023-en.pdf>

Si rezultat dolën një sërë rekomandimesh dhe propozimesh për strategji për të siguruar që politikat shtetërore të përfshijnë burime të mjaftueshme për të nxitur dhe arritur objektivat e barazisë gjinore dhe se metodikat buxhetore me bazë gjinore të jenë zhvilluar dhe zbatuar (përfshirë ndjekjen dhe vlerësimin e politikave buxhetore nga perspektiva gjinore) në të gjitha nivelet.

UN Women ka një instrument të thjeshtë (të përdorur në Projektin e Ukrainës) që mund të përdoret për të kryer analizën, “Planifikim i buxhetor me bazë gjinore: analiza e programeve buxhetore nga perspektiva gjinore”.⁴¹

ZGJIDHJET GOVTECH NË RAPORTIMIN FINANCIAR

Qeveritë duhet të ecin me hapin e shpejtë të novacionit në teknologjinë informatike, për t’u larguar nga proceset në letër e për të adoptuar teknologjinë e fundit dhe proceset e lidhura me to për të mundësuar progresin, për të mbështetur projektet e infrastrukturës dhe për të nxitur efikasitetin. Me rritjen e përdorimit të teknologjisë, është gjithashtu e rëndësishme t’u jepet qytetarëve infrastruktura digjitale e përditësuar për të marrë informacionet dhe shërbimet e qeverisë dhe të kuptohet se mundësitë e shumta teknologjike mund të sjellin rreziqe të reja dhe pritje më të mëdha shoqërore, të cilat qeveritë duhet të jenë të gatshme të trajtojnë.

GovTech (shkurt, në anglishte, për teknologjinë shtetërore) është një qasje e qeverisë si e tërë për

modernizimin e sektorit publik. Kjo rrit kapacitetet dhe aftësitë brenda qeverisë për të qenë në të njëjtin nivel me sektorin privat. Me një bazë të fortë teknologjike, zgjidhjet që fokusohen te qytetari dhe që orientohen drejt tyre mund të zhvillohen në mënyrë më efektive, për të ofruar shërbime publike të arritshme dhe për të nxitur rezultate më të mira të qeverisjes. Automatizimi i pagesave buxhetore, për shembull, mund të rritë cilësinë e administrimit të buxhetit dhe adoptimi i një platforme prokurimi elektronik mund të rritë transparencën buxhetore.

Në lidhje me raportimin financiar në nivel vendi, FMN-ja thekson se *“Përshtatja digjitale nga qeveritë ka potencialin për të fuqizuar operacionet e financave publike dhe për të përmirësuar realizimin e shërbimeve bazë. Zgjidhjet GovTech në administrimin e të ardhurave buxhetore mund të rrisin ndjeshëm mbledhjen e të ardhurave.”*⁴²

Kutia 14. Shembuj të vendeve në lidhje me novacionet GovTech

AUSTRALIA

Qeveria australiane ka zhvilluar një portal për transparencën⁴³ – një bazë qendrore të dhënash të raporteve dhe informacioneve që gjenden publikisht për të gjitha subjektet e Komonuelthit. Në të, publiku, parlamenti dhe të gjitha palët e interesit mund të konsultojë informacionet. Në të përfshihen informacione për buxhetin e qeverisë dhe ka një faqe me raportet financiare matematikore⁴⁴ ku mund të shihet qëndrueshmëria financiare e çdo njësie ekonomike (të sektorit publik a privat) (mbështetur në informacionet financiare të ngarkuara për secilën njësi ekonomike). Ka edhe informacione jofinanciare.

⁴¹ <https://www.efd.admin.ch/en/fiscal-sustainability-report#First-quantitative-estimate-of-the-impact-of-climate-protection-measures>

⁴² Material i FMN-së: “Transformimi i Financave Publike nëpërmjet GovTech-ut, <https://www.elibrary.imf.org/view/journals/006/2023/004/article-A001-en.xml>

⁴³ <https://www.transparency.gov.au/about>

⁴⁴ <https://www.transparency.gov.au/financial-ratios>

SINGAPORI

Vizioni i Singaporit për një qeveri digjitale⁴⁵ synon t'u shërbejë qytetarëve përmes hartimit të politikave dhe shërbimeve që janë gjithëpërfshirëse, pa probleme dhe të personalizuar për të gjithë. Digjitalizimi i shërbimeve shtetërore, përfshirë zhvillimin dhe përdorimin e teknologjive dhe aftësive digjitale në të gjithë Singaporin, nxit përfshirjen digjitale, duke rregulluar paralelisht të dhënat dhe aktivitetet online dhe duke fuqizuar sigurinë digjitale. Financohet me grant nga Fondi Kombëtar i Kërkimit dhe informacionet financiare përfshihen në shënimet shpjeguese të pasqyrës së Fondit Kombëtar të Kërkimit si pjesë e pasqyrave financiare të qeverisë së Singaporit për vitin ushtrimor 2022/23.⁴⁶


Diagrami 1: Çfarë do të thotë të jesh “digjital deri në bërthamë” brenda shërbimit publik të Singaporit⁴⁷



⁴⁵ <https://www.smartnation.gov.sg/vision/>

⁴⁶ Faqe 65: https://www.agd.gov.sg/files/Publications/fy2022_government_financial_statements.pdf

⁴⁷ Burimi: https://www.smartnation.gov.sg/files/publications/dgb-public-document_30dec20.pdf



PËRFUNDIM: VËNIA NË ZBATIM E PRAKTIKAVE TË MIRA TË RAPORTIMIT FINANCIAR NË SEKTORIN PUBLIK

Praktikat e mira të përshkruara më sipër mund të çojnë në reforma që përmirësojnë raportimin financiar në sektorin publik për:

- ▶ **Çuarjen përpara të interesit publik** – gjithçka që bën një qeveri prek interesin e publikut, çka do të thotë se publiku dhe palët kryesore të interesit janë shumë të interesuara. Qytetarët presin që qeveritë të krijojnë sisteme, procedura dhe mbikëqyrje efektive që rritin besimin për të dhënat financiare që raportohen. Ata presin edhe që qeveritë të jenë transparente në lidhje me situatën buxhetore dhe mënyrën se si përdoren fondet publike (llogaridhënia, qeverisja, etika).
- ▶ **Përmirësimin e qeverisjes, politikave dhe kontrollit** – duhet të ketë politika transparente, struktura të qarta, përfshirë parlamentin, komisionet parlamentare dhe njësitë e kontrollit,

për t'u kërkuar llogari dikastereve, krahas auditimit të brendshëm dhe të jashtëm dhe dhënësve të sigurisë.

- ▶ **Ngritjen e proceseve të besueshme të buxhetit dhe raportimit financiar** – sistemet dhe proceset duhet të sigurojnë hartimin e të dhënave dhe informacioneve financiare cilësore dhe të verifikueshme për të dhënë qartësi mbi gjendjen e financave publike, burimeve publike dhe realizimin e shërbimeve publike.
- ▶ **Nxjerrjen e informacioneve cilësore dhe të besueshme** – informacioni i nxjerrë duhet të jetë i plotë, përkatës, cilësor dhe i besueshëm për të vlerësuar ndikimin financiar të politikave shtetërore dhe përdorimin e burimeve dhe për një administrim dhe vendimmarrje më të mirë mbi politikat.

- ▶ **Mundësimin e konsultimit të informacioneve** – palët e interesit, sidomos qytetarët tatimpagues, duhet të jenë në gjendje të konsultojnë informacionet në formë të kuptueshme dhe në kohë. Për të përmbushur nevojat e qytetarëve duhet menduar zhvillimi i instrumenteve digjitale dhe ndërvepruese të raportimit.

Zbatimi i praktikave të mira për raportimin financiar në sektorin publik kërkon një strukturë të përgjithshme koherente projekti, përfshirë rolet dhe përgjegjësitë, autoritetin vendimmarrës, politikat dhe procedurat e hollësishme, linjat e raportimit dhe proceset e qeverisjes. Strategjia e projektit duhet të sigurojë:⁴⁸


- ▶ një kornizë legjislative dhe llogaridhënieje
- ▶ një plan me prioritete dhe me parime të forta të administrimit të projektit, përfshirë administrimin

e rreziqeve, qeverisjen dhe mekanizmat e kontrollit mbikëqyrës

- ▶ një angazhim për standarde dhe politika të pranuar botërisht
- ▶ zgjidhje informatike
- ▶ njerëzit e duhur me aftësi, njohuri dhe qasjen për t'i çuar përpara reformat nga lart-poshtë dhe nga poshtë-lart
- ▶ identifikimin e burimeve të nevojshme (të tanishme dhe të ardhshme) dhe mundësinë për t'i përdorur.

PULSAR-i vazhdon të mbështesë vendet anëtare për identifikimin dhe përshtatjen e praktikave të mira sipas nevojave të tyre kombëtare.

⁴⁸ ICAEW Building Blocks to Better PFM – A cash to accruals accounting toolkit
<https://www.icaew.com/about-icaew/regulation-and-the-public-interest/policy/better-government-series/building-blocks-to-better-pfm>



SHTOJCA 1. RRUGËTIMI NGA KONTABILITETI MONETAR NË KONTABILITETIN ME TË DREJTA DHE DETYRIME TË KONSTATUARA

Përpara kalimit në kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara, qeveritë duhet të rritin kapacitetet, besueshmërinë dhe paprekshmërinë e sistemeve të tyre nëpërmjet një sistemi kontabilitetit

monetar që funksionon mirë. E domosdoshme është ndjekja e hollësishme dhe në kohë e rezervave të likuiditetit dhe flukseve monetare dhe kontabilizimi i të gjitha arkëtimeve dhe pagesave.

Kontabiliteti me bazë monetare

- ▶ Kontabiliteti me bazë monetare është i thjeshtë dhe i lehtë për t'u zbatuar.
- ▶ Të ardhurat kontabilizohen kur arkëtohen paratë dhe shpenzimet kontabilizohen kur paguhen paratë.
- ▶ Transaksionet njihen vetëm kur paratë e lidhura merren ose paguhen.
- ▶ Kontabiliteti me bazë monetare jep një gjendje të hollësishme të pozicionit financiar të qeverisë duke krahasuar tepricat monetare me tepricën e borxhit për t'u shlyer.
- ▶ Palët e interesit dhe tregu mund të përdorin pasqyrat me bazë monetare për të analizuar aftësinë paguese dhe likuiditetin e qeverisë.

Baza monetare e modifikuar

- ▶ Baza monetare e modifikuar ndërthur kontabilitetin me bazë monetare dhe kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
- ▶ Shitjet ose të ardhurat njihen kur janë të matshme dhe të gatshme, dhe shpenzimet kontabilizohen me bazë të plotë me të drejta dhe detyrime të konstatuara sepse janë të matshme sapo ndodhin.
- ▶ Aktivët afatgjatë kontabilizohen me bazë me të drejta dhe detyrime të konstatuara.
- ▶ Aktivët afatshkurtra kontabilizohen me bazë monetare.
- ▶ Kontabiliteti i modifikuar monetar do të thotë edhe se qeveria mund të kontabilizojë llogaritë e arkëtueshme, aktivët afatshkurtra dhe afatgjatë dhe llogaritë e pagueshme.
- ▶ Baza e modifikuar monetare ofron informacione financiare më të rëndësishme se baza monetare dhe është më e lirë se baza e kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara.

Kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara


- ▶ Të ardhurat regjistrohen kur fitohen dhe shpenzimet kur kryhen, pavarësisht nëse paratë janë arkëtuar apo paguar gjatë periudhës.
- ▶ Zëra të tillë si amortizimi, rivlerësimi ose zhvlerësimi nuk krijojnë fluks monetar, por mbeten të rëndësishëm pasi mund të lidhen me transaksionet e mëparshme.
- ▶ Njihen të gjitha aktivët (përfshirë amortizimin) dhe detyrimet, inventarët zakonisht kontabilizohen me vlerën aktuale të tregut - vlerën në përdorim, ose një përafrim që pasqyron rivlerësimin.
- ▶ Duke mbuluar, si zërat monetarë, ashtu edhe ata jo-monetarë në pasqyrat financiare, pasqyrat financiare me të drejta dhe detyrime të konstatuara sigurojnë një pamje më të plotë të pozicionit financiar, ecurisë dhe kostos së veprimtarive.
- ▶ Pasqyra e bilancit pasqyron pozicionin e vërtetë financiar të qeverisë në çdo kohë të caktuar.
- ▶ Ndjekja efektive e arkëtimeve dhe pagesave në para është e domosdoshme për qëllime buxhetore edhe pas kalimit në bazën e plotë të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara.

Planifikimi buxhetor me të drejta dhe detyrime të konstatuara

- ▶ Për të marrë përfitimet e plota të kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara, përdoret planifikimi buxhetor me të drejta dhe detyrime të konstatuara.
- ▶ MFP-ja dhe shpërndarja e shpenzimeve paraqiten në bazë të planifikimit buxhetor me të drejta dhe detyrime të konstatuara, për të mundësuar që shpenzimet faktike të përputhen me buxhetin.
- ▶ Qeveritë mund të gjurmojnë shpenzimet e planifikuara në buxhet kundrejt shpenzimeve faktike.
- ▶ Buxhetet me të drejta dhe detyrime të konstatuara marrin parasysh zërat jo monetarë si amortizimi dhe provizionet për shpenzimet e ardhshme.

Raportimi i integruar

- ▶ Raportimi i sektorit publik në disa vende ka kaluar në raportim të integruar, ku organizatat përfshijnë informacione jo financiare në pasqyrat vjetore që demonstrojnë rezultatet dhe perspektivat e tyre dhe tregojnë se si shtojnë vlerë.
- ▶ Raportimi i integruar në sektorin publik synon të plotësojë nevojat më të gjera për informacione të të gjitha palëve të interesit, jo vetëm kërkesat financiare.
- ▶ Gama e informacioneve ndikon materialisht në aftësinë e organizatës për të krijuar vlerë me kalimin e kohës dhe plotëson shumë nevoja të palëve të interesit.
- ▶ Raportimi i integruar mund të nxisë vendimmarrje më të mirë, të sigurojë transparencë më të madhe, të përmirësojë llogaridhënien dhe të rritë besimin e publikut. Ndiqmon në ruajtjen dhe/ose përmirësimin e shërbimeve me më pak burime në mënyrë të qëndrueshme dhe të përgjegjshme shoqërore.



SHTOJCA 2. ESTONIA: PJESË TË SHKËPUTURA NGA PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË ESTONISË PËR VITIN 2022⁴⁹

2 Pasqyrat vjetore të konsoliduara dhe jo të konsoliduara të shtetit

2.1 Pasqyra e bilancit

Në milion euro

	Konsoliduar			Pa konsoliduar			Shënim
	31.12.2022	31.12.2021	31.12.2020	31.12.2022	31.12.2021	31.12.2020	
Aktive							
Aktive afatshkurtra							
Arka dhe banka	2.496,4	2.503,2	2.300,7	1.415,1	1.658,9	1.573,9	a2
Investime financiare	1.609,1	461,6	645,5	1.598,1	448,3	644,0	a3
Tatime, taksa shtetërore dhe gjoba të arkëtueshme	1.387,5	1.248,8	1.125,4	1.454,2	1.322,1	1.169,7	a4
Të drejta të tjera parapagime	1.676,8	1.294,7	1.097,8	1.034,0	1.228,5	775,9	a5
Derivativë	199,8	160,2	31,8	0,0	0,0	0,0	a18
Inventarë	714,4	367,4	319,9	40,0	33,3	47,0	a7
Aktive afatshkurtra jo-materiale	444,1	208,6	85,3	0,0	0,0	0,0	a12
Aktive biologjike	62,2	41,1	31,3	3,1	1,8	1,3	a14
Totali i aktiveve afatshkurtra	8.590,3	6.285,6	5.637,7	5.544,5	4.692,9	4.211,8	
Aktive afatgjata							
Interesa pronësie në fondacione	0,0	0,0	0,0	430,8	441,7	442,9	a8
Interesa pronësie në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje të lidhura	89,4	67,5	60,4	4.490,0	4.169,9	3.881,8	a9
Investime financiare	480,0	319,8	316,6	453,0	301,8	298,6	a3
Të drejta të tjera parapagime	941,4	925,1	867,1	1.193,2	1.089,2	1.533,3	a5
Derivativë	496,5	187,6	23,7	0,0	0,0	0,0	a18
Aktive afatgjata materiale të investuara	83,2	85,3	84,3	37,0	37,1	37,4	a10
Aktive afatgjata materiale	10.803,2	10.318,1	9.885,4	3.471,5	3.334,0	3.082,9	a11
Aktive afatgjata jo-materiale	333,2	305,9	279,8	180,3	150,4	125,6	a12
Aktive biologjike	2.170,3	930,7	758,9	27,7	16,5	12,0	a14
Totali i aktiveve afatgjata	15.397,2	13.140,0	12.276,2	10.283,5	9.540,6	9.414,5	
Totali i aktiveve	23.987,5	19.425,6	17.913,9	15.828,0	14.233,5	13.626,3	

⁴⁹ Burimi: <https://www.fin.ee/sites/default/files/documents/2023-12/Estonia%20Consolidated%20annual%20report%20of%20the%20state%20for%202022.pdf>

	Konsoliduar			Pa konsoliduar			Shënim
	31.12.2022	31.12.2021	31.12.2020	31.12.2022	31.12.2021	31.12.2020	
Aktive neto dhe detyrime							
Detyrime afatshkurtra							
Parapagime tatime, taksa shtetërore dhe gjoba të arkëtuara	700,2	622,8	523,2	716,6	638,6	534,7	a4
Kreditorë nga tregtia	532,0	387,1	303,8	218,6	172,9	153,5	
Të pagueshme ndaj punonjësve	188,5	165,9	152,1	71,7	63,1	60,6	
Detyrime për tatime, taksa shtetërore dhe gjoba	435,5	407,7	353,3	418,5	392,2	346,6	a4
Detyrime të tjera dhe parapagime të arkëtuara	2.639,3	2.019,3	1.669,4	3.087,7	2.865,2	2.518,7	a15
Provigjone	855,6	347,1	264,8	387,7	117,1	129,3	a16
Detyrime kredie	1.327,8	718,6	879,9	417,8	472,9	497,7	a17
Derivativë	169,1	116,1	10,4	0,0	0,0	0,0	a18
Totali i detyrimeve afatshkurtra	6.848,0	4.784,6	4.156,9	5.318,6	4.722,0	4.241,1	
Detyrime afatgjata							
Provigjone	4.111,1	3.787,8	3.289,3	4.025,7	3.701,4	3.215,6	a16
Detyrime kredie	5.621,5	5.179,0	4.817,3	4.542,5	3.443,6	3.136,1	a17
Detyrime të tjera dhe parapagime të arkëtuara	460,8	304,0	233,7	132,5	145,1	141,4	a15
Derivativë	32,1	37,8	4,4	0,0	0,0	0,0	a18
Totali i detyrimeve afatgjata	10.225,5	9.308,6	8.344,7	8.700,7	7.290,1	6.493,1	
Totali i detyrimeve	17.073,5	14.093,2	12.501,6	14.019,3	12.012,1	10.734,2	
Aktivet neto							
Aksione të pakicës	301,9	283,5	134,5	0,0	0,0	0,0	
Pasuria neto e shtetit							
Fondi Rezervë i Stabilizimit dhe rezerva për reforma	474,3	471,9	469,8	474,3	471,9	469,8	a20
Rezervë mbrojtëse	698,4	211,5	34,1	0,0	0,0	0,0	a18
Rezerva të tjera	12,5	8,2	5,9	0,0	0,0	0,0	
Suficit / deficit i akumuluar	5.426,9	4.357,3	4.768,0	1.334,4	1.749,5	2.422,3	
Totali i pasurisë neto të shtetit	6.612,1	5.048,9	5.277,8	1.808,7	2.221,4	2.892,1	
Totali i pasurisë neto / kapitalit neto	6.914,0	5.332,4	5.412,3	1.808,7	2.221,4	2.892,1	
Totali i detyrimeve dhe pasurisë neto	23.987,5	19.425,6	17.913,9	15.828,0	14.233,5	13.626,3	

2.2 Pasqyra e performancës financiare

Në milion euro

	Konsoliduar		Pa konsoliduar		Shënim
	2022	2021	2022	2021	
Të ardhura nga operacionet					
Tatim-taksa dhe kontribute të sigurimeve shoqërore	11.641,2	10.497,1	11.773,0	10.600,1	a4
Mallra dhe shërbime të shitura	4.347,1	3.173,9	514,5	401,9	a21
Grante të arkëtuara	1.176,0	1.034,2	1.085,9	984,0	a19
Të ardhura të tjera	661,5	302,6	281,0	190,5	a22
Totali i të ardhurave nga operacionet	17.825,8	15.007,8	13.654,4	12.176,5	
Shpenzime të shfrytëzimit					
Grante të miratuara	-6.662,8	-6.686,6	-7.134,9	-7.049,4	a19
Tatime, taksa shtetërore, gjoba të transmet-uara	-4.072,8	-3.532,9	-4.072,8	-3.532,9	a4
Ndryshime në tatime, taksa shtetërore dhe gjoba të arkëtueshme të dyshimta	-34,2	-39,4	-34,2	-39,4	a4
Kosto pune	-2.093,9	-1.903,9	-1.173,9	-1.068,8	a23
Shpenzime administrimi	-2.847,7	-2.076,4	-962,0	-811,3	a24
Amortizim dhe ndryshim i vlerës së aktiveve afatgjata	-739,0	-704,7	-312,2	-291,2	a25
Shpenzime të tjera	-939,1	-341,7	-144,5	-133,1	a26
Totali i shpenzimeve të shfrytëzimit	-17.389,5	-15.285,6	-13.834,5	-12.926,1	
Rezultati i shfrytëzimit	436,3	-277,8	-180,1	-749,6	
Rezultati i shfrytëzimit nga ndryshimi i vlerës së drejtë të aktiveve biologjike	1.260,7	181,6	12,5	4,9	a14
Të ardhurat dhe shpenzimet financiare					a27
Fitimi (Humbja) nga investimet financiare	30,5	1,0	331,8	365,7	
Shpenzime për interesa	-198,6	-166,2	-162,1	-126,5	
Të ardhura nga depozita dhe letra me vlerë	-8,5	-1,0	1,1	-4,4	
Të ardhura të tjera financiare	5,8	5,7	3,6	3,6	
Te tjera shpenzime financiare	-0,4	-0,5	0,0	0,0	
Totali i të ardhurave dhe shpenzimeve financiare	-171,2	-161,0	174,4	238,4	
Suficiti (deficiti) për periudhën ushtri-more	1.525,8	-257,2	6,8	-506,3	
Përfsh. kuotën e shtetit në suficit/deficit	1.491,2	-274,3	6,8	-506,3	
Përfsh. kuotën e pjesëmarrjes pakicë në suficit/deficit	34,6	17,1	0,0	0,0	

2.3 Pasqyra e flukseve monetare

Në milion euro

	Konsoliduar		Pa konsoliduar		Shënim
	2022	2021	2022	2021	
Flukse monetare nga veprimtaritë parësore					
Rezultati i shfrytëzimit	436,3	-277,8	-180,1	-749,6	
Amortizim dhe ndryshim i vlerës së aktiveve afatgjata	739,0	704,7	312,2	291,2	a25
Fitimi (humbja) nga aktivet afatgjate të shitura	-59,2	-38,4	-52,3	-31,3	a22
Të ardhura nga grante shtetërore të arkëtuara për blerjen e aktiveve afatgjata	-600,0	-488,2	-544,5	-454,9	a19
Shpenzime për grante shtetërore të miratuara për blerjen e aktiveve afatgjata	395,5	448,6	562,5	557,3	a19
Të tjera të ardhura dhe shpenzime jo financiare	182,7	11,7	-5,5	-0,2	
Totali i rezultatit të korrigjuar të shfrytëzimit	1.094,3	360,6	92,3	-387,5	
Ndryshimi neto i aktiveve afatshkurtra	-1.112,9	-591,2	-310,5	-234,2	
Ndryshimi neto i detyrimeve	1.174,1	828,0	472,5	684,4	
Totali i flukseve monetare nga veprimtaritë parësore	1.155,5	597,4	254,3	62,7	
Flukse monetare nga veprimtaritë e investimit					
Investime në aktive afatgjata	-1.318,0	-1.063,7	-479,5	-542,6	a13, a17
Fitimi kapital nga shitja e aktiveve afatgjate	66,9	50,7	54,4	33,9	a5, a10, a11, a14
Grante shtetërore të arkëtuara për blerjen e aktiveve afatgjata	453,5	452,7	390,4	415,8	a19
Grante shtetërore të investuara për blerjen e aktiveve afatgjata	-351,6	-404,6	-514,5	-459,1	a19
Paguar për blerjen e investimeve financiare likuide	-1.516,2	-679,7	-1.514,9	-679,2	
Arkëtuar nga shitja e investimeve financiare likuide	352,4	862,4	350,4	860,9	
Paguar në blerjen e investimeve financiare të tjera	-163,4	-8,5	-179,1	-31,6	a3, a5
Paguar për blerjen e pjesëmarrjeve (minus mjetet monetare të blera)	-14,1	-31,9	-148,0	-33,0	a5, a8, a9
Arkëtuar dhe dhënë nga transferimi, shitja dhe likuidimi i pjesëmarrjeve dhe investimeve të tjera financiare (minus mjetet monetare të hequra)	26,4	189,8	479,1	52,3	a3, a8, a9
Dividendë të arkëtuar	2,6	3,4	190,6	104,2	a9, a5
Dividendë të paguar	-17,5	-6,6	0,0	0,0	a9A
Kredi të dhëna	-34,2	-86,6	-20,1	-0,2	a6
Shlyerje e kredive të marra	53,9	46,7	16,5	15,1	a6
Të ardhura financiare të arkëtuara	6,7	-3,6	1,0	-7,2	
Totali i flukseve monetare nga veprimtaritë e investimit	-2.452,6	-679,5	-1.373,7	-270,7	
Flukse monetare nga veprimtaritë e financimit					
Arkëtime nga marrja e detyrimeve të kredisë	2.051,3	957,0	1.666,1	781,0	a17
Kredi të shlyera	-973,0	-791,2	-625,5	-499,7	a17
Interesa të paguara dhe të tjera shpenzime financiare	-34,4	-34,3	-3	-0,8	
Ndryshim i depozitave të klientëve	246,4	153,1	-162,0	12,5	a15
Totali i flukseve monetare nga veprimtaritë e financimit	1.290,3	284,6	875,6	293,0	
Flukse monetare neto	-6,8	202,5	-243,8	85,0	
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fillim të vitit	2.503,2	2.300,7	1.658,9	1.573,9	a2
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fund të vitit	2.496,4	2.503,2	1.415,1	1.658,9	a2
Ndryshimi i mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare	-6,8	202,5	-243,8	85,0	

2.4 Pasqyra e ndryshimeve në pasurinë neto

Në milion euro

A. Raporti përmbledhës

	Pasuria neto e shtetit						Aksione të pakicës	Totali	Shënim
	Fondi rezervë i stabilizimit	Fondi Rezervë i reformës së pronësisë	Rezervë mbrojtëse	Rezerva të tjera	Suficit / deficit i akumuluar	Totali			
Teprica më 31.12.2020	431,9	37,9	34,1	5,9	4.768,0	5.277,8	134,5	5.412,3	
Diferenca në kursin e këmbimit të ngarkueshme filialeve të huaja dhe ndikimi i të ardhurave të tjera të plota të pjesëmarrjeve				2,3		2,3		2,3	
Rivlerësimi i instrumenteve mbrojtës të rrezikut			177,4			177,4		177,4	a18
Fitimet dhe humbjet neto aktuariale në provizionet për pensione					167,6	167,6		167,6	a16
Rivlerësimi i aktiveve afatgjate materiale					4,7	4,7		4,7	a11
Suficiti (deficiti) për periudhën ushtrimore					-274,3	-274,3	17,1	-257,2	
Totali i suficitit (deficitit) për periudhën ushtrimore			177,4	2,3	-437,2	-257,5	17,1	-240,4	
Blerje dhe shitje të pjesëmarrjeve të pakicës					27,7	27,7	138,5	166,2	a9A
Pjesëmarrje të konsoliduara për herë të parë					0,9	0,9		0,9	
Dividendë të paguar						0,0	-6,6	-6,6	
Rishpërndarje	-1,8	3,9			-2,1	0,0		0,0	a20
Teprica më 31.12.2021	430,1	41,8	211,5	8,2	4.357,3	5.048,9	283,5	5.332,4	
Diferenca në kursin e këmbimit të ngarkueshme filialeve të huaja dhe ndikimi i të ardhurave të tjera të plota të pjesëmarrjeve				4,3		4,3		4,3	
Rivlerësimi i instrumenteve mbrojtës të rrezikut			486,9			486,9	3,4	490,3	a18
Fitimet dhe humbjet neto aktuariale në provizionet për pensione					-394,7	-394,7		-394,7	a16
Kalim inventari në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore					-28,0	-28,0		-28,0	a7
Rivlerësimi i aktiveve afatgjate materiale					3,5	3,5		3,5	a11
Suficiti (deficiti) për periudhën ushtrimore					1.491,2	1.491,2	34,6	1.525,8	
Totali i suficitit (deficitit) për periudhën ushtrimore	0,0	0,0	486,9	4,3	1.072,0	1.563,2	38,0	1.601,2	
Blerje dhe shitje të pjesëmarrjeve të pakicës						0,0	-2,1	-2,1	a9A
Dividendë të paguar						0,0	-17,5	-17,5	
Rishpërndarje	-6,2	8,6			-2,4	0,0		0,0	a20
Teprica më 31.12.2022	423,9	50,4	698,4	12,5	5.426,9	6.612,1	301,9	6.914,0	

B. Raporti jo përmbledhës

	Stabilisation Reserve Fund	Ownership Re- form Reserve	Accumulated surplus or deficit	Totali	Shënim
Teprica më 31.12.2019	431,9	37,9	2.422,3	2.892,1	
Fitimet dhe humbjet neto aktuariale në provizionet për pensione			-167,6	-167,6	a16
Rivlerësimi i aktiveve afatgjate materiale			3,2	3,2	a11
Suficiti (deficiti) për periudhën ushtrimore			-506,3	-506,3	
Totali i suficitit (deficitit) për periudhën ushtrimore			-670,7	-670,7	
Rishpërndarje	-1,8	3,9	-2,1	0,0	a20
Teprica më 31.12.2021	430,1	41,8	1.749,5	2.221,4	
Fitimet dhe humbjet neto aktuariale në provizionet për pensione			-394,7	-394,7	a16
Kalim inventari në Fondin e Sigurimeve Shëndetësore			-28,0	-28,0	a7
Rivlerësimi i aktiveve afatgjate materiale			3,2	3,2	a11
Suficiti (deficiti) për periudhën ushtrimore			6,8	6,8	
Totali i suficitit (deficitit) për periudhën ushtrimore			-412,7	-412,7	
Rishpërndarje	-6,2	8,6	-2,4	0,0	a20
Teprica më 31.12.2022	423,9	50,4	1.334,4	1.808,7	

2.6 Metodat e kontabilitetit dhe parimet e vlerësimit

Këto pasqyra vjetore janë përgatitur në përputhje me standardin estonez të raportimit financiar dhe Ligjin për Buxhetin e Shtetit. Kërkesat bazë të standardit të raportimit financiar të Estonisë janë përcaktuar në Ligjin për Kontabilitetin dhe janë plotësuar me udhëzimet e nxjerra nga Këshilli i Standardeve të Kontabilitetit të Estonisë, përfshirë udhëzimet e kontabilitetit financiar dhe raportimit të sektorit publik. Standardi i raportimit financiar estonez mbështetet në standardet e raportimit financiar të njohura botërisht, përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik.

Në pasqyrat vjetore të pakonsoliduara të shtetit, njësitë ekonomike shtetërore të kontabilitetit janë konsoliduar zë për zë dhe përfshijnë, në zbatim të Ligjit për Kontabilitetin, të gjitha ministritë, Kryeministrinë e Estonisë dhe institucionet kushtetuese - *Riigikogu*, Presidentin e Republikës, Zyrën Kombëtare të Kontrollit, Kancelarin e Drejtësisë dhe Gjykatën e Lartë. Sipas Ligjit për Buxhetin e Shtetit, njësitë ekonomike kontabël të shtetit janë edhe subjektet administrative të buxhetit të shtetit për të cilat është përgatitur një raport për zbatimin e buxhetit të shtetit. Lista e njësive ekonomike kontabël të shtetit të përfshira në pasqyrat vjetore të pakonsoliduara të shtetit jepet në shënimin a1 A të pasqyrave vjetore.

Në pasqyrat vjetore të pakonsoliduara të shtetit, krahas të dhënave financiare të pakonsoliduara të shtetit, janë konsoliduar zë për zë të dhënat financiare të fondacioneve dhe filialeve që janë nën ndikimin kontrollues të shtetit dhe të agjencisë shtetërore fitimprurëse "Qendra e Administrimit të Pyjeve Shtetërore". Lista e fondacioneve dhe filialeve të përfshira në pasqyrën e konsoliduar dhe treguesit kryesorë ekonomikë jepet në shënimin a1 B të llogarive vjetore.

Pasqyrat vjetore janë hartuar në përputhje me parimin e kostos, me përjashtim të letrave me vlerë të mbajtura për shitje, aktiveve dhe detyrimeve financiare të mbajtura për rishitje, transaksioneve derivative dhe aktiveve biologjike të kultivuara për fitim, të cilat raportohen me vlerën e drejtë.

Monedha funksionale dhe monedha e paraqitjes

Monedha funksionale është monedha e mjedisit ekonomik kryesor. Monedha e paraqitjes është euro. Pasqyrat janë rrumbullakosur në njëqind mijë, me përjashtim të raportit për zbatimin e buxhetit të shtetit, i cili është rrumbullakosur në mijëshe.

Klasifikimi i aktiveve dhe pasiveve afatshkurtra dhe afatgjata

Në pasqyrën e bilancit, aktivet dhe detyrimet janë klasifikuar në afatshkurtra dhe afatgjata, në varësi të faktit nëse detyrimi pritet të mbahet deri në një vit ose më gjatë, duke filluar nga data e bilancit.

Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare

Rubrika e arkës dhe bankës në bilanc përfshin arkën, tepricën e llogarive bankare (përveç llogarive të zbuluara) dhe depozitat afatshkurtra ose depozitat e përfunduara para afatit brenda një viti. Interesat e konstatuara dhe jo të arkëtuar nga depozitat deri më datën e bilancit njihen si të ardhura të konstatuara.

Investimet financiare

Investimet financiare afatshkurtra përfshijnë letrat me vlerë të mbajtura për tregtim afatshkurtër (aksione, obligacione, kuota fondesh etj.) dhe letrat me vlerë me afat fiks brenda 12 muajve pas datës së bilancit. Investimet financiare afatgjata janë letra me vlerë që nuk kanë gjasa të shiten brenda 12 muajve të ardhshëm (përveç pjesëmarrjeve ku njësia raportuese ushtron ndikim kontrollues, dhënë me të drejtën e votës duke filluar nga 20% e interesit të pronësisë) dhe letra me vlerë me afat fiks më shumë se 12 muaj pas datës së bilancit.

Investimet financiare (përveç instrumenteve të borxhit të mbajtura deri në afat) kontabilizohen me vlerën e drejtë nëse mund të vlerësohen me besueshmëri. Si vlerë e drejtë përdoret çmimi i tregut të kapitalit më datën e bilancit. Nëse vlera e drejtë nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme, investimet financiare kontabilizohen sipas metodës së kostonë së rregulluar (p.sh. kostoja fillestare minus zhvlerësimet e mundshme, nëse vlera e mbuluar nga investimi ka rënë nën vlerën kontabël).

Investimet financiare në obligacione dhe instrumente të tjera borxhi të mbajtura deri në afat njihen me kosto të rregulluar duke përdorur normën efektive të interesit.

Blerjet dhe shitjet e investimeve financiare njihen më datën e transaksionit.

Tatime, taksa shtetërore, gjoba dhe të tjera të arkëtueshme

Tatime, taksa shtetërore, gjoba dhe të tjera të arkëtueshme njihen në pasqyrën e bilancit sipas metodës së kostonë së rregulluar. Llogaritë e arkëtueshme njihen në bilanc pasi lind e drejta e kërimit dhe çmohen në bazë të shumave të arkëtueshme. Disa llogari të arkëtueshme njihen fillimisht jashtë bilancit pas konstatimit, derisa marrja e tyre konsiderohet e mundshme (vendime fiskale, vendime gjyqësore). Në qoftë se është e mundur, llogaritë e arkëtueshme nga secili klient vlerësohen veçmas për çdo klient specifik, duke marrë parasysh çdo informacion të disponueshëm në lidhje me aftësinë paguese të klientit. Mundësia e arkëtimit e një numri të madh llogarish të arkëtueshme të së njëjtës kategori vlerësohet në bazë grupore, duke marrë parasysh statistikën e periudhave të mëparshme për arkëtimin e të llogarive të arkëtueshme të ngjashme. Llogaritë e arkëtueshme të dyshimta kontabilizohen me vlerën e arkëtueshme të padyshimtë. Llogaritë e arkëtueshme të arkëtuara gjatë periudhës ushtrimore dhe të kaluara në kosto njihen si zvogëlim i shpenzimeve për llogaritë e arkëtueshme të dyshimta në periudhën raportuese. Llogaritë e arkëtueshme që nuk mund të arkëtohen janë hequr nga bilanci. Një llogari e arkëtueshme konsiderohet se nuk mund të arkëtohet në qoftë se këshilli i administrimit mendon se është e pamundur të arkëtohet.

Llogaritë e arkëtueshme afatgjata njihen me vlerën aktuale të shumës së arkëtueshme, duke marrë parasysh të ardhurat nga interesi mbi llogaritë e arkëtueshme në periudhat e ardhshme, duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Llogaritë e arkëtueshme nga tatimore dhe gjobat tatimore vlerësohen veçmas në qoftë se llogaritë e arkëtueshme totale për klient tejkalojnë 60 mijë euro. Për të çmuar llogaritë e arkëtueshme të mbetura tatimore dhe interesi si të dyshimta, përdoret metoda e përafërt e mëposhtme: llogaritë e arkëtueshme nga personat juridikë janë shlyer 100% në qoftë se afati i pagesës ka kaluar më shumë se 180 ditë; llogaritë e arkëtueshme nga personat fizikë janë shlyer 100% në qoftë se afati i pagesës ka kaluar më shumë se 360 ditë.

Derivatvë

Derivatvë njihen me vlerën e drejtë dhe ndryshimi i vlerës së drejtë përgjithësisht njihet në pasqyrën e performancës financiare. Në qoftë se janë përcaktuar objektivat e mbrojtjes dhe strategjia për transaksionet mbrojtëse, lidhja midis një derivativi të konsideruar si instrument mbrojtës dhe objektit të mbrojtur është dokumentuar në momentin e regjistrimit të transaksionit, dhe derivativi konsiderohet shumë efikas sa i takon mbrojtjes gjatë gjithë vlefshmërisë së instrumentit mbrojtës, pjesa efektive e ndryshimit të vlerës së drejtë mund të njihet në pasurinë neto si ndryshim i rezervës mbrojtëse.

Inventarët

Produkti i gatshëm dhe prodhimi në proces njihen me koston e prodhimit, që përfshijnë shpenzimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të prodhimit. Inventarët e tjerë njihen me kosto, që përfshin çmimin e blerjes dhe kosto të tjera që lidhen drejtpërdrejt me blerjen. Në kalimin e inventarëve të kostonë, përdoret ose FIFO-ja ose parimi i kostonë mesatare të ponderuar.

Inventarët zhvlerësohen deri në vlerën e çmuar të realizueshme neto në qoftë se është më e ulët se kostoja e tyre. Në qoftë se vlera neto e realizueshme e inventarëve të zhvlerësuar më parë rritet, zhvlerësimi i ardhshëm anulohet.

Interesa pronësie në fondacione dhe shoqata jofitimprurëse

Pasqyra e bilancit e njësive ekonomike raportuese tregon interesin e pronësisë në fondacionet dhe shoqatat jofitimprurëse ku njësia raportuese ka pjesëmarrje influencuese. Pjesëmarrje quhet influencuese në qoftë se njësia raportuese ka të drejtë të emërojë ose të shkarkojë shumicën e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës të njësive ekonomike.

Interesi i pronësisë njihet në pasqyrën e pakonsoliduar me koston e supozuar (shih shpjegimin). Në pasqyrat e konsoliduara, fondacionet dhe shoqatat jofitimprurëse nën ndikim kontrollues konsolidohen zë për zë.

Interesa pronësie në shoqëri të kontrolluara dhe pjesëmarrje

Shoqëri e kontrolluar konsiderohet se ndodhet nën ndikimin kontrollues në qoftë se njësia raportuese zotëron më shumë se 50% të aksioneve me të drejtë vote të shoqërisë së kontrolluar, është në gjendje të kontrollojë politikën operative dhe financiare të shoqërisë së kontrolluar ose ka të drejtë të emërojë ose largojë shumicën e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës.

Pjesëmarrje është shoqëria ku mbahen 20 deri në 50% të aksioneve me të drejtë vote. Pjesëmarrjet në shoqëritë e kontrolluara dhe shoqëritë pjesëmarrje njihen në pasqyrat e pakonsoliduara me koston e supozuar (shih shpjegimin përkatës).

Në pasqyrat e konsoliduara, shoqëritë e kontrolluara nën influencë kontrolluese konsolidohen zë për zë dhe pjesëmarrjet kontabilizohen në bazë të metodës së kapitalit neto.

Kostoja e supozuar

Në rastin e interesit të pronësisë të blerë përpara 31 dhjetorit 2003, kostoja e supozuar përcaktohet si vlera e tij sipas metodës së kapitalit neto, sepse nuk ka informacion të besueshëm për koston në periudhat e mëparshme, dhe në rastin e interesit të pronësisë të blerë pas 31 dhjetorit 2003, si kosto. Kostoja e supozuar zhvlerësohet në qoftë se aksionet në pronësi të njësive ekonomike që mban interesin e pronësisë në të investuarin bie nën vlerën e interesit të pronësisë siç është dhënë në pasqyrën e bilancit të pronarit. Zhvlerësimet e bëra stornohen në periudhat e ardhshme raportuese, por jo më lart se kostoja e supozuar.

Konsolidimi

Veprimtaria e njësive ekonomike nën kontroll ose pjesëmarrje influencuese njihet në pasqyrën e konsoliduar nga fillimi deri në fund të pjesëmarrjes kontrolluese ose influencuese. Blerja e njësive ekonomike nën pjesëmarrje kontrolluese ose influencuese njihet me metodën e blerjes ku aktivet dhe detyrimet e interesit të pronësisë së blerë vlerësohen me vlerën e drejtë, me përjashtim të blerjeve të bëra nën kontroll të përbashkët, që kontabilizohen me vlerën kontabël.

Në pasqyrën e konsoliduar, treguesit financiarë të njësive ekonomike nën pjesëmarrje kontrolluese mbledhen zë për zë, ndërsa aktivet, detyrimet, pasuria neto, të ardhurat, shpenzimet dhe fitimet dhe humbjet e përealizuara të njësive ekonomike të përfshira në konsolidim janë eliminuar.

Në pasqyrën e konsoliduar, njësitë ekonomike nën pjesëmarrje influencuese kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit neto.


Aktive afatgjata materiale të investuara

Aktivët afatgjata materiale të investuara përfshijnë pasuri të paluajtshme (troje, ndërtesa, objekte) të mbajtura me qira ose për rritjen e vlerës së tregut, të cilat njësia raportuese ose ndonjë njësi tjetër ekonomike e sektorit publik nuk i përdor në aktivitetin kryesor. Aktivët afatgjata materiale të investuara kontabilizohen me metodën e koston (me kosto, minus amortizimin e akumuluar dhe zhvlerësimet e mundshme).

Aktivët afatgjata materiale

Aktivët me jetë të dobishme të pritur më të gjatë se një vit dhe kosto duke filluar nga 5 mijë euro, llogariten si aktive afatgjata materiale. Kostoja e aktiveve afatgjata materiale përfshin shpenzimet e nevojshme për përdorimin, përveç tatimeve, taksave shtetërore, shpenzimeve të formimit dhe udhëtimit në lidhje me blerjen, që kontabilizohen si shpenzime të periudhës raportuese kur konstatohen. Shoqëritë e kontrolluara të cilat i hartojnë pasqyrat financiare sipas standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, i kapitalizojnë shpenzimet e huasë në koston e aktiveve materiale. Të gjitha njësitë e tjera nuk i kapitalizojnë shpenzimet e huasë, por i kontabilizojnë në pagesat e interesit si të konstatuara.

...



SHTOJCA 3. ZELANDA E RE: PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 30 QERSHOR 2023⁵⁰


Qeveria e Zelandës së Re i publikoi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 30 qershor 2023 brenda katër muajve pas mbylljes së vitit. Pasqyrat fillojnë me një

përmbledhje buxhetore, ku evidentohen rezultatet buxhetore dhe forca qëndruese, përfshirë këtu më poshtë.

Informacion i përgjithshëm mbi buxhetin


Rezultatet financiare 2023

Rezultati buxhetor




Rregullat buxhetore

Sipas Ligjit për Financat Publike, Qeverisë i kërkohet të hartojë një strategji buxhetore duke ndjekur parimet e administrimit të përgjegjshëm buxhetor. Përpara buxhetit 2022, qeveria njoftoi se strategjia buxhetore do të mbështetet në dy rregulla. Këto rregulla synojnë të sigurojnë që me kalimin e kohës shpenzimet e shfrytëzimit të mos shtojnë borxhin neto si pjesë e PBB-së, duke siguruar hapësirë buxhetore për investime kapitale cilësore dhe një rezervë buxhetore të mjaftueshme për çdo goditje të ardhshme.


**OBEGAL**

Synimi afatshkurtër i Qeverisë është kthimi në suficitin OBEGAL deri 2026/27, në varësi të kushteve ekonomike dhe buxhetore. Kur teprica e shfrytëzimit (para fitimit dhe humbjes) të jetë kthyer në suficit, objektivi afatgjatë është të ruhet një suficit mesatar në gamën prej 0 për qind deri në 2 për qind të PBB-së. Kjo do të sigurojë që, mesatarisht, gjatë një periudhe të arsyeshme kohore, shpenzimet totale të shfrytëzimit të mos jenë më të mëdha se të ardhurat totale të shfrytëzimit. Qeveria ka deklaruar një deficit prej 9,4 miliardë dollarësh, që do të thotë se një pjesë e këtij deficiti do të duhet të financohet duke rritur borxhin neto. Përveç kësaj, shpenzimet kapitale arrijnë në 22,2 miliardë dollarë, ku 10,5 miliardë dollarë sollën rritje të borxhit neto.

Forca rezistuese buxhetore

Këto rregulla ishin:

- kthimi i tepicës nga veprimtaria e shfrytëzimit para fitimit dhe humbjes (OBEGAL) në suficit dhe synimi për suficite të vogla më pas, si **rregull parësor buxhetor**, dhe
- një tavan neto borxhi që plotëson objektivin OBEGAL duke lejuar më shumë hapësirë buxhetore për të financuar investime kapitale cilësore që do të përmirësojnë produktivitetin dhe standardet e jetesës.



Borxhi neto

Synimi afatshkurtër i qeverisë është ta mbajë borxhin neto nën 30% të PBB-së.

Borxhi neto ishte rritur me 9,5 miliardë dollarë në 71,4 miliardë dollarë në 30 qershor 2023 (18% e PBB-së).

Përmbledhje e pasqyrave Financiare

Rezultatet financiare të Qeverisë për vitin 2022/23 tregojnë se të ardhurat dhe shpenzimet janë rritur me ritme të ngjashme në krahasim me një vit më parë. Fitimet nga rivlerësimi kanë pasur ndikim të favorshëm të konsiderueshëm në vlerën e aktiveve dhe detyrimeve, gjë që ka rezultuar në një rezultat më të fortë të tepcës nga shfrytëzimi dhe një pozicion më të mirë të pasurisë neto në krahasim me një vit më parë. Pas buxhetit të vitit 2023, të hyrat faktike nga tatim-taksat kanë rënë nën atë që pritej, çka ka sjellë një numër treguesish buxhetorë më të dobët nga sa pritej.

- Totali i të ardhurave (153 miliardë dollarë) ishte 11,4 miliardë dollarë më shumë se një vit më parë, por më i ulët se parashikimi i buxhetit 2023 me 2,5 miliardë dollarë. Këto diferenca kanë ardhur kryesisht për shkak të ndryshimeve në të ardhurat tatimore (faqe 11).
- Totali i shpenzimeve është 161,8 miliardë dollarë, 10,9 miliardë dollarë më shumë se një vit më parë dhe në përputhje me parashikimin e Buxhetit 2023 (faqe 14). Rritja nga viti i kaluar vjen kryesisht për shkak të faktorëve ekonomikë dhe vendimeve të politikave (faqe 12).
- Teprica e shfrytëzimit ishte suficit prej 5,3 miliardë dollarësh kryesisht si rezultat i fitimeve neto prej 14,7 miliardë dollarësh të kompensuar pjesërisht nga shpenzimet që tejkalojnë të ardhurat me 8,8 miliardë dollarë (faqe 15).
- Me rritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve me një shumë të ngjashme gjatë vitit, deficitin operativ para fitimeve dhe humbjeve (OBEGAL) prej 9,4 miliardë dollarësh është përgjithësisht në përputhje me deficitin e raportuar vitin e kaluar (faqe 18). Megjithatë, rezultat fiskal faktik më i dobët pas Buxhetit 2023 ka bërë që deficitin OBEGAL të jetë 2,5 miliardë dollarë më shumë se sa ishte parashikuar.
- Pasuria neto u rrit me 17,2 miliardë dollarë në 191,5 miliardë dollarë (faqe 28), kryesisht si rezultat i rivlerësimeve pozitive të aktiveve afatgjata materiale dhe suficitit të tepcës nga shfrytëzimi (faqe 25).
- Borxhi neto (71,4 miliardë dollarë, 18% e PBB-së), është 9,5 miliardë dollarë më i lartë se niveli i qershorit 2022, por afër 71 miliardë dollarëve (18% e PBB-së) të parashikuar në Buxhetin 2023 (faqe 21).

Tabela 1 – Treguesit financiarë kryesorë

Viti i mbyllur më 30 qershor.					Parashikimi		
	Fakti	Fakti	Diferenca		Buxheti 2023	Diferenca	
	2023	2022	2023	2022	2023	2023	2022
	milione \$	milione \$	milione \$	%	milione \$	milione \$	%
Të ardhura gjithsej	153.011	141.627	11.384	8	155.556	-2.545	-1,6
Shpenzime gjithsej	161.822	150.956	10.866	7,2	161.924	(102)	(0,1)
Teprica nga shfrytëzimi ¹	5.321	(16.932)	22.253	(131,4)	4.219	1.102	26,1
Pasuria neto gjithsej	191.472	174.319	17.153	9,8	178.956	12.516	7,0
Totali i aktiveve	536.666	501.844	34.822	6,9	519.192	17.474	3,4
Totali i detyrimeve	345.194	327.525	17.669	5,4	340.236	4.958	1,5
OBEGAL ¹	(9.446)	(9.691)	245	(2,5)	(6.959)	(2.487)	35,7
Borxhi neto	71.367	61.850	9.517	15,4	70.957	410	0,6
%e PBB-së²							
Të ardhura gjithsej	38,6	38,9	(0,3)		39,5		(0,9)
Shpenzime gjithsej	40,9	41,5	(0,6)		41,1		(0,2)
Teprica nga shfrytëzimi	1,3	(4,7)	6,0		1,1		0,2
Pasuria neto gjithsej	48,4	47,9	0,5		45,4		3,0
Totali i aktiveve	135,6	138,0	(2,4)		131,8		3,8
Totali i detyrimeve	87,2	90,1	(2,9)		86,4		0,8
OBEGAL	(2,4)	(2,7)	0,3		(1,8)		(0,6)
Borxhi neto	18,0	17,0	1,0		18,0		0,0

1 Nuk përfshin interesat e pakicës.

2 PBB-ja faktike përditësohet për të pasqyruar shifrat më të fundit të publikuara – shih seritë kohore historike në faqen 181 për shifrat nominale të PBB-së (Burimi: Stats NZ).

Burimi: Thesari

Përmbledhje e pasqyrave Financiare (vijon)

Ky relacion shpjegues shoqëron pasqyrat financiare të audituara në faqet 44 deri në 166. Pasqyrat Financiare të Qeverisë kanë marrë opinion të pamodifikuar të audituesit për vitin e mbyllur më 30 qershor 2023.

Viti ushtrimor 2022/23 përkoi me një mjedis ekonomik me inflacion të lartë dhe rritje të normave të interesit. Këto kushte kanë kontribuar në një sërë tendencash në treguesit kryesorë buxhetorë të qeverisë krahasuar me vitin e kaluar. Më 30 qershor 2023, ndryshimi vjetor në përqindje i Indeksit të Çmimeve të Konsumit ishte 6%. Kjo ka mbështetur rritjen e fortë të pagave dhe konsumin privat gjatë vitit dhe ka sjellë një rritje të qëndrueshme të ekonomisë nominale, ku PBB nominale që u rrit me 8,9%. Të ardhurat fiskale janë rritur si pasojë e rritjes së ekonomisë, por me një ritëm pak më të ngadaltë duke reflektuar ndikimin e fitimeve më të dobëta të biznesit. Inflacioni ka kontribuar edhe në rritjen e shpenzimeve, ku një pjesë e madhe e Buxhetit 2022 është përdorur për të mbuluar presionet e kostove dhe nismat politike për të mbështetur banorët e Zelandës së Re t'i bëjnë ballë përmes rritjes së kostos së jetesës (p.sh. pagesa për koston e jetesës).

Me objektivin për ta lehtësuar normën e inflacionit, Banka e Rezervës e Zelandës së Re (Banka e Rezervës) ka ngritur normën zyrtare të fondeve (OCR) nga 2,5% në korrik 2022 në 5,5% në qershor 2023, e cila nga ana tjetër sjell një rritje të normave të interesit. Në përgjithësi, rritja e normave të interesit ka ndikuar negativisht në rezultatet buxhetore të qeverisë, ku rritja e kostos së financave ka qenë më e madhe se rritja e të ardhurave nga interesi.

Viti ushtrimor 2022/23 mbulon edhe një periudhë ku kufizimet e COVID-19 kryesisht kanë marrë fund dhe masat e përkohshme të mbështetjes së qeverisë (për shembull, skema e subvencionimit të pagave dhe pagesat në mbështetje të rimëkëmbjes), kanë qenë minimale në krahasim me vitet e fundit, duke rezultuar në një ulje të shpenzimeve. Heqja e shumicës së kufizimeve të COVID-19 ka nënkuptuar gjithashtu që aktiviteti në disa sektorë (p.sh. udhëtimi ajror) është rikthyer në nivelet e para-COVID-19, gjë që ka rritur si të ardhurat ashtu edhe shpenzimet. Sidoqoftë, dukuritë e motit të Ishullit të Veriut në fillim të vitit kalendarik 2023 kanë sjellë disa kosto të njëhershme që i janë ngarkuar vitit ushtrimor 2022/23. Kjo përfshin kostot për shlyerjen e dëmeve të sigurimit, zhvlerësimin e aktiveve dhe kostot e ndërhyrjes së shpejtë.

Si rezultat i faktorëve të mësipërm, të ardhurat totale të Kurorës (153 miliardë dollarë) janë rritur me 11,4 miliardë dollarë dhe shpenzimet totale të Kurorës (161,8 miliardë dollarë) janë rritur me 10,9 miliardë dollarë nga viti ushtrimor 2021/22. Me rritjen e të ardhurave dhe shpenzimeve me një shumë të ngjashme gjatë vitit, deficitin OBEGAL prej 9,4 miliardë dollarësh në 2022/23 është përgjithësisht në përputhje me deficitin e raportuar vitin e kaluar.

Po kështu, deficitin i mbetur i likuiditetit prej 25,6 miliardë dollarësh është gjerësisht në përputhje me deficitin e raportuar në 2021/22.

Financimi i deficitit të likuiditetit në 2022/23 kontribuon në rritjen e borxhit neto. Megjithatë, kjo kompensohet disi nga kushtet më të forta të tregut të investimeve gjatë vitit 2022/23, çka i ka rritur aktivet financiare. Në përgjithësi, borxhi neto në 2022/23 ishte 9,5 miliardë dollarë më shumë se një vit më parë duke u rritur nga 61,9 miliardë dollarë (17% e PBB-së) në 71,4 miliardë dollarë (18% e PBB-së).

Vlerësimi i aktiveve dhe detyrimeve ka kontribuar në një rezultat më të fortë të rezultatit të shfrytëzimit dhe pozicion më të mirë të pasurisë neto krahasuar me vitin e kaluar. Kushte më të forta të tregut të investimeve kanë e rritur vlerën e instrumenteve financiare, të zotëruara kryesisht nga Fondi NZS dhe Korporata e Kompensimit të Aksidentëve (ACC). Vlera e përgjegjësisë të Skemës së Tregtimit të Çlirimeve të Zelandës së Re (NZ ETS) ka rënë, çka ka sjellë njohjen e një fitimi nga vlerësimi. Në përgjithësi, fitimet neto nga vlerësimi të njohura në rezultatin e shfrytëzimit janë 14,7 miliardë dollarë dhe kanë qenë shtytësi kryesor për suficitin e rezultatit të shfrytëzimit prej 5,3 miliardë dollarësh, duke qenë më i lartë se rezultati i vitit të kaluar.

Pozicioni i pasurisë neto të qeverisë është 17,2 miliardë dollarë më i lartë se një vit më parë, kryesisht si rezultat i suficitit të rezultatit të shfrytëzimit të deklaruar në 2022/23 dhe rritjeve nga rivlerësimi në disa prej aktiveve fizike të qeverisë. Rritjet nga rivlerësimi reflektojnë kryesisht kosto më të larta materiale që kërkojnë për të zëvendësuar aktivet ekzistuese.

Shumica e treguesve kryesorë buxhetorë të qeverisë janë më të dobët se sa ishte parashikuar në Buxhetin 2023.

Ky rezultat më i dobët vjen kryesisht për shkak të të ardhurave fiskale, që ishin 2,9 miliardë dollarë më pak se plani. Shkak për këtë është kryesisht rënia e të ardhurave neto fiskale nga tatimi mbi shoqëritë tregtare dhe tatimit mbi të ardhurat personale, pasi fitimet e tatueshme për vitin tatimor 2022 ishin më të ulëta se sa mendohej në parashikimin e Buxhetit 2023.

Rezultatet krahasohen me një vit më parë dhe me parashikimet për vitin 2022/23:

- *Buxheti 2022* është "Përditësimi ekonomik dhe buxhetor për vitin 2022" botuar në maj 2022, dhe
- *Buxheti 2023* është "Përditësimi ekonomik dhe buxhetor për vitin 2023" botuar në maj 2023.

Rezultatet e fund-vitit krahasuar me rezultatet e pa audituara të përfshira në Përditësimin Parazgjedhor

"Përditësimi ekonomik dhe buxhetor parazgjedhor" (Përditësimi parazgjedhor) u botua më 12 shtator 2023 dhe përfshinte rezultatet e pa audituara për vitin e mbyllur më 30 qershor 2023. Kjo rubrikë krahason rezultatet e fund-vitit me rezultatet e pa audituara të botuara në *Përditësimin parazgjedhor*.

Në përgjithësi, shumica e treguesve financiarë ishin afër rezultateve të pa audituara të paraqitura në *Përditësimin parazgjedhor* (Tabela 2), ku shumica e diferencave kishin të bënin me riklasifikimet dhe finalizimin e vlerësimeve. Kjo natyrë e ndryshimeve ka rrjedhoja minimale në perspektivën buxhetore të paraqitur në *Përditësimin parazgjedhor*.

Tabela 2– Rezultatet e 30 qershorit 2023 krahasuar me *Përditësimin parazgjedhor*

Viti i mbyllur më 30 qershor.	Fakti 2023 milionë \$	Përditësimi parazgjedhor 2023 milionë \$	Variance milionë \$	%
Të ardhura gjithsej	153.011	152.474	537	0,4
Shpenzime gjithsej	161.822	161.873	(51)	0,0
Teprica nga shfrytëzimi ¹	5.321	5.086	235	4,6
Pasuria neto gjithsej	191.472	191.437	35	0,0
Totali i aktiveve	536.666	536.187	479	0,1
Totali i detyrimeve	345.194	344.750	444	0,1
OBEGAL ¹	(9.446)	(10.034)	588	(5,9)
Borxhi neto	71.367	71.421	(54)	(0,1)

1 Nuk përfshin interesat e pakicës.

Burimi: Thesari


Të ardhurat totale ishin 0,5 miliardë dollarë më të larta se rezultati i pa audituar, duke reflektuar kryesisht një riklasifikim nga fitimet nga instrumentet financiare në të ardhura nga interesi mbi të hyrat nga Programi i financimit për huadhënie (FLP). Kjo pasqyrohet në një përmirësim të OBEGAL, por ka ndikim neutral në rezultatin e shfrytëzimit.

Shpenzimet totale ishin 0,1 miliardë dollarë më të ulëta se rezultati i pa audituar. Një shpenzim shtesë prej 0,4 miliardë dollarësh u njoh për të pasqyruar pjesën e prapambetur të shlyerjes së kompensimit të pagave të infermierëve më 31 korrik 2023. Megjithatë, kjo u kompensua më shumë nga stornimi i humbjeve nga zhvlerësimi dhe ndryshimet e amortizimit në aktivet e mbajtura nga KiwiRail. Ky ndryshim bën që disa aktive tani konsiderohen si të mbajtura kryesisht për fitim publik, në vend të aktiveve të mbajtura vetëm për të gjeneruar mjete monetare, gjë që ka ndryshuar qasjen e vlerësimit për qëllimet e raportimit të Kurorës këtë vit.

Si rezultat i ndryshimeve në të ardhurat totale dhe shpenzimet totale, deficitin OBEGAL ishte 0,6 miliardë dollarë më i vogël se rezultati i pa audituar. Siç u përmend më lart, fitimet nga instrumentet financiare janë ulur, për rrjedhojë rezultati i shfrytëzimit është përgjithësisht në përputhje me rezultatin e pa audituar.

Megjithëse vlera totale neto ishte afër rezultatit të pa audituar, si totali i aktiveve ashtu edhe detyrimet totale ishin më të larta për një shumë të ngjashme. Ndryshimet në totalin e aktiveve lidhen kryesisht me vlerësimet e aktiveve fizike. Ndërsa ndryshimi në totalin e detyrimeve, reflekton kryesisht provizionin për shlyerjen e prapambetur të pagave të infermierëve si formë kompensimi.

Nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në borxhin neto.



SHTOJCA 4. ZVICRA: PASQYRAT FINANCIARE SHTETËRORE 2023^{51,52}

PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE

Milionë franga zvicerane	PF 2022	Bxh. 2023	PF 2023	Δ 2022-23	
				absolute	%
Arkëtime korente	74.766	80.309	78.605	3.840	5,1
Arkëtime fiskale	69.493	74.970	74.784	5.291	7,6
Tatim i drejtpërdrejtë federal - persona fizikë	12.532	13.306	13.344	812	6,5
Tatim i drejtpërdrejtë federal - persona juridikë	12.249	13.835	14.491	2.242	18,3
Tatimi i mbajtur në burim	3.888	6.675	6.445	2.557	65,8
Taksë pulle	2.483	2.375	2.181	-302	-12,2
Tatimi mbi vlerën e shtuar	24.588	25.410	25.148	559	2,3
Të tjera tatime mbi konsumin	8.207	8.077	7.992	-214	-2,6
Arkëtime fiskale të ndryshme	5.546	5.292	5.183	-363	-6,6
Arkëtime jo fiskale	5.272	5.339	3.821	-1.451	-27,5
Renta dhe koncesione	2.393	2.350	374	-2.020	-84,4
Arkëtime të tjera	2.521	2.589	2.818	297	11,8
Arkëtime financiare	358	400	630	272	75,9
Shpenzime korente	75.072	76.629	75.203	131	0,2
Shpenzime shfrytëzimi	12.009	11.626	11.529	-480	-4,0
Shpenzime personeli	6.107	6.379	6.234	127	2,1
Shpenzime të përgjithshme, administrative dhe shfrytëzimi	4.970	4.443	4.353	-618	-12,4
Shpenzime për mbrojtjen	932	804	943	10	1,1
Shpenzime transferimi	62.057	63.993	62.379	322	0,5
Depozita në fonde speciale dhe financime speciale	7.614	8.034	7.438	-176	-2,3
Kontribute në institucione të veta	3.920	3.926	4.042	122	3,1
Kontribute në sigurime shoqërore	19.332	18.426	18.422	-910	-4,7
Kontribute për kantone dhe komuna	23.025	25.088	24.340	1.315	5,7
Kontribute të të tretët	8.166	8.519	8.138	-28	-0,3
Shpenzime financiare	1.006	1.010	1.295	289	28,7
Vetëfinancim	-307	3.681	3.402	3.708	n,d,
Amortizim, aktive afatgjata materiale dhe jo-materiale	-2.946	-3.123	-3.002	-57	-1,9
Amortizim i kontributeve në investime	-1.188	-1.432	-1.229	-40	-3,4
Të tjera ndryshime vlere në aktive administrative	-694	-210	-704	-9	-1,4
Rezultati nga interesa financiare	1.516	1.423	2.410	894	59,0
Suficit/(deficit) për vitin	-3.619	339	877	4.496	124,2

Shifrat për vitin 2022, si edhe struktura dhe paraqitja janë rregulluar (shih rubrikën B.72. Ndryshimet në pasqyrat financiare 2023)

⁵¹ Pasqyrat financiare shtetërore konsolidojnë dikasteret (ministritë) dhe njësitë e decentralizuara, por jo NSH-të. Pasqyrat financiare shtetërore përkojnë me buxhetin e shtetit. Pasqyrat financiare të konsoliduara përgatiten dhe konsolidojnë edhe NSH-të dhe nuk kanë buxhet përkues, meqë NSH-të nuk përfshihen në buxhetin e shtetit.

⁵² Burimi: <https://www.efv.admin.ch/efv/en/home/finanzberichterstattung/finanzberichte/staatsrechnung.html>

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

Milionë franga zvicerane	01.01.2022	31.12.2022	31.12.2023	Δ 2022-23	Shënimet
Aktive	181.781	188.700	190.187	1.487	
Aktive jo administrative	40.955	45.504	44.564	-940	
Aktive likuide	12.973	15.615	16.791	1.177	-
Llogari të arkëtueshme	10.746	10.557	11.615	1.058	-
Shpenzime të parapaguara dhe të ardhura të konstatuara	3.784	4.231	4.141	-90	-
Investime financiare	13.453	15.101	12.017	-3.084	-
Aktive	140.825	143.196	145.623	2.427	
Inventarë dhe paradhënie	4.425	4.264	3.764	-500	-
Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	60.893	61.635	62.853	1.218	-
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	431	564	677	113	-
Hua	5.574	5.523	5.627	105	-
Interesa financiarë	69.503	71.211	72.701	1.491	-
Detyrimet dhe kapitali neto	181.781	188.700	190.187	1.487	
Detyrime	175.888	184.510	186.251	1.742	
Detyrime afatshkurtra	18.558	19.235	21.223	1.988	-
shpenzime të konstatuara dhe të ardhura të shtyra	12.796	8.511	7.587	-924	-
Detyrime financiare	92.736	104.469	106.869	2.400	-
Fonde të kufizuara në detyrime	9.285	10.832	11.207	375	-
Detyrime për përfitimet e punonjësve	3.475	2.139	2.767	628	-
Provizione	39.038	39.323	36.598	-2.725	-
Aktivët neto / kapitali neto	5.893	4.191	3.936	-255	
Fonde të kufizuara në aktivët neto / kapitalin neto	6.523	6.582	6.601	20	-
Rezerva nga buxheti global	446	710	621	-88	-
Deficiti i akumuluar	-1.076	-3.101	-3.287	-186	-

Shifrat për vitin 2022 janë rregulluar (shih rubrikën B.72. Ndryshimet në pasqyrat financiare 2023)

PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

Milionë franga zvicerane	PF 2022	PF 2023	absolute
Totali i flukseve monetare	2.642	1.177	-1.465
Flukse monetare nga veprimtaritë e shfrytëzimit	-3.716	-733	2.982
Suficit/(deficit) për vitin	-3.619	877	4.496
Amortizimi dhe zhvlerësimet	2.946	3.002	57
Rezultati nga interesa financiare (metoda e kapitalit neto)	-1.516	-2.410	-894
Fitimi nga heqja e aktiveve afatgjate	-6	-12	-6
Zmadhimi/zvogëlimi neto i provigjoneve	285	-2.725	-3.010
Transaksione të tjera jo financiare	1.899	-61	-1.960
Ndryshimi i aktiveve afatshkurtra neto	-3.705	595	4.300
Zmadhimi/zvogëlimi i llogarive të arkëtueshme	189	-1.058	-1.247
Zmadhimi/zvogëlimi i shpenzimeve të parapaguara / të ardhurave të konstatuara	-447	90	538
Zmadhimi/zvogëlimi i inventarëve	161	500	338
Zmadhimi/zvogëlimi i detyrimeve afatshkurtra	677	1.988	1.311
Zmadhimi/zvogëlimi i shpenzimeve të konstatuara / të ardhurave të shtyra	-4.284	-924	3.360
Flukse monetare nga veprimtaritë e investimit	-4.550	253	4.803
Blerja e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	-3.865	-4.265	-400
Heqja e aktiveve afatgjata materiale dhe jo-materiale	75	23	-53
Investime në hua/interesa financiare (admin, aktive)	-143	-139	4
Mbyllje e huave/interesave financiare (admin, aktive)	105	147	42
Investime në aktive jo administrative	-7.431	-7.581	-150
Mbyllje e aktiveve jo administrative	5.784	10.646	4.862
Interesa dhe dividendë të arkëtuara	925	1.423	497
Flukse monetare nga veprimtaritë e financimit	10.908	1.657	-9.251
Zmadhim i detyrimeve financiare afatshkurtra	48.622	60.234	11.613
Heqje e detyrimeve financiare afatshkurtra	-43.857	-65.706	-21.849
Detyrime financiare afatgjata shtesë	13.219	14.669	1.450
Heqje e detyrimeve financiare afatgjata	-5.687	-6.127	-440
Interes i paguar	-1.389	-1.415	-25

PASQYRA E LIKUIDITETIT

Milionë franga zvicerane	PF 2022	PF 2023	absolute
Arka dhe banka më 01.01.	12.973	15.615	2.642
zmadhim (+) / zvogëlim (-)	2.642	1.177	-1.465
Arka dhe banka më 31.12.	15.615	16.791	1.177

Paraqitja dhe struktura janë rregulluar (shih rubrikën B.72. Ndryshimet në pasqyrat financiare 2023)

PASQYRA E INVESTIMEVE

Milionë franga zvicerane	PF 2022	Bxh. 2023	PF 2023	Δ 2022-23	
				absolute	%
Arkëtime nga investimet	882	1.038	1.002	119	13,5
Dividendë	633	833	832	200	31,6
Shlyerje huaje	105	152	147	42	40,1
Të tjera arkëtime nga investimet	145	53	22	-123	-84,6
Shpenzime për investime	5.825	9.544	5.835	10	0,2
Ndërtesa	861	898	829	-32	-3,8
Aktivitet afatgjatë materiale	123	135	253	130	106,1
Inventarë	673	105	232	-441	-65,5
Autostrada	2.012	1.772	2.067	55	2,7
Pajisje për mbrojtjen	771	950	1.026	255	33,0
Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara	52	38	57	6	10,8
Hua	62	4.143	68	6	9,4
Interesa financiarë	81	71	71	-10	-12,2
Kontribute të veta në investime	1.189	1.432	1.231	41	3,5
Investime neto	-4.943	-8.506	-4.833	110	2,2

Paraqitja dhe struktura janë rregulluar (shih rubrikën 72. Ndryshimet në pasqyrat financiare 2023)


PASQYRA E AKTIVEVE NETO / KAPITALIT NETO

	Financim special 1	Fonde speciale 2	Fonde të tjera të kufizuara 3	Fonde të kufizuara 4=1+2+3	Të akumuluar globalisht rezerva buxheti 5	Të akumuluar deficit / suficit 6	Totali i aktiveve neto / kapitalit neto 7=4+5+6
Milionë franga zvicerane							
Riparaqitur më 01.01.2022	5.055	1.437	30	6.523	446	-841	6.127
Ndryshimet në standardet kontabël/riparaqitja	-	-	-	-	-	-235	-235
Riparaqitur më 01.01.2022	5.055	1.437	30	6.523	446	-1.076	5.893
Rezultati i fondeve speciale	-	33	-	33	-	1	34
Ndryshimi në fonde të tjera të kufizuara	-	-	-1	-1	-	-	-1
Rivlerësimi i përfitimeve të pensionit për punëmarrësit	-	-	-	-	-	1.386	1.386
Përqindja e transaksioneve të kapitalit neto me interesa të kapitalit neto	-	-	-	-	-	738	738
Transaksione mbrojtëse	-	-	-	-	-	-239	-239
Totali i zërave të njohur në aktivet neto / kapitalin neto	-	33	-1	31	-	1.886	1.917
Suficiti/(deficiti) për vitin i riparaqitur	-	-	-	-	-	-3.619	-3.619
Totali i rezultatit i njohur	-	33	-1	31	-	-1.733	-1.702
Regjistrim i transferimeve në aktivet neto / kapitalin neto	28	-	-	28	264	-292	-
Ndryshime objekti konsolidimi	-	-	-	-	-	-	-
Riparaqitur më 31.12.2022	5.083	1.470	28	6.582	710	-3.101	4.191
Ndryshimet në standardet kontabël/riparaqitja	-5	35	-	30	-	21	51
Riparaqitur më 01.01.2023	5.078	1.505	28	6.612	710	-3.080	4.242
Rezultati i fondeve speciale	-	8	-	8	-	1	10
Ndryshimi në fonde të tjera të kufizuara	-	-	-6	-6	-	-	-6
Rivlerësimi i përfitimeve të pensionit për punëmarrësit	-	-	-	-	-	-661	-661
Përqindja e transaksioneve të kapitalit neto me interesa të kapitalit neto	-	-	-	-	-	-82	-82
Transaksione mbrojtëse	-	-	-	-	-	-444	-444
Totali i zërave të njohur në aktivet neto / kapitalin neto	-	8	-6	2	-	-1.185	-1.183
Suficiti/(deficit) për vitin	-	-	-	-	-	877	877
Totali i rezultatit i njohur	-	8	-6	2	-	-308	-306
Regjistrim i transferimeve në aktivet neto / kapitalin neto	-13	-	-	-13	-88	101	-
Ndryshime objekti konsolidimi	-	-	-	-	-	-	-
Më 31.12.2023	5.066	1.513	22	6.601	621	-3.287	3.936

Shifrat për vitin 2022 janë rregulluar (shih rubrikën B.72. Ndryshimet në pasqyrat financiare 2023)

PASQYRA E AKTIVEVE NETO / KAPITALIT NETO

Pasqyra e aktiveve neto / kapitalit neto tregon se cilat veprime financiare kanë sjellë ndryshim të zërit përkatës në kapitalit neto. Konkretisht, tregon se zërat e shpenzimeve dhe të ardhurave që janë njohur drejtpërdrejt në aktivet neto / kapitalin neto dhe jo në pasqyrën e performancës financiare dhe efekti i ndryshimit të rezervave dhe fondeve të kufizuara në aktivet neto / kapitalin neto.




SHTOJCA 5. SHEMBUIJ TË VENDEVE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E NDËRMARRJEVE SHTETËRORE⁵³

Informacionet financiare që tregojnë të ardhurat, shpenzimet, aktivet, detyrimet dhe kapitalin neto në lidhje me segmentin e NSH-ve përfshihet në pasqyrat

financiare të konsoliduara të qeverisë të mbyllura më 30 qershor 2023 me të dhënat krahasuese në faqet 176 dhe 177.

	30 qershor 2023				30 qershor 2022			
	Të ardhura (pa fitimin kapital)	Shpenzime (pa humbje)	Rezultati i shfrytëzimit	Shpërndarjet	Të ardhura (pa fitimin kapital)	Shpenzime (pa humbje)	Rezultati i shfrytëzimit	Shpërndarjet
	milionë \$	milionë \$	milionë \$	milionë \$	milionë \$	milionë \$	milionë \$	milionë \$
Ndërmarrjet shtetërore								
Airways Corporation of New Zealand Limited	226	220	7	-	144	178	-34	-
AsureQuality Limited	233	231	4	4	213	206	7	12
Landcorp Farming Limited	259	259	(3)	5	275	247	51	5
New Zealand Post Limited	1.200	1.245	48	717	1.095	1.082	107	-
KiwiRail Holdings Limited	1.629	1.167	455	-	1.333	1.075	251	-
Transpower New Zealand Limited	921	786	130	120	890	737	171	120
Kordia Group Limited	151	144	7	2	137	127	(2)	-
Kiwi Group Holdings Limited	548	431	121	-	1.054	931	182	98
New Zealand Railways Corporation	-	-	-	-	-	-	-	-
Të tjera ndërmarrje shtetërore	125	117	8	2	109	103	4	1
Totali i ndërmarrjeve shtetërore	5.292	4.600	777	850	5.250	4.686	737	236
Air New Zealand Limited	6.426	5.933	788	-	2.779	2.469	283	-
Genesis Energy Limited	2.358	2.261	166	186	2.851	2.761	218	183
Meridian Energy Limited	3.234	2.794	81	453	3.912	3.728	657	437
Mercury NZ Limited	2.724	2.401	131	286	2.192	2.002	470	248
Minus pjesëmarrjet si aksionar i vogël	-	-	(566)	(500)	-	-	(792)	(423)
Totali i shoqërive me pronësi të përzier	14.742	13.389	600	425	11.734	10.960	836	445
Eliminimet mes segmenteve	(257)	(147)	(101)	-	(259)	(587)	199	-
Totali i segmentit të NSH-ve	19.777	17.842	1.276	1.275	16.725	15.059	1.772	681

	30 qershor 2023						30 qershor 2022
	Blerja e AAM	Totali i AAM	Totali i aktiveve	Huamarrje	Totali i detyrimeve	Kapitali neto	Kapitali neto
	milionë \$	milionë \$	milionë \$	milionë \$	milionë \$	milionë \$	milionë \$
Ndërmarrjet shtetërore							
Airways Corporation of New Zealand Limited	35	169	320	58	103	217	196
AsureQuality Limited	8	56	158	25	58	100	100
Landcorp Farming Limited	46	1.596	2.100	263	297	1.803	1.831
New Zealand Post Limited	62	239	1.040	60	320	720	1.485
KiwiRail Holdings Limited	1.221	16.244	17.187	31	545	16.642	13.478
Transpower New Zealand Limited	350	4.787	6.067	3.510	4.479	1.588	1.597
Kordia Group Limited	15	56	119	28	57	62	58
Kiwi Group Holdings Limited	-	-	-	-	-	-	2.246
New Zealand Railways Corporation	12	4.261	4.263	-	-	4.263	4.311
Të tjera ndërmarrje shtetërore	5	22	85	11	30	55	49
Totali i ndërmarrjeve shtetërore	1.754	27.430	31.339	3.986	5.889	25.450	25.351
Air New Zealand Limited	539	5.353	9.595	2.793	6.352	3.243	2.432
Genesis Energy Limited	77	3.743	4.974	1.365	2.567	2.407	2.377
Meridian Energy Limited	316	8.950	9.967	1.424	4.010	5.957	5.508
Mercury NZ Limited	250	8.008	9.313	2.245	4.465	4.848	4.767
Totali i shoqërive me pronësi të përzier	1.182	26.054	33.849	7.827	17.394	16.455	15.084
Eliminimet mes segmenteve	2	(170)	(290)	(142)	(188)	(102)	(2.437)
Totali i segmentit të NSH-ve	2.938	53.314	64.898	11.671	23.095	41.803	37.998



MATERIALET MBËSHTETËSE

ACCA

- ▶ **“A vijon ende të mbretërojë baza monetare: maksimizimi i përfitimeve të informacioneve me të drejta dhe detyrime të konstatuara në sektorin publik”**
https://www.accaglobal.com/content/dam/ACCA_Global/professional-insights/Is_cash_still_king/pi-IPSAS-is-cash-still-king v5.pdf
- ▶ **“Përfitimet e bazës me të drejta dhe detyrime të konstatuara”**
<https://www.accaglobal.com/gb/en/member/discover/cpd-articles/financial-management/cashking-cpdapr200.html>
- ▶ **“Nyja e raportimit të qëndrueshmërisë”**
<https://www.accaglobal.com/uk/en/professional-insights/global-profession/sustainability-reporting.html>
- ▶ **“Kultura e rrezikut: relacion i posaçëm mbi ndërmarrjet shtetërore të Kinës, 2023”**
https://www.accaglobal.com/content/dam/ACCA_Global/professional-insights/riskculture/PI-RISK-CULTURE-CHINA v8.pdf

CIPFA

- ▶ **“Menaxhimi i financave publike – një qasje e sistemit në tërësi 2010”**
https://www.cipfa.org/-/media/files/publications/pfm_wsa_vol1.pdf
- ▶ **“Rrugët drejt kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara, 2017”**
https://pathways.ifac.org/standards/pathways/2021?section=MASTER_27#_Toc96512584
- ▶ **CIPFA dhe Këshilli Ndërkombëtare i Raportimit të Integruar, “Mendimi dhe raportimi i integruar: përqendrimi te krijimi i vlerës në sektorin publik”, shtator 2016**
https://integratedreporting.ifrs.org/wp-content/uploads/2016/09/Focusing-on-value-creation-in-the-public-sector-_vFINAL.pdf

CIMA

- ▶ **“Raportimi i integruar në sektorin publik”, 2016**
<https://integratedreporting.ifrs.org/wp-content/uploads/2016/09/IR-in-the-Public-Sector-CIMACGMA.pdf>

ICAEW

- ▶ **Elemente ndërtuese për një MFP më të mirë – paketë instrumentesh nga kontabiliteti me baza monetare në atë me të drejta dhe detyrime të konstatuara, 2017**
<https://www.icaew.com/about-icaew/regulation-and-the-public-interest/policy/better-government-series/building-blocks-to-better-pfm>
- ▶ **Administrimi i pasqyrës së bilancit në sektorin publik, 2016**
<https://www.icaew.com/-/media/corporate/files/about-icaew/what-we-do/policy/public-finances/managing-the-public-balance-sheet.ashx>

IFAC

- ▶ **“Rruga drejt kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara – konteksti i përgjithshëm i reformave”**
https://pathways.ifac.org/standards/pathways/2021?section=MASTER_3#_Toc96512532
- ▶ **“Nevojat e sektorit publik për hartimin e raportimit të qëndrueshmërisë dhe dhënien e sigurisë”**
<https://www.ifac.org/news-events/2023-10/public-sector-needs-prepare-sustainability-reporting-and-assurance-challenge>
- ▶ **Transparenca dhe llogaridhënia për menaxhimin financiar të sektorit publik: përdorimi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik, mars 2012**
<https://www.ifac.org/knowledge-gateway/public-sector/publications/public-sector-financial-management-transparency-and-accountability-use-international-public-sector>

IIRC

- ▶ **Raportimi i integruar, 2013**
<https://integratedreporting.ifrs.org/wp-content/uploads/2013/12/13-12-08-THE-INTERNATIONAL-IR-FRAMEWORK-2-1.pdf>

FMN

- ▶ **Transformimi i financave publike nëpërmjet GovTech-ut, 2023**
<https://www.elibrary.imf.org/view/journals/006/2023/004/006.2023.issue-004-en.xml>

- ▶ **“Kalimi drejt kontabilitetit me të drejta dhe detyrime të konstatuara”**
<https://www.imf.org/external/pubs/ft/tnm/2009/tnm0902.pdf>

Financial Times

- ▶ **Fondi Monetar Ndërkombëtar e ka paralajmëruar Britaninë e Madhe se duhet, 28 shtator 2022**
<https://www.ftadviser.com/investments/2022/09/28/imf-warns-uk-over-mini-budget-tax-cuts/>
- ▶ **Plani i qeverisë brinatike është menduar keq nga ana ekonomike dhe është një mundësi e humbur, 29 shtator 2022**
<https://www.ft.com/content/e77e8669-d4e4-4bc3-8193-b9dfd571b3f9>

OECD

- ▶ **Strategjia digjitale shtetërore**
<https://www.oecd.org/gov/digital-government/>
- ▶ **“Planifikimi i gjelbër buxhetor”**
<https://www.oecd.org/en/topics/sub-issues/green-budgeting.html>
- ▶ **“Korniza për planifikimin e gjelbër buxhetor” e OECD-së**
[https://one.oecd.org/document/GOV/SBO\(2024\)2/en/pdf](https://one.oecd.org/document/GOV/SBO(2024)2/en/pdf)
- ▶ **Drejtuesimi mes prioriteteve tregtare dhe jotregtare të ndërmarrjeve shtetërore, 2013**
https://www.oecd-ilibrary.org/governance/balancing-commercial-and-non-commercial-priorities-of-state-owned-enterprises_5k4dkhztzp9r-en
- ▶ **Udhëzimet E OECD-së për drejtimin e brendshëm të ndërmarrjeve shtetërore, tetor 2024**
<https://doi.org/10.1787/18a24f43-en>

Thesari i LT-së, Britania e Madhe

- ▶ **“Shqyrtimi i pasqyrës së bilancit: përmirësimi i administrimit të pasqyrës së bilancit të sektorit publik”, nëntor 2020**
https://assets.publishing.service.gov.uk/media/5fbd02dfe90e077ee6d17a26/The_Balance_Sheet_Review_report____.pdf

UN Women

- ▶ **“Planifikimi buxhetor me bazë gjinore: analizë e programeve buxhetore nga perspektiva gjinore”**

<https://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/05/gender-responsive-budgeting--analysis-of-budget-programmes-from-gender-perspective>

PULSAR, Banka Botërore


- ▶ **Udhërrëfyes i reformave të kontabilitetit në sektorin publik: model i praktikës së mirë, 2018**
<https://cfrr.worldbank.org/publications/roadmap-public-sector-accounting-reform-good-practice-template>
- ▶ **Përfitimet nga kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara në sektorin publik, 2019**
https://cfrr.worldbank.org/sites/default/files/2019-11/PULSAR_Accrual_Accounting_Brochure.pdf
- ▶ **Përfitimet nga kontabiliteti me të drejta dhe detyrime të konstatuara në sektorin publik, 2022**
<https://cfrr.worldbank.org/publications/benefits-accrual-accounting-public-sector>
- ▶ **Korniza (PULSE) e vlerësimit të kontabilitetit në sektorin publik, 2024**
<https://cfrr.worldbank.org/publications/public-sector-accounting-assessment-pulse-framework-handbook>
- ▶ **Korniza e tregimit të të dhënave në sektorin publik, 2022**
<https://cfrr.worldbank.org/publications/data-guide>
- ▶ **Konsolidimi i pasqyrave financiare në nivele të ndryshme të qeverisjes, 2022**
<https://cfrr.worldbank.org/publications/consolidation-financial-statements-different-levels-government>
- ▶ **Zbatimi për herë të parë i SNKSP-ve me të drejta dhe detyrime të konstatuara, 2021**
<https://cfrr.worldbank.org/publications/first-time-adoption-accrual-basis-ipsas>
- ▶ **PULSAR – Faktorët shtytës të reformave të kontabilitetit në sektorin publik, 2021**
<https://cfrr.worldbank.org/publications/pulsar-drivers-public-sector-accounting-reforms>
- ▶ **Faqja në internet e GovTech – Të rejat nga GovTech**
<https://www.worldbank.org/en/programs/govtech>
- ▶ **Faqja në internet e PEFA-s Kuadri plotësues për vlerësimin e MFP-së mbi baza gjinore**
<https://www.pefa.org/gender>

PROGRAMI PULSAR

MENAXHOHET NGA



BASHKËFINANCOHET NGA



Swiss Confederation

Federal Department of Economic Affairs,
Education and Research EAER
State Secretariat for Economic Affairs SECO

